

VËLLIMI XXVII /TETOR-DHJETOR/ 2024

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS
2024**

BULETINI ZYRTAR



**AUTORITETI I
KONKURRENCËS**

PËRMBAJTJA

- Nr.1113, Datë 04.10.2024
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË KCA DEUTAG INTERNATIONAL LIMITED NGA SHOQËRIA HP GLOBAL HOLDINGS LIMITED”
- Nr.1114, Datë 04.10.2024
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E GRUMBULLIMIT DHE SHITJES ME SHUMICË TË FRUTA-PERIMEVE NË QARKUN TIRANË, ELBASAN, BERAT, FIER DHE KORÇË”
- Nr.1115, Datë 11.10.2024
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË PHARMA ONE SHPK NGA SHOQËRITË MED LAB SHPK, EVITA SHPK DHE FARMACOM SHPK”
- Nr.1116, Datë 11.10.2024
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË HORIZON SHPK NGA Z. ERMAL BEQIRI”
- Nr.1117, Datë 11.10.2024
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DELTA MED SHPK NGA SHOQËRIA PHARMA ONE SHPK”
- Nr.1118, Datë 11.10.2024
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË PHARMA ONE SHPK, NGA SHOQËRIA EVITA SHPK DHE Z. BEN PETANI”
- Nr.1119, Datë 11.10.2024
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË PHARMA ONE SHPK, NGA SHOQËRITË EVITA SHPK, FARMACOM SHPK DHE Z. BEN PETANI”
- Nr.1120, Datë 11.10.2024
“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRISË FARMACOM SHPK, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË 33.33% TË KAPITALIT TË SHOQËRISË PHARMA ONE SHPK NGA

SHOQËRIA FARMACOM SHPK”

Nr.1121 Datë 11.10.2024

“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRISË PHARMA ONE SHPK, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DELTA MED SHPK NGA SHOQËRIA PHARMA ONE SHPK”

Nr.1122, Datë 23.10.2024

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE ADASTRA SHPK DHE COLOMBO SHPK”

Nr.1123, Datë 23.10.2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DELEPLANQUE ET COMPAGNIE NGA SHOQËRIA RAGT SEMENCES”

Nr.1124, Datë 23.10.2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA NGA SHOQËRITË KONČAR – ELECTRICAL INDUSTRI INC. DHE SIEMENS ENERGY HOLDING B.V”

Nr.1127, Datë 07.11.2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË JOHNSON CONTROLS - HITACCHI AIR CONDITIONING HOLDING (UK) LTD DHE BIZNESIT TË SHOQËRISË JOHNSON CONTROLS INTERNATIONAL PLC NGA SHOQËRIA ROBERT BOSCH GMBH”

Nr.1128, Datë 07.11.2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË V4DRIVE BATTERY GMBH NGA SHOQËRIA DR. ING.H.C.F. PORCHE AKTIENGESELLSCHAFT”

Nr.1129, Datë 07.11.2024

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SHA”

Nr.1130, Datë 07.11.2024

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E SIGURIMIT

TË JETËS PËR KREDI”

Nr.1132, Datë 14.11.2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË ENTITETEVE TË GRUPIT VANTIVE (VANTIVE HEALTH LLC, VANTIVE MEXICO LLC, GAMBRO RENAL PRODUCTS INC, RTS WORLDWIDE HOLDINGS INC, VANTIVE HOLDING BV, VANTIVE HEALTH GMBH, JERSEY NEWCO) NGA SHOQËRIA CP SPRUCE HOLDINGS, S.C.SP..”

Nr.1133, Datë 14.11.2024.....

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË IDEMIA IDENTITY & SECURITY FRANCE NGA SHOQËRIA IMPRIMERIE NATIONALE”

Nr.1134, Datë 06.12.2024.....

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË NOA SHA NGA SHOQËRIA TRANZIT SHPK”

Nr.1136, Datë 06.12.2024.....

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË BIZNESIT TË TRANSFERUAR NGA SHITËSIT TEK SHOQËRIA DIGI TÁVKÖZLÉSI ÉS SZOLGÁLTATÓ KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG”

Nr.1137, Datë 06.12.2024.....

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SHA”

Nr.1138, Datë 20.12.2024.....

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE ADASTRA SHPK DHE COLOMBO SHPK, GJOBITJEN DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJET ADASTRA SHPK DHE COLOMBO SHPK”

Nr.1139, Datë 27.12.2024.....

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALBANIA LEASING SHA NGA SHOQËRIA AMERICAN CAPITAL SHPK”

Nr.1140, Datë 27.12.2024.....

“MBI VËNIEN NË DISPOZICION TË NJË KOPJEJE TË DOKUMENTEVE TË HETIMIT

TË THELLUAR PËR NDËRMARRJEN SAFE SECURITY ALBANIA SHPK”

Nr.1142, Datë 27.12.2024
“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1078,
DATË 10.05.2024 “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË
TREGUN E OFRIMIT DHE AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ
NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË
REZIDENCAT E BANIMIT KU KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË”

VENDIM

Nr. 1113, Datë 04. 10. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË KCA DEUTAG INTERNATIONAL LIMITED NGA SHOQËRIA HP GLOBAL HOLDINGS LIMITED.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04. 10. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë KCA Deutag International Limited nga shoqëria HP GLOBAL HOLDINGS LIMITED.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë KCA Deutag International Limited nga shoqëria HP GLOBAL HOLDINGS LIMITED.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë KCA Deutag International Limited nga shoqëria HP GLOBAL HOLDINGS LIMITED.

Referuar dokumentit “Marrëveshje Shit-Blerje”, nënshkruar më datë 25 korrik 2024, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse:

Blerësi: HP GLOBAL HOLDINGS LIMITED është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, me aksione të inkuorporuara në Jersey. HP GLOBAL HOLDINGS LIMITED është një shoqëri e themeluar për qëllim të këtij transaksioni (SPV). HP GLOBAL HOLDINGS LIMITED zotërohet plotësisht në mënyrë indirekte nga shoqëria Helmerich & Payne, Inc.

Garantuesi i Blerësit: HELMERICH & PAYNE, INC. është një korporatë e themeluar sipas ligjit të përgjithshëm të Korporatës të shtetit Delaware, SHBA, me objekt aktiviteti: Të ushtrojë biznesin e prodhimit, blerjes, shitjes dhe asgjësimit dhe kthimit në llogari, shpërndarjes së naftës, naftës bruto dhe gazit të të gjitha llojeve, etj. Aktualisht HELMERICH & PAYNE, INC. ofron, përmes filialeve të saj, shërbim të kontraktuar për shpime me një flotë prej rreth 160 pajisjesh aktive, kryesisht në SHBA, si dhe në Gjirin e Meksikës, Argjentinë, Kolumbi, Bahrein, Australi dhe Emiratet e Bashkuara Arabe.

Pala shitëse:

Shitësit me shumicë aksionesh: përcaktuar në pjesën 1 të shtojcës 1 të Marrëveshjes.

Shitësit kryesorë: Ocorian Limited është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, dhe aksione të inkuorporuara në Jersey. Kjo shoqëri është në cilësinë e vet si administrues i besuar i Planit të Kapitalit të shoqërisë KCA Deutag International Limited (Administratori i Besuar, së bashku me shitësit me shumicë aksionesh dhe Shitësin Menaxhues).

Shitësit menaxhues: Z. Joseph Elkhoury, përcaktuar në pjesën 2 të shtojcës 1 të Marrëveshjes.

Target: KCA Deutag International Limited është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, me aksione të inkuorporuara në Jersey, me seli në Aberdeen, Mbretëria e Bashkuar dhe vepron si një partner kryesor në fushën e shpimit, inxhinierisë dhe teknologjisë në tregjet globale të energjisë aktuale dhe të ardhshme.

KCA Deutag International Limited ka të regjistruar në Shqipëri, degën e saj - **KCA Deutag Drilling GmbH Dega në Shqipëri – Degë e shoqërisë së huaj**, e regjistruar me kohëzgjatje të papërcaktuar, me fushë veprimtarie: Hapja/shpimi i puseve të çdo lloji dhe kryerja e punëve/shërbimeve që lidhen me to në të gjithë botën dhe veçanërisht realizimi i shpimeve në thellësi dhe punëve përkatëse me qëllim përmirësimit të tyre.

II. Transaksioni

Më [.....] ndërmjet palës shitëse: shitësve me shumicë të aksioneve, shitësit menaxhues, shoqërisë Ocorian Limited dhe palës blerëse: shoqërisë HP GLOBAL HOLDINGS LIMITED (blerësi), shoqërisë HELMERICH & PAYNE, INC. (garantuesi i blerësit) dhe, vetëm për qëllimet e përcaktuara në pikën 18.5 të marrëveshjes, shoqëria KCA Deutag International Limited, është nënshkruar, “Marrëveshje Shit - Blerje”.

Blerësi ka rënë dakord të blejë të gjithë kapitalin aksionar të emetuar të shoqërisë si vijon: (i) secili nga Administratori i Besuar dhe Shitësi Menaxhues ka rënë dakord të shesë aksionet e

përcaktuara për secilin; (ii) shitësit me Shumicë Aksionesh kanë rënë dakord për ti dorëzuar blerësit të gjitha aksionet e shitësit me Shumicë Aksionesh, dhe; (iii) Blerësi do të dërgojë një njoftim për t'ju bashkuar shitjes Shitësve me Pakicë aksionesh, në bazë të të cilit Shitësve të Pakicës do t'u kërkohej të transferojnë të gjitha aksionet e tyre në pakicë të blerësi.

Garantuesi i blerësit është shoqëria aksionare përfundimtare e blerësit dhe është e gatshme të garantojë detyrimet e blerësit sipas kësaj Marrëveshje.

Pala njoftuese sqaron se me përmbushjen e kësaj kontrate HP GLOBAL HOLDINGS LIMITED do të zotërojë plotësisht kapitalin aksionar të shoqërisë target KCA Deutag International Limited. Shoqëria HELMERICH & PAYNE, INC. do të zotërojë indirekt shoqërinë KCA Deutag International Limited.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i ofrimit të shërbimit të shpimit të puseve dhe shërbimeve inxhinierike dhe teknologjike të lidhura me to, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i synuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë KCA Deutag International Limited nga shoqëria HP GLOBAL HOLDINGS LIMITED.

HP GLOBAL HOLDINGS LIMITED është një shoqëri private, e themeluar sipas legjislacionit të Jersey, e cila zotërohet plotësisht në mënyrë indirekte nga HELMERICH & PAYNE, INC..

HELMERICH & PAYNE, INC. është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të shtetit të Delaware, aksionet e së cilës janë të listuara dhe tregtohen në Bursën e Nju Jorkut.

HELMERICH & PAYNE, INC. nuk ka filial në Shqipëri dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

KCA Deutag International Limited është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Jersey. Ajo është një shoqëri holding, filialet kryesore të së cilës ofrojnë shërbime inxhinierike dhe teknologjike të shpimit të puseve dhe objekteve në baza mbarë botërore për industrinë e energjisë, duke qenë një kompani lider në fushën e shpimit, inxhinierisë dhe teknologjisë në tregjet globale të energjisë.

KCA Deutag International Limited ka regjistruar në Shqipëri degën e saj – KCA Deutag Drilling GmbH Dega në Shqipëri, e cila ka për objekt aktiviteti hapjen/shpimin e puseve të çdo lloji dhe

kryerjen e punëve/shërbimeve që lidhen me to në të gjithë botën dhe veçanërisht realizimin e shpimeve në thellësi dhe punëve përkatëse me qëllim përmirësimin e tyre.

Targeti, KCA Deutag International Limited operoi një platformë shpimi në Shqipëri në vitin 2023, e cila nuk është më aktive dhe është planifikuar të largohet nga vendi gjatë vitit 2024.

Për sa më sipër, meqenëse HP GLOBAL HOLDINGS LIMITED nuk ka aktivitete në Shqipëri, ndërsa targeti, KCA Deutag International Limited është planifikuar të largohet nga vendi gjatë vitit 2024 transaksioni i propozuar nuk do të ngrejë shqetësime në lidhje me konkurrencën në Shqipëri.

Nga sa më sipër, transaksioni i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni nuk pritet të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë KCA Deutag International Limited nga shoqëria HP GLOBAL HOLDINGS LIMITED.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 1114, Datë 04. 10. 2024

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E GRUMBULLIMIT DHE SHITJES ME SHUMICË TË FRUTA-PERIMEVE NË QARKUN TIRANË, ELBASAN, BERAT, FIER DHE KORÇË”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04. 10. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.

Bazë ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 43, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, “Mbi procedurën e hetimit paraprak në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë”.

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, me anë të vendimit nr.1085, datë 14.06.2024, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë”, vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë, për periudhën kohore nga 1 janar 2023 deri në 31 Maj 2024, për të vlerësuar nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9121/2003, si dhe raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Në vazhdim të procedurës, në zbatim të vendimit nr. 1085, datë 14.06.2024 të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 27/16, datë 14.06.2024 "Autorizim për Inspektim", gjatë procedurës së hetimit paraprak u kryen 65 (gjashtëdhjetë e pesë) inspektime pranë ndërmarrjeve ushtrinë

veprimtari në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë, të cilat zotërojnë një pjesë të konsiderueshme të tregut.

3. Gjithashtu gjatë procedurës së hetimit paraprak, bazuar në nenin 34 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", me qëllim identifikimin e saktë të ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun objekt hetimi, është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Statistikave.
4. Përcaktimi i tregut përkatës është elementi kryesor i analizës së konkurrencës. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si dhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", *"tregu përkatës përbëhet nga produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese"*. Në zbatim të ligjit nr. 9121/2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
5. Bazuar në vendimin e KK nr.1085, datë 14.06.2024, "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë", tregu përkatës i produktit përfshin:
 - Import-eksportin e fruta perimeve;
 - Tregun e grumbullimit të fruta perimeve;
 - Tregun e shitjes me shumicë të fruta perimeve.
6. Analiza e këtyre tregjeve bëhet e domosdoshme pasi, ndërmarrjet më të mëdha në tregun në tregun e grumbullimit janë importues dhe eksportues dhe çdo shtrembërim i konkurrencës në tregu jep efekte të drejtpërdrejta në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë , transmetohet tek deri tek konsumatori përfundimtar.
7. Referuar VKK nr. 1085, datë 14.06.2024, si më sipër, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet qarku Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.
8. Perimet përbëjnë një nga nën sektorët më produktivë dhe të rëndësishëm të bujqësisë Shqiptare, me mundësi të mira të rritjes së tregut të brendshëm dhe atij për eksport. Sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2022, rezulton se qarqet më të mëdha për prodhimin e perimeve në sera janë qarku i Fierit, Beratit dhe Tiranës, ndërsa për prodhimin e frutave janë qarku i Korçës dhe Elbasanit. Këto janë qytetet të cilat kanë peshën më të madhe të prodhimit në vendin tonë.

9. Nga struktura e tregut konstatohet se ky treg ka shumë nivele tregtimi: Fermerët/prodhuesit; Importuesit dhe eksportuesit e frutave dhe perimeve; Pikat e grumbullimit; Shitësit me shumicë (Tregjet Agroushqimore me Shumicë); Shitësit me pakicë.
10. Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, vërehet se qarku me i madh për nga numri grumbulluesve dhe për nga xhiro për vitin 2022 është qarku i Fierit me 53.5% të totalit të xhiros së realizuar në të gjithë Shqipërinë, e ndjekur nga qarku i Tiranës me 24% dhe qarku i Beratit me rreth 10%. Në këto të dhëna janë paraqitur edhe grumbulluesit të cilët realizojnë importe dhe eksporte.
11. Bazuar në të dhënat e administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, janë identifikuar ndërmarrjet importuese dhe eksportuese, por janë marrë në analizë vetëm ndërmarrjet të cilat kanë një pjesë mbi 5% në raport me sasinë totale të importuar dhe eksportuar të fruta perimeve për periudhën janar 2023 – shkurt 2024.
12. Nga inspektimet e realizuara gjatë procedurës së hetimit paraprak rezulton se:
 - Tregu i grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, ndër të tjera ka problematika sa i përket: ekonomisë informale dhe integritimit vertikal pasi grumbulluesit mund të zotërojnë edhe vetë sera. Duke qenë se tregu i prodhimit, grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve është i përbërë nga shumë nivele tregtimi, çmimet nga fermeri te konsumatori përfundimtar rezultojnë shumë të larta për konsumatorin fundor (marzhe deri në 50% në qarqet e monitoruara) megjithëse çmimi final i produkteve në tregun e pakicës ndikohet nga *frot* (humbjet) dhe jetëgjatësia e produktit në raft;
 - Ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun e grumbullimit janë të përqendruara në qarkun e Tiranës, Fierit, Beratit dhe Korçës. Nisur nga pozita gjeografike dhe largësia ndërmjet ndërmarrjeve një pjesë e këtyre ndërmarrjeve kanë të njëjtën zyrë kontabiliteti për mbajtjen e të dhënave ekonomike;
 - Gjatë periudhës nën hetim është vënë re se ndërmarrjet grumbulluese kanë aplikuar çmime të përafërta të blerjes së këtyre produkteve nga fermerët vendas;
 - Për shkak të ekonomisë informale, fermeret dhe grumbulluesit punojnë pa kontrata, pa fatura, pa mbështetje financiare. Grumbulluesit nuk shlyejnë detyrimet e prapambetura. Thuajse të gjitha pikat e grumbullimit operojnë pa kontratë me fermerët, duke i ekspozuar këta të fundit përballë rreziqeve, që një produkt bujqësor ta shesin me humbje. Për fermerët kjo situatë, pa çmime dhe në shumë raste edhe pa faturë, e ka deformuar tregun, duke sjellë çmime abusive.

13. Sa më sipër, referuar strukturës së tregut, integritit vertikal, sjelljes së ndërmarrjeve grumbulluese dhe diferencave të mëdha në zinxhirin e vlerës së produktit nga prodhuesit, grumbulluesit, shitësit me shumicë deri tek konsumatori fundor, mund të jemi para një sjellje antikonkurrese si pasojë e marrëveshjeve dhe/ose praktikave të bashkërenduara ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve që operojnë në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja d) dhe nenin 43, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë.
- II. Hetimi i thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2023- 30 Shtator 2024.
- III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1115, Datë 11. 10. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË PHARMA ONE SHPK NGA SHOQËRITË MED LAB SHPK, EVITA SHPK DHE FARMACOM SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 10. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë Med Lab SHPK, Evita SHPK dhe FARMACOM SHPK.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”; Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë Med Lab SHPK, Evita SHPK dhe FARMACOM SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë Med Lab SHPK, Evita SHPK dhe FARMACOM SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga pala njoftuese si dhe informacionit të marrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Autoriteti i Konkurrencës konstatoi se shoqëria PHARMA ONE SHPK është përfshirë në disa transaksione të panjoftuara.

Me qëllim vlerësimin e ndikimeve në treg që mund të kenë sjellë transaksionet e ndryshimit të kontrollit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK në tregun e barnave, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 1081, datë 24.05.2024 “Mbi pezullimin e afateve të procedurës së kontrollit të përqendrimeve për transaksionin e përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë MED LAB SHPK, EVITA SHPK dhe FARMACOM SHPK dhe fillimin e procedurës së kontrollit për transaksionet e pa njoftuara”, vendosi pezullimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve për transaksionin e shit-blerjes së Kuotës që përfaqëson 33.34 % të kapitalit të shoqërisë “Pharma One” SHPK dhe fillimin e procedurës së kontrollit të transaksioneve të mësipërme.

Referuar dokumenteve të depozituara nga pala njoftuese, palët në transaksionin e përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë Med Lab SHPK, Evita SHPK dhe FARMACOM SHPK janë:

Pala Blerëse: Med Lab SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti shitje-blerje të pajisjeve mjekësore e laboratorike, investime në fushën e laboratorëve mjekësore; import, eksport, tregtim me shumicë e pakicë, montim e riparim i aparaturave laboratorike mjekësore etj.

Shoqëria Med Lab SHPK zotërohet 100% nga znj. Rezalda Shehi.

Referuar pasqyrave financiare të shoqërisë për vitin 2022 rezulton se shoqëria nuk ka kryer aktivitet ekonomik dhe nuk ka realizuar të ardhura.

Dhënësit e pëlqimit:

- **Shoqëria Evita SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti import-eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të produkteve farmaceutike, kozmetike, bimëve medicinale, instrumenteve dhe pajisjeve shëndetësore dhe medicinale, sanitare, shtesa ushqimore dhe dietike; import, eksport, tregtim me shumicë, montim dhe riparim i aparaturave dhe pajisjeve mjekësore, impianteve dhe aksesorëve të tyre etj.
- **Shoqëria FARMACOM SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti import, eksport, tregtim me shumicë, montim dhe riparim i aparaturave laboratorike mjekësore etj; investime, shërbime e projekte në fushën e mjekësisë e laboratorëve mjekësorë; ndërmarrja e nismave, veprimeve, aktiviteteve e pjesëmarrjes në iniciativa të ndryshme koncesionare, privatizimi apo tenderimi etj.

Pala Shitëse: z. Ben Petani shtetas shqiptar, person fizik, i cili zotëron 33.34% të kuotës në shoqërinë PHARMA ONE SHPK.

Shoqëria target: PHARMA ONE SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e angazhuar në fushën e tregtisë ku do të kryejë tregtimin

me shumicë dhe pakicë të barnave dhe pajisjeve mjekësore dhe artikujve farmaceutikë, lëndëve të para, aksesorë, para farmaceutike, tregtimin dhe import-eksportin e mallrave të ndryshme si pajisje mjekësore industriale e artikujve të ndryshme, elektrike, mekanike, elektronike, cigare të të gjitha llojeve, industriale, ushqimore, të ndërtimit, të mediave, të mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit etj.

Aktualisht shoqëria PHARMA ONE SHPK zotërohet 33.34% nga z. Ben Petani, 34% nga shoqëria Evita SHPK dhe 32.66% nga shoqëria FARMACOM SHPK.

Referuar pasqyrës financiare të vitit 2022, “Informacion i përgjithshëm”, evidentohet se shoqëria PHARMA ONE SHPK zotëron:

- 85% të kuotave në shoqërinë Qarkullimi i Barnave Asgeta SHPK, në Gracanisë, Kosovë.
- 100% të kuotave të shoqërisë DELTA MED SHPK, shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti tregtim të artikujve farmaceutike dhe kozmetike, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligji; distributor dhe shpërndarës i barnave dhe medikamenteve mjekësore; import, eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të barnave dhe medikamenteve mjekësore etj.
- 100% të kuotave të shoqërisë Albhealth SHPK, shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti tregti me pakicë e barnave, produkteve farmaceutike, kozmetike dhe pajisjeve mjekësore; import-eksport i barnave dhe pajisjeve mjekësore dhe artikujve farmaceutike, kozmetike, lëndëve të para, aksesorë, para farmaceutike, por pa u kufizuar vetëm në këto; tregtim dhe import-eksport të mallrave industriale, kozmetike etj.

II. Përqendrimi

Më datë 19.01.2024, ndërmjet shoqërisë Med Lab SHPK (blerësi), z. Ben Petani (shitësi), shoqërive Evita SHPK dhe FARMACOM SHPK (Dhënësit e pëlqimit) është nënshkruar Kontratë Shitje Kuote me Kusht.

Referuar kësaj kontrate, blerësi i ka kërkuar shitësit të blejë 1 kuotë prej 33.34% të kapitalit, që zotëron në shoqërinë target PHARMA ONE SHPK, sipas çmimit, kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë kontratë.

Kalimi i pronësisë së kuotës së z. Ben Petani tek blerësi do të ndodhë vetëm pasi të jenë plotësuar në mënyrë kumulative të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. Të jetë paguar plotësisht çmimi për kalimin e kuotës;
- ii. Të jetë kaluar pronësia e pasurive të paluajtshme tek z. Ben Petani;
- iii. Të jenë hequr të gjitha hipotekat që rëndojnë mbi pasuritë e paluajtshme dhe këto pasuri të kaluara tek z. Ben Petani të jenë të lira nga çdo barrë garancie në favor të një personi të tretë;

iv. Të jetë marrë pëlqimi për transaksionin nga Autoriteti i Konkurrencës.

Referuar shkresës nr. 125/7 prot., i AK, datë 20.05.2024, të depozituar nga shoqëria PHARMA ONE SHPK citohet se: “Për sa kohë nuk ka një parashikim të ndryshëm statutor, vendimmarrja në shoqërinë PHARMA ONE SHPK kryhet sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë vendos me shumicë të thjeshtë (50%+1 të votave) për të gjitha vendimet për të cilat sipas nenit 86/1 të ligjit nuk kërkohet një shumicë e cilësuar dhe me shumicë prej $\frac{3}{4}$ të votave të ortakëve për vendimmarrjet e parashikuara nga neni 87/1 i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar. Për këto arsye, shoqëria kontrollohet bashkërisht nga të tre ortakët.

Në përfundim të transaksionit të propozuar shoqëria target PHARMA ONE SHPK do të zotërohet 33.34% nga shoqëria Med Lab SHPK, 33.33% nga shoqëria Evita SHPK dhe 33.33% nga shoqëria FARMACOM SHPK.

Në Udhëzimin “Mbi kontrollin e përqendrimit ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 78, është përcaktuar se: Hyrja e aksionarëve të rinj në një ndërmarrje të kontrolluar bashkërisht ose duke shtuar numrin e aksionarëve tashmë kontrollues ose duke zëvendësuar një nga ata, gjithashtu përbën një përqendrim që duhet njoftuar, pavarësisht se ndërmarrja kontrollohet bashkërisht para dhe pas operacionit. *Së pari*, gjithashtu në këtë skenar ka një aksionar i cili rishtaz përfton kontrollin e joint venture. *Së dyti*, cilësia e kontrollit të joint venture përcaktohet duke identifikuar të gjithë aksionarët kontrollues. Kjo shtrihet në natyrën e kontrollit të përbashkët ku secili aksionar më vete ka të drejta bllokuese në lidhje me vendime strategjike, aksionarët e përbashkët kontrollues duhet të marrin në konsideratë interesat e njëri-tjetrit dhe u kërkohet që të bashkëpunojnë për përcaktimin e sjelljeve strategjike të një sipërmarrje të përbashkët.

Duke qenë se, në shoqërinë target PHARMA ONE SHPK ka hyrë një aksionar i ri kontrollues, Med Lab SHPK, atëherë hyrja e këtij aksionari të ri në shoqërinë target të kontrolluar bashkërisht, përbën një ndryshim kontrolli.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shitjes së barnave dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar konsiston në përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë Med Lab SHPK, Evita SHPK dhe FARMACOM SHPK.

Blerësi, shoqëria Med Lab SHPK është një shoqëri me objekt aktiviteti shitje-blerje të pajisjeve mjekësore e laboratorike, investime në fushën e laboratorëve mjekësore; import, eksport, tregtim me shumicë e pakicë, montim e riparim i aparaturave laboratorike mjekësore etj; investime, shërbime e projekte në fushën e mjekësisë e laboratorëve mjekësore; ndërmarrja e nismave, veprimeve, aktiviteteve e pjesëmarrjes në iniciativa të ndryshme koncesionare, privatizimi apo tenderimi etj. Referuar pasqyrave financiare të shoqërisë për vitin 2022 rezulton se shoqëria nuk ka kryer aktivitet ekonomik dhe nuk ka realizuar të ardhura.

Shoqëria target, PHARMA ONE SHPK, është e angazhuar në tregtimin me shumicë dhe pakicë të barnave dhe pajisjeve mjekësore dhe artikujve farmaceutikë, lëndëve të para, aksesorë, para farmaceutike, tregtimin dhe import-eksportin e mallrave të ndryshme, si pajisje mjekësore industriale e artikujve të ndryshme, elektrike, mekanike, elektronike, cigare të të gjitha llojeve, industriale, ushqimore, të ndërtimit, të mediave, të mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit etj.

Shoqëria operon në tregun e shitjes me shumicë të barnave, si një depo sekondare, e cila blen produktet nga të gjithë depot primare (importues) dhe i shet në rrjetin e shitjes me pakicë (farmacitë) dhe gjithashtu ka kontrollit e shoqërisë DELTA MED SHPK, depo sekondare dhe Albhealth SHPK, farmaci.

Në tregun e shitjes me shumicë të barnave operojnë ndërmarrje të licencuara për import barnash (depo primare) dhe ndërmarrje të cilat kryejnë distribucionin e barnave (depo sekondare) drejt farmacive të rrjetit të hapur (tregti me pakicë).

Referuar të dhënave të importit të barnave na rezulton se importi i barnave realizohet nga një numër shumë i madh subjektsh importuese, (rreth 140 subjekte) ku ndërmarrjet me pjesën më të madhe të tregut janë “Rejsi Farma” me XX% të tregut, “Delta Pharma- AL” me XX% dhe “Intermed” me XX%. Tregu karakterizohet nga indikatorë të ulët të përqendrimit.

Ndërmarrjet pjesë e transaksionit, apo të lidhura me transaksionin, evidentohen të jenë EVITA me XX% të tregut, PHARMA ONE me XX% dhe pjesa e kombinuar e tregut e të dyjave është XX%.

Nga analiza e mësipërme, u evidentua se shoqëria target, PHARMA ONE SHPK, operon në tregun e shitjes me shumicë të barnave, por me një integrim vertikal në të gjitha nivelet e tregtimit të barnave.

Shoqëria blerëse MED LAB SHPK është licencuar për shitje-blerje të pajisjeve mjekësore e laboratorike, investime në fushën e laboratorëve mjekësore; import, eksport, tregtim me shumicë e pakicë, montim e riparim i aparaturave laboratorike mjekësore etj, por nuk ka patur aktivitet ekonomik.

Referuar Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate”, konstatohet se transaksioni i shitblerjes së 33.34% të kapitalit të shoqërisë “Pharma One” SHPK”

nga MED LAB SHPK përbën një përqendrim konglomerat, pasi përqendrimet konglomerate ndodhin kur ndërmarrjet që marrin pjesë në përqendrim nuk kanë as marrëdhënie horizontale (si konkurrentë në të njëjtin treg përkatës) dhe as vertikale (si prodhues edhe klientë). Palët në transaksion operojnë në tregje të ndryshme.

Referuar analizës së strukturave të tregut dhe tregjeve të prekura nga transaksioni, konstatohet se tregu i barnave dhe tregu i pajisjeve mjekësore mund të konsiderohen si tregje të lidhura për një tipologji të kufizuar të barnave, kryesisht për barnat parafarmaceutike apo materiale paramjekësore.

Shoqëria MED LAB SHPK nuk ka kryer asnjëherë aktivitet ekonomik dhe blerja e kuotave në shoqërinë PHARMA ONE SHPK nuk do të sjellë asnjë ndryshim në aktivitetin ekonomik të targetit, si dhe fuqinë e tij në tregun përkatës.

Pjesa e vogël e tregut të shoqërive të lidhura, PHARMA ONE SHPK dhe EVITA SHPK në importin e barnave (rreth XX%), si dhe pjesa shumë e vogël e tregut të targetit në shpërndarjen e barnave (depo sekondare), nuk pritet të sjellë efekte antikonkurrese në tregun e barnave në të ardhmen.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje midis aktiviteteve të palëve (blerës dhe target) në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në strukturat e tregut.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë Med Lab SHPK, Evita SHPK dhe FARMACOM SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 1116, Datë 11. 10. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË HORIZON SHPK NGA Z. ERMAL BEQIRI.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 10. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë HORIZON SHPK nga Z. Ermal Beqiri.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, “Udhëzimi “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë HORIZON SHPK nga Z. Ermal Beqiri,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë HORIZON SHPK nga Z. Ermal Beqiri.

Referuar dokumentit “Kontratë shitje e kuotave të kapitalit” të nënshkruar më datë 19 prill 2024, palët në marrëveshje janë:

Pala Blerëse: Z. Ermal Beqiri, shtetas shqiptar.

Në nenin 10 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” është parashikuar se një përqendrim ndodh kur kemi një ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit, si rrjedhojë e:b) përfimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrje tjetër.....

Gjithashtu referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, në paragrafin 9 citohet se: *Kontrolli mund të përftohet nga një person në rrethanat ku ky person tashmë kontrollon (ose veçmas ose bashkërisht) të paktën një ndërmarrje tjetër ose ndryshe, nga një kombinim i personave (të cilët kontrollojnë një ndërmarrje tjetër) dhe ndërmarrjeve.*

Referuar Formularit të thjeshtuar të njoftimit të përqendrimit, Z. Ermal Beqiri zotëron 100% të shoqërive SOFT & SOLUTION SHPK; R&D Solution SHPK; IMO Solution SHPK; Nsolution SHPK; AL SOFT SHPK (Shoqëria është në likuidim e sipër); 5 min.al SHPK (Shoqëria është me status “Pezulluar”), si dhe 50% të shoqërive AL-FORENSIC SHPK (Shoqëria është me status “Pezulluar”) dhe ALB-RED STONE SHPK (Shoqëria është me “Urdhër për sekuestro konservative”).

Për këto arsye, ky transaksion bëhet objekt kontrolli nga Autoriteti i Konkurrencës.

Vetëm shoqëritë SOFT & SOLUTION SHPK dhe Nsolution SHPK kanë patur aktivitet dhe kanë realizuar të ardhura në vitet e fundit.

SOFT & SOLUTION SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: zhvillim, implementim dhe mirëmbajtje të sistemeve dhe programeve në fushën e teknologjisë së informacionit; projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje në fushën e telekomunikacionit si rrjete WAN/LAN, sisteme sigurie web-site, etj.; shërbim akses interneti; shërbime konsulence dhe trajnime profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit dhe telekomunikacionit; shërbime të dizenjimit, printimit, publikimit, botimit dhe prodhime të ndryshme të shtypshkrimit, etj.

Nsolution SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Shërbime në fushën e telekomunikacioneve, rrjeteve kompjuterike, internetit, sistemeve audio e video, programeve kompjuterike; shërbime specifike të shpërndarjes kabllore e valore të shërbimeve të përcaktuara në pikën a) si dhe kanaleve televizive; projektim, vlerësim, konsulencë monitorim të sistemeve teknologjike të telekomunikacionit dhe informatike; import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, pajisje për klinika mjekësore, pajisje elektronike, elektrike, informatike, elektroshtëpiake, pajisje ventilimi dhe kondicionimi.

Pala Shitëse: Comscope Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Qipros.

Shoqëria Target: HORIZON SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Veprimtari në fushën e teknologjisë, duke ofruar krijim dhe integrim të sistemeve të informacionit për shoqëri dhe individë; zgjidhje, shërbime mbështetëse; import-eksport, si dhe shitje të pajisjeve informatike, produkte hardware dhe software, programe në tregun vendas dhe atë të huaj; konsulencë dhe mirëmbajtje të shoqëruara me kurse, trajnime profesionale, si dhe çdo aktivitet tjetër i konsideruar fitimprurës dhe në interes

të shoqërisë.

Para transaksionit, shoqëria target HORIZON SHPK zotërohej X% nga shoqëria Comscope Limited.

II. Transaksioni

Më datë 19 prill 2024, është nënshkruar “Kontratë shitje e kuotave të kapitalit”, ndërmjet Z. Ermal Beqiri në cilësinë e blerësit dhe shoqërisë Comscope Limited në cilësinë e shitësit. Referuar kësaj kontrate, shitësi i shet blerësit 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë HORIZON SHPK, kundrejt shpërblimit të caktuar në këtë kontratë.

Në përfundim të transaksionit, z. Ermal Beqiri do të zotërojë plotësisht shoqërinë HORIZON SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i teknologjisë së informacionit. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i teknologjisë së informacionit

Tregu i teknologjisë së informacionit përfshin një tërësi produktesh digjitale ose teknologjike, të cilat shpesh integrohen në sisteme më të gjera duke ndërvepruar me njëri-tjetrin, ose nëpërmjet ofrimit mes një morie shërbimesh të lidhura mes tyre. Shërbimet digjitale shpesh ofrohen në platforma shumë-palëshe, potencialisht të kontrolluara nga kompanitë që kanë një rol të dyfishtë si ndërmjetëse dhe konkurrencte në këto platforma. Këto shërbime nuk kanë kufij gjeografikë fiks dhe të mirë përcaktuar.

Transaksionet në tregjet digjitale dhe teknologjike përfshijnë raste të përqendrimeve horizontale, vertikale dhe konglomerate. Pjesa më e madhe e përqendrimeve janë raste konglomerate, pasi produktet në hapësirën digjitale dhe teknologjike, duke përfshirë komponentë si të softuerit dhe të harduerit, janë produkte plotësuese, të cilët ndërveprojnë me njëri-tjetrin si pjesë e një sistemi më të gjerë.¹

Dy produktet/shërbimet kryesore të tregut të teknologjisë së informacionit janë **softueri dhe hardueri**.

Softueri është një set instruksionesh, të dhënash ose programesh që përdoren në funksion të

¹ Burimi: Merger Enforcement in Digital and Tech Markets: An Overview of the European Commission’s Practice.

kompjuterit, i cili ndahet në 2 kategori kryesore:

1. Softuer aplikacioni (application software), i cili kryen detyra specifike për përdoruesit.
2. Softuer sistemi (systems software) është projektuar për të drejtuar harduerin e një kompjuteri dhe ofron një platformë për aplikacionet që do të funksionojnë mbi të.

Lloje të tjera të softuerit përfshijnë: Programimi i softuerit, i cili siguron mjetet e programimit që zhvilluesit e softuerit kanë nevojë; Middleware, i cili qëndron midis softuerit të sistemit dhe aplikacioneve dhe Driver software, i cili operon në pajisje kompjuterike dhe periferi.

Edhe pse të gjithë softuerët ofrojnë instruksionet dhe të dhënat për të cilët kompjuterët kanë nevojë për të funksionuar dhe përmbushur kërkesat dhe nevojat e përdoruesve, ka ndryshim mbi mënyrën se si funksionon secili prej tyre.

Hardueri përfshin pjesët fizike të një kompjuteri, të tilla si njësia qendrore e përpunimit (CPU), memoria e aksesit të rastësishëm (RAM), motherboard, magazinimi i të dhënave kompjuterike, karta grafike, karta e zërit dhe rasti kompjuterik. Ai përfshin pajisje të jashtme të tilla si një monitor, mi, tastierë dhe altoparlantë.

Softueri është grupi i udhëzimeve që mund të ruhen dhe të drejtohen nga hardueri. Hardueri zakonisht drejtohet nga softueri për të ekzekutuar çdo komandë ose instruksion. Një kombinim i harduerit dhe softuerit formon një sistem kompjuterik të përdorshëm, edhe pse sisteme të tjera ekzistojnë vetëm me harduer.

Për sa më sipër, produktet harduer dhe shërbimet softuer janë plotësues për shkak të karakteristikave dhe qëllimit të përdorimit.

Referuar dokumentacionit të depozituar, konstatohet se shoqëria SOFT & SOLUTION SHPK ofron shërbime informatike dhe zhvillim të softuerëve.

Disa prej projekteve të realizuara nga SOFT & SOLUTION SHPK janë: Sistemi HuRes (Human Resources System); AME (Accounting Made Easy); M-DC (Management of Debt Collection); SMT-SS (Sistemi i Menaxhimit të Tenderave); AGS (Adress Geo System); M-Assets (Management of Assets); Live Track, etj.

Ndërkohë, shoqëria HORIZON SHPK realizon mirëmbajtjen e pajisjeve harduer (servera, etj.). Produktet dhe shërbimet që ofrohen prej saj janë: Mbështetje dhe mirëmbajtje harduer; Implementim dhe integrim; Rekuperim të dhënash dhe Trajnime.

Disa prej zgjidhjeve të ofruara nga HORIZON SHPK janë: Ambienti i Desktop-it Virtual (Mbështetur në Server); Qendra Telefonike; POS – Retail; Fatura Elektronike; Backup & Storage.

HORIZON SHPK ka një staf të përqendruar në infrastrukturën teknologjike dhe jo në zhvillimin e softuerit, duke përfshirë teknikë dhe inxhinierë të fokusuar në mirëmbajtje dhe instalime harduer, jo programues apo zhvillues softueri.

Nga sa më sipër, konstatohet se shoqëria SOFT & SOLUTION SHPK ofron shërbime softuerike, përfshirë zhvillimin e aplikacioneve dhe sistemeve informatike, ndërsa HORIZON SHPK është një shoqëri që ka si objekt kryesor mirëmbajtjen e pajisjeve harduer, përfshirë mirëmbajtjen e serverëve dhe pajisjeve të tjera fizike.

Shoqëritë SOFT & SOLUTION SHPK dhe HORIZON SHPK operojnë në segmente të ndryshme të zinxhirit të teknologjisë së informacionit ku produktet dhe shërbimet e ofruara prej tyre janë plotësuese të njëra – tjetrës dhe ndërveprojnë si pjesë e një sistemi më të gjerë.

Sa më sipër, transaksioni i propozuar do të klasifikohet si një përqendrim konglomerat.

Sipas Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate”, përqendrimet konglomerate ndodhin kur ndërmarrjet që marrin pjesë në përqendrim nuk kanë as marrëdhënie horizontale (si konkurrentë në të njëjtin treg përkatës) dhe as vertikale (si prodhues edhe klientë).

Përqendrimet jo-horizontale në përgjithësi, kanë më pak mundësi për të kufizuar ndjeshëm konkurrencën efektive sesa përqendrimet horizontale, pasi ndryshe nga përqendrimet horizontale, përqendrimet vertikale dhe konglomerate nuk shkaktojnë humbjen e konkurrencës direkt ndërmjet ndërmarrjeve pjesëmarrëse në një përqendrim që veprojnë në të njëjtin treg përkatës. Përqendrimet vertikale dhe konglomerate sigurojnë mundësi reale për eficientat. Një karakteristikë e përqendrimeve vertikale dhe atyre konglomerate është që veprimtaritë ekonomike dhe/ose produktet e ndërmarrjeve pjesëmarrëse, janë plotësuese të njëra-tjetrës.

Nga sa deklaron pala njoftuese, blerja e HORIZON SHPK, si një kompani e specializuar në mirëmbajtjen harduer, nga ortaku i vetëm i SOFT & SOLUTION SHPK, ofron mundësinë për të ofruar një zinxhir të plotë shërbimesh teknologjike për klientët e saj. Ky transaksion mund të ketë përfitime ekonomike për konsumatorët. Meqenëse shërbimet e softuerit dhe mirëmbajtja harduer do të jenë pjesë e një grupi të përbashkët, kjo mund të sjellë paketa të integruara dhe të harmonizuara për klientët, me kosto më të ulëta dhe mbulim më të gjerë të nevojave teknologjike.

Efektet në konkurrencën e tregut

Në vlerësimin e efekteve të konkurrencës në një përqendrim, Autoriteti krahason kushtet e konkurrencës që mund të rezultojnë nga përqendrimi i njoftuar, me kushtet që mbizotëronin para realizimit të përqendrimit. Përqendrimet jo-horizontale nuk përbëjnë një kërcënim për konkurrencën efektive, vetëm nëse njësia e përqendruar ka një shkallë jo të konsiderueshme të fuqisë në treg në të paktën një nga tregjet përkatëse, por kjo nuk do të thotë se njësia e përqendruar duhet të ketë pozitë dominuese.

Pjesët e tregut dhe nivelet e përqendrimit sigurojnë treguesit e parë të nevojshëm të fuqisë së tregut dhe rëndësisë së konkurrencës, si të palëve pjesëmarrëse në përqendrim ashtu edhe të konkurrentëve të tyre.

Referuar të dhënave të depozituara nga Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve mbi të ardhurat e

realizuara për vitin 2022 dhe 2023 nga subjektet e licencuara në tregun e teknologjisë së informacionit, rezulton se **prodhimi i programeve kompjuterike** përfshin: aktivitete të programimit informatik, aktivitete të menaxhimit të instalimeve informatike dhe shërbime të tjera të teknologjisë së informacionit, ku përfshihet një numër shumë i madh ndërmarrjesh dhe secila prej tyre zë një pjesë shumë të vogël tregu.

Shoqëritë SOFT & SOLUTION SHPK dhe HORIZON SHPK zënë një pjesë të vogël tregu, përkatësisht shoqëria SOFT & SOLUTION SHPK zë X% të tregut për vitin 2022 dhe X% për vitin 2023, ndërsa shoqëria HORIZON SHPK zë X% të tregut për vitin 2022 dhe X% për vitin 2023.

Pas realizimit të transaksionit të njoftuar, shoqëritë SOFT & SOLUTION SHPK dhe HORIZON SHPK zënë së bashku X% të tregut për vitin 2023, duke zotëruar përsëri një pjesë të vogël tregu dhe treguesi i përqendrimit HHI është shumë i ulët (HHI është X për vitin 2023). Edhe pas realizimit të transaksionit, HHI vazhdon të jetë në nivelin e një tregu me përqendrim të ulët.

Bazuar në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate”, Autoriteti e ka të pamundur të zbulojë probleme në përqendrimet jo horizontale, qofshin këto efekte koordinuese apo jo koordinuese, ku pjesët e tregut të hyrësve të rinj pas përqendrimit në secilin nga tregjet në fjalë, është nën X% dhe HHI pas përqendrimit është nën X.

Blerja e HORIZON SHPK nga ortaku i vetëm i SOFT & SOLUTION SHPK nuk e kufizon konkurrencën në tregun e teknologjisë së informacionit në Shqipëri. Asnjëra prej shoqërive të tjera të zotëruara nga Z. Ermal Beqiri nuk operon në tregun e teknologjisë së informacionit. Shoqëritë SOFT & SOLUTION SHPK dhe HORIZON SHPK operojnë në segmente të ndryshme të tregut të teknologjisë së informacionit (mirëmbajtje harduer dhe shërbime softuerike). Nuk ka mbivendosje të produkteve dhe shërbimeve të ofruara prej tyre. Gjithashtu pjesa e tregut që zënë këto shoqëri para dhe pas realizimit të përqendrimit është shumë e vogël dhe treguesi HHI është nën X. Asnjëra prej shoqërive nuk ka fuqi tregu për të sjellë kufizime të konkurrencës.

Për sa më sipër, transaksioni i njoftuar nuk pritet të sjellë ndikim në konkurrencën në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë HORIZON SHPK nga Z. Ermal Beqiri.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1117, Datë 11. 10. 2024

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET
PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DELTA MED SHPK NGA
SHOQËRIA PHARMA ONE SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.10. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet Përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria Evita SHPK dhe Z. Ben Petani; Përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe Z. Ben Petani dhe Përfimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK, nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me Marrëveshjen për Shit-blerjen e Kuotës, datë 19.04.2024, lidhur ndërmjet shoqërisë “MED LAB” SHPK dhe z. Ben Petani, për shit-blerjen e Kuotës që përfaqëson 33.34% (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e katër përqind) të kapitalit të shoqërisë “Pharma One” SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga pala njoftuese si dhe informacionit të marrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Autoriteti i Konkurrencës konstatoi se shoqëria PHARMA ONE SHPK është përfshirë në disa transaksione të panjofituara.

Me qëllim vlerësimin e ndikimeve në treg që mund të kenë sjellë transaksionet e ndryshimit të kontrollit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK në tregun e barnave, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 1081, datë 24.05.2024 “Mbi pezullimin e afateve të procedurës së kontrollit të përqendrimeve për transaksionin e përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë MED LAB SHPK, EVITA SHPK dhe FARMACOM SHPK dhe fillimin e procedurës së kontrollit për transaksionet e pa njoftuara”, vendosi pezullimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve për transaksionin e shit-blerjes së Kuotës që përfaqëson 33.34 % të kapitalit të shoqërisë “Pharma One” SHPK dhe fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria PHARMA ONE SHPK, pjesë e vendimit.

Në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës, shoqëria PHARMA ONE SHPK me shkresat nr. 125/18 prot., datë 30.09.2024 “Formulari i thjeshtuar i njoftimit të përqendrimeve”, dorëzoi dokumentacionin e parashikuar në rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” dhe Sekretariati filloi procedurat e kontrollit të përqendrimeve.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

Blerësi: PHARMA ONE SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Angazhuar në fushën e tregtisë ku do të kryejë tregtimin me shumicë dhe pakicë të barnave dhe pajisjeve mjekësore dhe artikujve farmaceutikë, lëndëve të para, aksesore, para farmaceutike, tregtimin dhe import-eksportin e mallrave të ndryshme si pajisje mjekësore industriale e artikujve të ndryshme, elektrike, mekanike, elektronike, cigare të të gjitha llojeve, industriale, ushqimore, të ndërtimit, të mediave, të mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit, të makinerive, të metaleve ferroke dhe joferroke, të lëndës drusore, të lëndëve të para dhe të përpunuara për procesin e prodhimit, tregtimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, shitblerjen e tokës, tregtimin e mallrave të gatshëm e gjysmë të gatshëm, etj.

Shoqëria zotërohej nga shoqëria Evita dhe z.Ben Petani, në masën 50 % të kapitalit secili.

Shitësi: Eduard Curraj dhe **Dorian Sadiku**, shtetas shqiptar, zotërues të 1 kuotë të barabartë me 50% të kapitalit fillestar të shoqërisë DELTA Med SHPK, secili.

Shoqëria Target: Shoqëria DELTA Med SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Tregtim të artikujve farmaceutikë dhe kozmetikë, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligji. Distributor dhe shpërndarës i barnave dhe medikamenteve mjekësore. Import, eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të barnave dhe medikamenteve mjekësore, barnave popullore, pajisjeve dhe aparaturave mjekësore, mjeteve dhe materialeve ndihmëse mjekësore. Import, eksport tregtim me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm kozmetikë. Import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm industriale, elektroshtëpiake, elektrike e elektronike, pajisjeve informatike, artikuj kinkalerie,

bizhuteri, suvenire, artikuj mobilerie, prodhim dhe tregtim artikuj duralumini, pajisjeve të kondicionimit dhe ajrimin e aksesorëve të tyre. Import eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë të materialeve të ndërtimit, pjesëve të këmbimit për automjete, tregtim me pakicë të karburanteve dhe vajra lubrifikante.

II. Transaksioni

Me datë 27 shkurt 2020, shoqëria PHARMA ONE SHPK (blerësi), Eduard Curraj (shitësi 1), znj. Marjana Curraj (dhënësjë e pëlqimit për shitësin 1), Dorian Sadiku (shitësi 2) dhe znj. Jorida Jubani (dhënësjë e pëlqimit për shitësin 2), kanë nënshkruar “Kontratë shitje e kuotave të kapitalit” të shoqërisë DELTA Med SHPK.

Qëllimi i kësaj kontrate ka qenë transferimi i pronësisë kundrejt pagesës, të Kuotave të Kapitalit Themeltar të shoqërisë DELTA Med SHPK, që zotërojnë shitësit në favor të blerësit. Kjo kontratë shërben për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrave të transferimit të kësaj pronësie, si dhe pagesat përkatëse në lidhje me këtë transferim.

Referuar kësaj kontrate, shitësit detyrohen t’i japin dhe t’i kalojnë blerësit 100% të Kuotave të Kapitalit Themeltar që ata zotërojnë tek shoqëria DELTA Med SHPK, secili nga 50% të pjesëve të kapitalit që zotërojnë.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria DELTA Med SHPK do të zotërohet 100% nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

Transaksioni i realizuar përbënte përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pasi jemi përpara faktit të përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

Në zbatim të nenit 53 të ligjit, përfutimi i kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria PHARMA ONE SHPK nuk është njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit, edhe në këtë transaksion, do të konsiderohet tregu i shitjes së barnave dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Referuar formularit të njoftimit të përqendrimit, shoqëria PHARMA ONE SHPK ka kryer një vlerësim të tregut dhe madhësisë së tij për vitin 2019, nga ku konstatohet se shoqëritë PHARMA ONE SHPK dhe Evita SHPK kanë zotëruar në vitin 2019 rreth XX % të tregut të shitjes së barnave, ndërkohë që shoqëria DELTA MED SHPK ka zotëruar rreth XX% të tregut të shitjes me shumicë të barnave, por e fokusuar në tregtimin e tyre në qytetin e Shkodrës.

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim horizontal, pasi pala blerëse dhe shoqëria target

operojnë në të njëjtin treg përkatës. Për shkak të pjesës së vogël të tregut të shoqërisë target, vlerësojmë se transaksioni nuk përbën shqetësim për konkurrencën pasi nuk shfaq shenja të krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria PHARMA ONE SHPK, me datë 27 shkurt 2020.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1118, Datë 11. 10. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË PHARMA ONE SHPK, NGA SHOQËRIA EVITA SHPK DHE Z. BEN PETANI”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 10. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria EVITA SHPK dhe z. Ben Petani.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet Përfimit i kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria Evita SHPK dhe Z. Ben Petani; Përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe Z. Ben Petani; dhe Përfimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK, nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me Marrëveshjen për Shit-blerjen e Kuotës, datë 19.04.2024, lidhur ndërmjet shoqërisë “MED LAB” SHPK dhe z. Ben Petani për shit-blerjen e Kuotës që përfaqëson 33.34% (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e katër përqind) të kapitalit të shoqërisë “Pharma One” SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga pala njoftuese si dhe informacionit të marrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Autoriteti i Konkurrencës konstatoi se shoqëria PHARMA ONE SHPK është përfshirë në disa transaksione të panjoftuara.

Me qëllim vlerësimin e ndikimeve në treg që mund të kenë sjellë transaksionet e ndryshimit të kontrollit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK në tregun e barnave, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 1081, datë 24.05.2024 “Mbi pezullimin e afateve të procedurës së kontrollit të përqendrimeve për transaksionin e përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë MED LAB SHPK, EVITA SHPK dhe FARMACOM SHPK dhe fillimin e procedurës së kontrollit për transaksionet e pa njoftuara”, vendosi pezullimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve për transaksionin e shit-blerjes së Kuotës që përfaqëson 33.34 % të kapitalit të shoqërisë “Pharma One” SHPK dhe fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria EVITA SHPK dhe z. Ben Petani, pjesë e vendimit.

Në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës, shoqëria Evita SHPK me shkresat nr. 125/19 prot., datë 30.09.2024 “Formulari i thjeshtuar i njoftimit të përqendrimeve”, dorëzoi dokumentacionin e parashikuar në rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” dhe Sekretariati filloi procedurat e kontrollit të përqendrimeve.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

Blerësi: Evita SHPK është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: Import-eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të produkteve farmaceutike, kozmetike, bimëve medicinale, instrumentave dhe pajisjeve shëndetësore dhe medicinale, sanitare, shtesa ushqimore dhe dietike. Import, eksport, tregtim me shumicë, montim dhe riparim i aparaturave dhe pajisjeve mjekësore, impianteve dhe aksesorëve të tyre etj.

Shoqëria zotërohet nga z.Ertel Kërçuku në masën 27.50% të kapitalit dhe nga shoqëria Arimo B.V në masën 72,50% të kapitalit të shoqërisë.

Sipas të dhënave të QKB, shoqëria Evita SHPK në vitin 2018, ishte zotëruese e 85% të kuotave në shoqërinë:

- **DiaVita SHPK** një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Zbatimi i Kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat "Për Shërbimin e Hemodializës pranë spitaleve rajonale në Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë dhe Elbasan". Shoqëria e zhvillon aktivitetin në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me statutin e saj, në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Shoqëria mund të krijojë filiale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje edhe me legjislacionin e vendit përkatës².

² Gjatë vitit 2019, shoqëria ndryshoi kontrollin dhe Autoriteti i Konkurrencës vlerësoi transaksionin e njoftuar nga palët. Komisioni i Konkurrencës me vendimin e nr. 648, datë 19.09.2019 “Për mos klasifikimin si përqendrim të

Ortaku i shoqërisë Evita SHPK, Arimo B.V, është shoqëri aksionare e regjistruar në Hollandë, e cila aktualisht zotëron kuota në shoqërinë Farmacom SHPK dhe në shoqërinë Equos Resort SHPK.

Shitësi: Z. Ben Petani, shtetas shqiptar, zotërues në masën 100% të kapitalit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, në vitin 2018.

Sipas të dhënave të QKB, gjatë vitit 2018, z. Petani ishte zotërues i kuotave në shoqëritë: - **Winpharma SHPK**, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprim apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar. -**FAMO GROUP SHPK**, shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Tregtimi me shumicë dhe pakicë, import eksport i produkteve farmaceutike, aksesorëve dhe mjeteve spitalore, materiale të mjekimit, si dhe të produkteve gjysmë të gatshme farmaceutike, etj. -**ALMOND CONSTRUCTION SHPK**, shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit , për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të veprave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi publik dhe/ose privat si: ndërtimin e ndërtesave publike dhe private, rrugëve, etj. - **Alb-Farm SHPK** është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Tregtimi me shumicë e pakicë i barnave, ilaceve, bimëve mjekësorë, për njerëzit dhe për kafshët, import eksport i tyre dhe i lëndës së parë si dhe i ilaceve të gatshme dhe gjysmë të gatshme, prodhimi i tyre dhe shitblerja, etj

Shoqëria target: PHARMA ONE SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: Angazhuar në fushën e tregtisë ku do të kryejë tregtimin me shumicë dhe pakicë të barnave dhe pajisjeve mjekësore dhe artikujve farmaceutikë, lëndëve të para, aksesorë, para farmaceutike, tregtimin dhe import-eksportin e mallrave të ndryshme si pajisje mjekësore industriale e artikujve të ndryshme, elektrike, mekanike, elektronike, cigare të të gjitha llojeve, industriale, ushqimore, të ndërtimit, të mediave, të mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit, të makinerive, të metaleve ferroke dhe joferroke, të lëndës drusore, të lëndëve të para dhe të përpunuara për procesin e prodhimit, tregtimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, shitblerjen e tokës, tregtimin e mallrave të gatshëm e gjysmë të gatshëm, etj.

II. Transaksioni

Më datë 25 qershor 2018, ndërmjet shoqërisë Evita SHPK (blerësi) z. Ben Petani (shitësi) dhe znj. Xhuljeta Petani (Dhënëse Pëlqimi e Shitësit), është nënshkruar “Kontratë për shit-blerjen e kuotës”.

njoftimit mbi përfundimin e kontrollit të shoqërisë DiaVita SHPK nga shoqëria Diaverum International AB dhe dhënien e rekomandimeve Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”

Referuar kësaj kontrate, shitësi i ka shitur blerësit kuotën e tij, e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK (shoqëria target).

Në përfundim të transaksionit, shoqëria target PHARMA ONE SHPK zotërohej 50% nga z. Ben Petani dhe 50% nga shoqëria Evita SHPK. Kontrata e nënshkruar nga palët ka sjellë për pasojë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga kontroll i vetëm në kontroll të përbashkët.

Transaksioni i realizuar përbën përqendrim në kuptim të nenit 10 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pasi jemi përpara faktit të përfundimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria Evita SHPK dhe z. Ben Petani.

Në zbatim të nenit 53 të ligjit, përfundimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nuk është njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III. Analiza e konkurrencës

Vlerësimi i konkurrencës është bërë ex-post duke u mbështetur mbi treguesit ekonomik të palëve për vitin 2017.

Transaksioni i përfundimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga Z. Petani dhe shoqëria Evita, nëpërmjet blerjes së 50% të kuotave nga kjo e fundit, klasifikohet si një përqendrim horizontal pasi palët në transaksion operojnë në të njëjtin nivel tregtimi.

Referuar Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, analiza e konkurrencës për këto raste fillon me përcaktimin e tregut përkatës si dhe efektet e mundshme antikonkurrese.

Aktiviteti kryesor i shoqërive Evita SHPK dhe PHARMA ONE SHPK ka qenë importi dhe tregtimi me shumicë i barnave. Shoqëria Evita SHPK është e licensuar me licensen LN-6569-06-2013 “Tregtimi me shumicë i barnave”, ndërkohë që shoqëria Pharma One SHPK është licensuar me licensen LN-5833-11-2012 dhe LN-3459-05-2011 “Tregtimi me shumicë i barnave”.

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, Tregu përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shitjes së barnave dhe Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Për efekt të vlerësimit të strukturës së tregut dhe fuqisë ekonomike të ndërmarrjeve pjesëmarrëse në transaksion, analiza e strukturës së tregut është realizuar mbi vlerën e barnave të tregtuara nga shoqëritë pjesëmarrëse në përqendrim.

Referuar formularit të njoftimit të përqendrimit, shoqëria Evita SHPK ka kryer një vlerësim të tregut dhe madhësisë së tij për vitin 2017, nga ku rezulton se Evita SHPK ka zotëruar në vitin 2017 rreth XX % të tregut të shitjes së barnave, ndërkohë që shoqëria PHARMA ONE SHPK, zotëronte XX % të tij.

Pjesa e tregut të shitjes së barnave nga dy shoqëritë e prekura nga transaksioni ka qenë rreth XX %, e cila nuk ngre shqetësime për konkurrencën në treg, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese. Dy shoqëritë vazhdojnë të funksionojnë si njësi ekonomike te pavaruara.

Legjislacioni për barnat dhe shërbimin farmaceutik, ka të rregulluar mënyrën e importit/prodhimit dhe tregtimit të barnave si dhe përcaktimin e marzhit të ndryshimit të çmimit dhe përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë të tyre. Këto mekanizma e bëjnë të vështirë koordinimin e ndërmarrjeve për shkelje të mundshme të konkurrencës sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit.

Nga sa më sipër, konstatohet se përfitimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria Evita SHPK dhe Z. Ben Petani, nëpërmjet blerjes së 50 % të kuotave nga Evita SHPK nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin nëpërmjet përfitimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria EVITA SHPK dhe z. Ben Petani, më datë 25 qershor 2018.
 2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1119, Datë 11. 10. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË PHARMA ONE SHPK, NGA SHOQËRITË EVITA SHPK, FARMACOM SHPK DHE Z. BEN PETANI.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 10. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe z. Ben Petani.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet Përfimit i kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria Evita SHPK dhe Z. Ben Petani; Përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe Z. Ben Petani; dhe Përfimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK, nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me Marrëveshjen për Shit-blerjen e Kuotës, datë 19.04.2024, lidhur ndërmjet shoqërisë “MED LAB” SHPK dhe z. Ben Petani për shit-blerjen e Kuotës që përfaqëson 33.34% (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e katër përqind) të kapitalit të shoqërisë “Pharma One” SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga pala njoftuese si dhe informacionit të marrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Autoriteti i Konkurrencës konstatoi se shoqëria PHARMA ONE SHPK është përfshirë në disa transaksione të panjoftuara.

Me qëllim vlerësimin e ndikimeve në treg që mund të kenë sjellë transaksionet e ndryshimit të kontrollit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK në tregun e barnave, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 1081, datë 24.05.2024 “Mbi pezullimin e afateve të procedurës së kontrollit të përqendrimeve për transaksionin e përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë MED LAB SHPK, EVITA SHPK dhe FARMACOM SHPK dhe fillimin e procedurës së kontrollit për transaksionet e pa njoftuara”, vendosi pezullimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve për transaksionin e shit-blerjes së Kuotës që përfaqëson 33.34 % të kapitalit të shoqërisë “Pharma One” SHPK dhe fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe z. Ben Petani.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

Blerësi: FARMACOM SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: Mjekësorë, import, eksport, tregëtim me shumicë e pakicë, montim e riparim i aparaturave laboratorike mjekësore, etj. Invenstime, shërbime e projekte në fushën e mjekësisë e laboratorëve mjekësorë. Ndërmarrja e nismave, veprimeve, aktiviteteve e pjesëmarrjes në iniciativa të ndryshme konçesionare, privatizimi apo tenderimi. Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër plotësues dhe ndihmës që ka si qëllim ofrimin e çdo shërbimi tjetër, në rast se rezultojnë të dobishme dhe/ose të nevojshme për përmbushjen e objektit kryesor, si dhe çdo aktivitet tjetër që konsiderohet fitimprurës dhe në interes të shoqërisë pa u kufizuar në objektin e mësipërm të veprimtarisë.

Sipas të dhënave të Statutit të shoqërisë FARMACOM SHPK, Ortaku z.Ertel Kërçuku në vitin 2020, ishte zotërues i 100% të kuotave në shoqërinë blerëse.

Shitësi 1: Z. Ben Petani është shtetas shqiptar, zotërues i 50% i kuotave në shoqërinë target.

Shitësi 2: Evita SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Import-eksport dhe tregëtim me shumicë dhe pakicë të produkteve farmaceutike, kozmetike, bimëve medicinale, instrumentave dhe pajisjeve shëndetësore dhe medicinale, sanitare, shtesa ushqimore dhe dietike. Import, eksport, tregëtim me shumicë, montim dhe riparim i aparaturave dhe pajisjeve mjekësore, impianteve dhe aksesoreve të tyre etj, zotërues i 50% i kuotave në shoqërinë target

Shoqëria Target: PHARMA ONE SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Angazhuar në fushën e tregtisë ku do të kryejë tregëtimin me shumicë dhe pakicë të barnave dhe pajisjeve mjekësore dhe artikujve farmaceutikë, lëndëve të para, aksesorë, para farmaceutike, tregëtimin dhe import-eksportin e mallrave të

ndryshme si pajisje mjekësore industriale e artikujve të ndryshme, elektrike, mekanike, elektronike, cigare të të gjitha llojeve, industriale, ushqimore, të ndërtimit, të mediave, të mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit, të makinerive, të metaleve ferroke dhe joferroke, të lëndës drusore, të lëndëve të para dhe të përpunuara për procesin e prodhimit, tregtimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, shitblerjen e tokës, tregtimin e mallrave të gatshëm e gjysmë të gatshëm, etj.

II. Transaksioni

Më datë 06 mars 2020 ndërmjet shoqërive FARMACOM SHPK (blerësi), z. Ben Petani (shitësi 1), Evita SHPK (shitësi 2), znj. Xhulieta Petani (dhënësjë e pëlqimit për shitësin 1), është nënshkruar “Kontratë Shitje e Kuotave të Kapitalit”.

Qëllimi i kësaj kontrate ka qenë transferimi i pronësisë kundrejt pagesës, të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë PHARMA ONE SHPK që zotërojnë shitësit në favor të Blerësit.

Shitësi, z.Petani, ka shitur 16.66% të kuotave të kapitalit themeltar që ai zotëron në shoqërinë PHARMA ONE SHPK dhe shoqëria Evita SHPK ka shitur 16.67% të kuotave të kapitalit themeltar që ajo zotëron në shoqërinë target.

Me regjistrimin e kësaj Marrëveshje në Qendrën Kombëtare të Biznesit, shoqëria PHARMA ONE SHPK përbëhet nga ortakët:-Z. Ben Petani zotërues i 33.34 % të pjesëve të kapitalit, -Shoqëria Evita SHPK zotëruese e 33.33 % të pjesëve të kapitalit dhe Shoqëria FARMACOM SHPK zotëruese e 33.33 % të pjesëve të kapitalit.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Në zbatim të nenit 53 të ligjit, përfitimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe z. Ben Petani nuk është njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si edhe analizës së rastit të përfitimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria Evita SHPK dhe z. Ben Petani, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shitjes së barnave. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i përfitimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe Z. Ben Petani, nëpërmjet blerjes së 33 % të kuotave nga shoqëria FARMACOM SHPK, përbën një përqendrim konglomerat, pasi pala

blerëse ka për objekt aktiviteti tregtim me shumicë e pakicë, montim e riparim i aparaturave laboratorike mjekësore, etj.

Pala blerëse, shoqëria FARMACOM SHPK, ka qenë një shoqëri e sapo krijuar dhe pa aktivitet në tregun e shitjes së barnave. Referuar formularit të njoftimit të përqendrimit, shoqëria FARMACOM SHPK ka kryer një vlerësim të tregut dhe madhësisë së tij për vitin 2019, nga ku rezulton se ndërmarrja PHARMA ONE SHPK dhe Evita SHPK kanë zotëruar në vitin 2019 rreth XX% të tregut të shitjes së barnave, ndërkohë që shoqëria FARMACOM SHPK nuk ka patur aktivitet.

Sipas pasqyrave financiare të shoqërisë FARMACOM SHPK, nxjerrë nga QKB, rezulton se shoqëria nuk ka realizuar të ardhura në vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023.

Për sa më sipër, ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe nuk do të ketë asnjë efekt në strukturën e tregut të barnave pasi pjesa e tregut që zotërojnë shoqëritë Evita SHPK dhe PHARMA ONE SHPK do të mbetet e pandryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe z. Ben Petani, më datë 06 mars 2020.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1120, Datë 11. 10. 2024

“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRISË FARMACOM SHPK, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË 33.33% TË KAPITALIT TË SHOQËRISË PHARMA ONE SHPK NGA SHOQËRIA FARMACOM SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim Kraja	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 10. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Shqyrtimi i sjelljes së shoqërisë FARMACOM SHPK, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 33.33% të kapitalit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK tek shoqëria FARMACOM SHPK.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, nenet 53, nenet 73 dhe 75 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet Përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria Evita SHPK dhe Z. Ben Petani, Përfutimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe Z. Ben Petani dhe Përfutimi i kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK, nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

VËREN SE :

I. Procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me Marrëveshjen për Shit-blerjen e Kuotës, datë 19.04.2024, lidhur ndërmjet shoqërisë “MED LAB” SHPK dhe z. Ben Petani për shit-blerjen e Kuotës që përfaqëson 33.34% (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e katër përqind) të kapitalit të shoqërisë “Pharma One” SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga pala njoftuese si dhe informacionit të marrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Autoriteti i Konkurrencës konstatoi se shoqëria PHARMA ONE SHPK është përfshirë në disa transaksione të panjoftuara.

Me qëllim vlerësimin e ndikimeve në treg që mund të kenë sjellë transaksionet e ndryshimit të kontrollit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK në tregun e barnave, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 1081, datë 24.05.2024 “Mbi pezullimin e afateve të procedurës së kontrollit të përqendrimeve për transaksionin e përfuturit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë MED LAB SHPK, EVITA SHPK dhe FARMACOM SHPK dhe fillimin e procedurës së kontrollit për transaksionet e pa njoftuara”, vendosi pezullimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve për transaksionin e shit-blerjes së Kuotës që përfaqëson 33.34 % të kapitalit të shoqërisë “Pharma One” SHPK dhe fillimin e procedurës së kontrollit të transaksioneve të mësipërme, pjesë e vendimit.

Në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës, shoqëria FARMACOM SHPK me shkresat nr. 125/17 prot., datë 30.09.2024 “Formulari i thjeshtuar i njoftimit të përqendrimeve”, dorëzoi dokumentacionin e parashikuar në rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” dhe Sekretariati filloi procedurat e kontrollit të përqendrimeve.

Referuar dokumentacionit të depozituar rezultoi se më datë 06 mars 2020 ndërmjet shoqërive FARMACOM SHPK (blerësi), z. Ben Petani (shitësi 1), Evita SHPK (shitësi 2), znj. Xhuljeta Petani (dhënësjë e pëlqimit për shitësin 1), është nënshkruar “Kontratë Shitje e Kuotave të Kapitalit”.

Qëllimi i kësaj kontrate është transferimi i pronësisë kundrejt pagesës, të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë PHARMA ONE SHPK që zotërojnë shitësit në favor të Blerësit.

Shitësi z.Petani ka shitur 16.66% të kuotave të kapitalit themeltar që ai zotëron në shoqërinë PHARMA ONE SHPK dhe shoqëria Evita SHPK ka shitur 16.67% të kuotave të kapitalit themeltar që ajo zotëron në shoqërinë target.

Për sa më sipër, shitësit i kanë shitur blerësit 33.33% të pjesëve të kapitalit themeltar që ata zotërojnë tek shoqëria target PHARMA ONE SHPK.

Me regjistrimin e kësaj Marrëveshje në Qendrën Kombëtare të Biznesit, shoqëria PHARMA ONE SHPK përbëhet nga ortakët:-Z. Ben Petani zotërues i 33.34 % të pjesëve të kapitalit, -Shoqëria Evita SHPK zotëruese e 33.33 % të pjesëve të kapitalit dhe Shoqëria FARMACOM SHPK zotëruese e 33.33 % të pjesëve të kapitalit.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

II. Njoftimi i përqendrimit në shkelje të afatit ligjor

Bazuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, një përqendrim duhet të njoftohet pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes.

Sipas parashikimit të nenit 53 të ligjit, kanë detyrimin për njoftim: a) ndërmarrjet pjesëmarrëse në bashkim; b) *ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera*; c) në rast krijimi të një ndërmarrjeje të përbashkët, sipas pikës 3 të nenit 10, ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.

Në zbatim të nenit 53 të ligjit dhe Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” kanë patur detyrimin për njoftim shoqëria FARMACOM SHPK.

Më datë 06 mars 2020 ndërmjet shoqërive FARMACOM SHPK (blerësi), z. Ben Petani (shitësi 1), Evita SHPK (shitësi 2), znj. Xhulieta Petani (dhënësja e pëlqimit për shitësin 1), është nënshkruar “Kontratë Shitje e Kuotave të Kapitalit”, dhe në zbatim të nenit 12, pika 2 e ligjit, pala blerëse ka patur detyrimin për njoftim sipas parashikimit të nenit 53 të ligjit, brenda 30 ditëve duke filluar nga data 06 prill 2020.

Për mos respektim të afatit të përcaktuar, bazuar në nenin 73, pika 1, germa dh) e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës vendos gjobë në masën jo më shumë se 1% të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet apo grupimet e ndërmarrjeve nëse nuk njofton një përqendrim, sipas neneve 10 dhe 12 të këtij Ligji.

Neni 18 i ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, specifikon se: organi që shqyrton kundërvajtjen administrative duhet të marrë parasysh: a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes; b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë; c) rëndësinë e kundërvajtjes; ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.

Për të vlerësuar rëndësinë/gravitetin e shkeljen Komisioni i Konkurrencës ka marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Njoftimi është bërë me iniciativën e Autoritetit të Konkurrencës,
- Procedura është kryer pasi ka kaluar 6 muaj nga parashikimi i nenit 12, pika 2 e ligjit,
- Përqendrimi vlerësohet si përqendrim horizontal,

Referuar nenit 15 të ligjit nr. 9121/2003, rezulton se xhiroja e shoqërive palë në marrëveshje është në vlerën rreth [...] lekë, por shoqëria FARMACOM nuk ka realizuar të ardhura.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe neni 73, pika 1, germa dh) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 33.33% të kapitalit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëria FARMACOM SHPK, vendosjen e gjobës mbi:
 - a) shoqërinë FARMACOM SHPK, në masën [...] lekë,
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.
3. Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1121, Datë 11. 10. 2024

“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRISË PHARMA ONE SHPK, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQËNDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DELTA MED SHPK NGA SHOQËRIA PHARMA ONE SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim Kraja	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 10. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i sjelljes së shoqërisë PHARMA ONE SHPK, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, nenet 53, nenet 73 dhe 75 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet Përfutimit i kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria Evita SHPK dhe Z. Ben Petani, Përfutimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe Z. Ben Petani dhe Përfutimi i kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK, nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

VËREN SE :

I. Procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me Marrëveshjen për Shit-blerjen e Kuotës, datë 19.04.2024, lidhur ndërmjet shoqërisë “MED LAB” SHPK dhe z. Ben Petani për shit-blerjen e Kuotës që përfaqëson 33.34% (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e katër përqind) të kapitalit të shoqërisë “Pharma One” SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga pala njoftuese si dhe informacionit të marrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Autoriteti i Konkurrencës konstatoi se shoqëria PHARMA ONE SHPK është përfshirë në disa transaksione të panjoftuara.

Me qëllim vlerësimin e ndikimeve në treg që mund të kenë sjellë transaksionet e ndryshimit të kontrollit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK në tregun e barnave, Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 1081, datë 24.05.2024 “Mbi pezullimin e afateve të procedurës së kontrollit të përqendrimeve për transaksionin e përfuturit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë MED LAB SHPK, EVITA SHPK dhe FARMACOM SHPK dhe fillimin e procedurës së kontrollit për transaksionet e pa njoftuara”, vendosi pezullimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve për transaksionin e shit-blerjes së Kuotës që përfaqëson 33.34 % të kapitalit të shoqërisë “Pharma One” SHPK dhe fillimin e procedurës së kontrollit të transaksioneve të mësipërme, pjesë e vendimit.

Në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës, shoqëria PHARMA ONE SHPK me shkresat nr. 125/18 prot., datë 30.09.2024 “Formulari i thjeshtuar i njoftimit të përqendrimeve”, dorëzoi dokumentacionin e parashikuar në rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” dhe Sekretariati filloi procedurat e kontrollit të përqendrimeve.

Referuar dokumentacionit të depozituar rezultoi se datë 27 shkurt 2020, shoqëria PHARMA ONE SHPK (blerësi), Eduard Curraj (shitësi 1), znj. Marjana Curraj (dhënësjë e pëlqimit për shitësin 1), Dorian Sadiku (shitësi 2) dhe znj. Jorida Jubani (dhënësjë e pëlqimit për shitësin 2), kanë nënshkruar “Kontratë shitje e kuotave të kapitalit” të shoqërisë DELTA Med SHPK.

Qëllimi i kësaj kontrate ka qenë transferimi i pronësisë kundrejt pagesës, të Kuotave të Kapitalit Themeltar të shoqërisë DELTA Med SHPK që zotërojnë shitësit në favor të blerësit. Kjo kontratë shërben për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe mënyrave të transferimit të kësaj pronësie, si dhe pagesat përkatëse në lidhje me këtë transferim.

Referuar kësaj kontrate, shitësit detyrohen t’i japin dhe ti kalojnë blerësit 100% të Kuotave të Kapitalit Themeltar që ata zotërojnë tek shoqëria DELTA Med SHPK, secili nga 50% të pjesëve të kapitalit që zotërojnë.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria DELTA Med SHPK zotërohet 100% nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

II. Njoftimi i përqendrimit në shkelje të afatit ligjor

Bazuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, një përqendrim duhet të njoftohet pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes.

Sipas parashikimit të nenit 53 të ligjit, kanë detyrimin për njoftim: a) ndërmarrjet pjesëmarrëse në bashkim; b) *ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera*; c) në rast krijimi të një ndërmarrjeje të përbashkët, sipas pikës 3 të nenit 10, ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.

Në zbatim të nenit 53 të ligjit dhe Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve ” ka patur detyrimin për njoftim shoqëria PHARMA ONE SHPK.

Më datë 27 shkurt 2020, shoqëritë PHARMA ONE SHPK dhe z. Eduart Curraj e z. Dorian Sadiku (shitësit) kanë nënshkruar “Kontratë shitje e kuotave të kapitalit” të shoqërisë DELTA Med SHPK. Referuar kësaj kontrate, shitësit i kanë shitur blerësit 100% të kuotave të kapitalit themeltar që ata zotëronin në shoqërinë DELTA Med SHPK.

Për mos respektim të afatit të përcaktuar, bazuar në nenin 73, pika 1, germa dh) e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës vendos gjobë në masën jo më shumë se 1% të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet apo grupimet e ndërmarrjeve nëse nuk njofton një përqendrim, sipas neneve 10 dhe 12 të këtij Ligji.

Neni 18 i ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, specifikon se: organi që shqyrton kundërvajtjen administrative duhet të marrë parasysh: a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes; b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë; c) rëndësinë e kundërvajtjes; ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.

Për të vlerësuar rëndësinë/gravitetin e shkeljen Komisioni i Konkurrencës ka marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Njoftimi është bërë me iniciativën e Autoritetit të Konkurrencës,
- Procedura është kryer pasi ka kaluar 6 muaj nga parashikimi i nenit 12, pika 2 e ligjit,
- Përqendrimi vlerësohet si përqendrim horizontal,

Referuar nenit 15 të ligjit nr. 9121/2003, rezulton se xhiroja e shoqërive palë në marrëveshje është në vlerën rreth [...] lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe neni 73, pika 1, germa dh) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria PHARMA ONE SHPK, vendosjen e gjobës mbi:
 - a) shoqërinë PHARMA ONE SHPK, në masën [...] lekë,
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.
3. Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1122, Datë 23. 10. 2024

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE ADASTRA SHPK DHE COLOMBO SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23. 10. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK.

Bazë ligjore: Neni 4, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 43, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Agjencia e Prokurimeve Publike (APP) nëpërmjet shkresës nr. 3321/1 prot., datë 27.05.2024, (protokolluar pranë AK me nr. 388 prot., datë 28.05.2024), ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës, një rast mbi dyshimin për marrëveshje në oferta midis operatorëve ekonomik Colombo SHPK dhe Adastra SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për material për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Qendra e Personel Rekrutimit.
2. APP nëpërmjet kësaj shkrese shprehet se është depozituar shkresa nr. 2640/8 prot., datë 26.04.2024 (protokolluar në APP me nr. 3321 prot., datë 30.04.2024) më lëndë: “Kërkesë për

përfundim OE nga procedurat e prokurimit publik”, e Qendrës së Personel Rekrutimit, e cila ka kërkuar vlerësimin e rastit për operatorët ekonomik Colombo SHPK dhe Adastra SHPK.

3. Operatorët ekonomik Colombo SHPK dhe Adastra SHPK kanë qenë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt: “Shpenzime për material për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit, në datën 15.04.2024.
4. Sipas Autoritetit Kontraktor është konstatuar se të dy operatorët ekonomik të sipërcituar kanë lidhje familjare pasi administratorët e këtyre shoqërive janë në rrethin e personave të lidhur me njëri tjetrin (bashkëshortë) si dhe operatori ekonomik Colombo SHPK ka qenë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.
5. APP, i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Në nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 parashikohet se qëllimi i këtij ligji është si më poshtë vijon:
 - a) Të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
 - b) Të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
 - c) Të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
 - d) Të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
 - e) Të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.
 - f) Të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.
6. APP shprehet se, referuar dokumentacionit të dërguar në AK, “Deklaratë për paraqitje oferte e pavarur” nga operatori ekonomik Adastra SHPK është dërguar e paplotë dhe e panënshkruar nga subjekti dhe pas renditjes së tij në vendin e parë (mungon faqe e dytë e tij). Qëllimi i plotësimin të kësaj deklaratë është ndalimi i marrëveshjeve të fshehta në ofertë, pasi ky veprim çon në pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg dhe përbëjnë shkelje të rëndë të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
7. Nisur nga parimi i nxitjes së konkurrencës, ndërmjet operatorëve ekonomikë, si dhe në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit nr. 28/2 prot., datë 02.04.2019, të nënshkruar me Autoritetin e Konkurrencës, APP përcjell këtë rast për të vijuar më tej hetimin sa i takon kësaj çështjeje.
8. Nga vlerësimi i informacionit të paraqitur nga APP, mbi shkeljet e pretenduara të konkurrencës nga ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, dhe informacionit të Qendrës së Personel Rekrutimit, mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Shpenzime për

materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Qendra e Personel Rekrutimit Tiranë, vihet re:

- Ndërmarrja Adastra SHPK ka paraqitur “Deklaratë për paraqitje oferte e pavarur”, të plotë dhe të nënshkruar.
- Autorizim i datës 24.04.2024, ku ndërmarrja Adastra SHPK autorizon Z. Petrit Levendi të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor “Reparti Ushtarak nr. 6670 Qendra e Personel Rekrutimit Tiranë”, për të dorëzuar dokumentat dhe mostrat për procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës”.
- Z. Petrit Levendi është administrator dhe ortak i vetëm ndërmarrjes Colombo SHPK, gjithashtu pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt: “Shpenzime për materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit.
- Ndërmarrja Adastra SHPK dhe ndërmarrja Colombo SHPK, kanë të njëjtën zyrë qendrore me adresë të përbashkët.
- Në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik Adastra SHPK gjendet, vërtetim debie i datës 03.04.2024 “Për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, për personat juridik të interesuar për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura, si dhe për personat fizikë dhe juridikë të interesuar për procedurat që lidhen me zbatimin e rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit lidhur me ndërtimet e reja”, vërtetim i lëshuar me kërkesën e ndërmarrjes Colombo SHPK.

9. Sa më sipër ngrihen dyshime të arsyeshme se ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK përdorin skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord më përpara se cili prej tyre do të paraqesë ofertën më të lartë dhe cili ofertën fituese në procedurën e prokurimit ku ata do të jenë pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët, duke krijuar përshtypjen e një oferte të pastër dhe një konkurrence të sinqertë.

10. Bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimit “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, kjo sjellje hedh dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për material për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit.

11. Për sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit me objekt “Shpenzime për material për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit, ka elementë të një sjelljeje

antikonkurrese, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

12. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” me Vendim nr. 1089, datë 21.06.2024, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, për periudhën kohore nga 01.01.2022 deri në 21.06.2024.
13. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës sa më sipër, ndërmarrjet nën hetim janë:
(i) Ndërmarrja Adastra SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në datë 11.06.2014, me kapital 100% privat, me NIPT: L41826018M, me seli në: Tiranë, Farkë Selitë, Rruga "Rreli", zona kadastrale nr. 3292, volumi 56, faqe 94, me Administrator dhe Ortak të vetëm Znj. Kozeta Levendi dhe (ii) ndërmarrja Colombo SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në datë 08.12.2000, me kapital 100% privat, me NIPT: K36608208V, me seli në: Tiranë, Farkë Selitë, Njësia Administrative Farke, Rruga "Rreli", objekti Selita 5, me Administrator dhe Ortak të vetëm Z. Petrit Levendi.
14. Në zbatim të Vendimit nr. 1089, datë 21.06.2024, bazuar në nenet 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës me nr. 388/6, datë 27.06.2024 “Autorizim inspektorësh”, Grupi i Inspektimit, gjatë periudhës së hetimit paraprak, më datë 27.06.2024 proceduan me kryerjen e inspektimit pranë adresave të deklaruara në QKB të ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, specifikisht në rruga “Rreli”, njësia administrative Farkë, Selitë, Tiranë.
15. Gjatë procedurës së inspektimit nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve nën hetim sipas përcaktimit të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
16. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion drejtuar Agjencisë e Zhvillimit të Territorit, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Jug dhe Drejtorsë së Policisë së Qarkut Vlorë.
17. Ndërmarrja Adastra SHPK dhe Colombo SHPK në datë 26.09.2024, janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, ku janë pyetur nga Sekretariati për çështjen objekt hetimi.

18. Në këtë seancë, Adastra SHPK dhe Colombo SHPK u shprehen se në asnjë moment sjellja e tyre ka pasur për qëllim kordinimin midis të dyja ndërmarrjeve për të komunikuar mbi ofertat dhe procedurat e prokurimit ku marrin pjesë, pavarësisht lidhjes si burrë dhe grua, ndërmarrjet shprehen se operojnë të pavarura në momentin e pjesëmarrjes në një procedurë prokurimi. Gjithashtu, ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK u shprehën se nuk kanë pasur dijeni që sjellja e tyre në procedurat e prokurimit mund të përbënte një marrëveshje të ndaluar. Së fundmi, Znj. Kozeta Levendi administratore dhe ortakë e vetme e ndërmarrjes Adastra SHPK u shpreh se angazhohet që do të mbylli aktivitetin e kësaj ndërmarrje.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

19. Në zbatim të Ligjit nr. 9121/2003, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.

20. Procedurat e prokurimeve publike kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me Ligjin nr. 162/2020. Ky ligj përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet dhe entet kontraktore për kontratat publike dhe konkurset e projektimit. Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike.

21. APP, nëpërmjet shkresës nr. 388 prot., datë 28.05.2024, i ka kërkuar Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ për procedurën e prokurimit me nr. REF-01042-04-12-2024, dhe objekt “Shpenzime për material për funksionimin e pajisjeve të zyrës” me fondin limit 800,000 lekë pa TVSH që është zhvilluar në datë 15.04.2024 nga autoriteti kontraktues, Qendra e Personel Rekrutimit.

22. Nëpërmjet shkresës nr. 388 prot., datë 28.05.2024 të depozituar nga APP pranë Autoritetit të Konkurrencës, janë sjellë të gjithë procedurat e prokurimit publik ku ndërmarrjet nën hetim kanë marrë pjesë. Adastra SHPK dhe Colombo SHPK kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

23. Gjatë periudhës kohore në hetim 1 janar 2022 – 21 qershor 2024, Adastra SHPK dhe Colombo SHPK kanë marrë pjesë në 1651 procedura prokurimi së bashku, në të cilat 772 procedura për vitin 2022, 650 procedura për vitin 2023 dhe 229 procedura për vitin 2024. Objekti i

prokurimit për këto procedura kryesisht kanë qenë në lidhje me shpenzime pajisje zyre, pajisje kancelarie, pajisje informatike etj.

24. Nisur nga sa më sipër, treg përkatës i produktit do të konsiderojmë tregun e prokurimit publik për shpenzimë kancelarie, pajisje zyre, pajisje informatike etj., ofruar nga ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK.
25. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.
26. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë të prokurimit janë aktive në tregjet e produktit, nëpërmjet ofrimit të tyre, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Si rrjedhojë, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve

27. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve, në tregun e prokurimit publik për shpenzimë kancelarie, pajisje zyre, pajisje informatike etj., ofruar nga ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK është realizuar bazuar në metodologjinë e OECD³ “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, si dhe Udhëzuesit⁴ të përshtatur sipas kësaj metodologjie të OECD, “Mbi Luftimin e Marrëveshjeve të Ndaluar në Oferta në Prokurimet Publike”.
28. Ndërmarrja Adastra SHPK, për vitin 2022 ka marrë pjesë në 777 procedura prokurimi, për vitin 2023 ka marrë pjesë në 655 procedura prokurimi dhe për vitin 2024 ka marrë pjesë në 232 procedura prokurimi.
29. Nga këto procedura është shpallur fituese në 38 prej tyre në vitin 2022, më pas në 2023 është shpallur fituese në 27 prej tyre dhe në 2024 në 11 procedura prokurimi.
30. Ndërmarrja Colombo SHPK, për vitin 2022 ka marrë pjesë në 822 procedura prokurimi, për vitin 2023 ka marrë pjesë në 873 procedura prokurimi dhe për vitin 2024 ka marrë pjesë në 376 procedura prokurimi.
31. Nga këto procedura është shpallur fituese në 34 prej tyre në vitin 2022, më pas në 2023 është shpallur fituese në 49 prej tyre dhe në 2024 në 20 procedura prokurimi.

³ <http://www.oecd.org/competition/cartels/fightingbidrigginginpublicprocurement.htm>

⁴ <http://www.caa.gov.al/file/publikimet/brochure.pdf>

32. Për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve për periudhën kohore nga 01.01.2022 deri në 21.06.2024 është shqyrtuar i gjithë dokumentacioni i administruar dhe i paraqitur nga Autoritetet Kontraktore pranë Autoritetit të Konkurrencës. Duke qenë se procedurat e prokurimit ku dy ndërmarrjet në hetim Adastra SHPK dhe Colombo SHPK kanë marrë pjesë janë procedura prokurimi me vlerë të vogël ndërmarrjet konkurrojnë vetëm nëpërmjet vlerës në këto procedura dhe nuk ngarkojnë dokumente në sistem. Procedurat e prokurimit të analizuara si vijon:
- i. Procedura e referuar nga APP: me nr. REF-01042-04-12-2024, dhe objekt “Shpenzime për material për funksionimin e pajisjeve të zyrës” me fondin limit 800,000 lekë pa TVSH që është zhvilluar në datë 15.04.2024 nga autoriteti kontraktues, Qendra e Personel Rekrutimit. Nuk është shpallur fitues asnjë nga ndërmarrjet nën hetim.
 - ii. Procedura me nr. REF-34602-06-28-2022, dhe objekt “Riparim kompjuter printer dhe fotokopje” që është zhvilluar në datë 28.06.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Zhvillimit të Territorit. Shpallur fitues Colombo SHPK. (Operatori ekonomik i renditur i pari Adastra SHPK u skualifikua pasi njoftoi me mesazh në sistemin elektronik të prokurimit publik për pamundësinë e realizimit të procedurës).
 - iii. Procedura me nr. REF-46819-10-20-2022, dhe objekt “Sherbim për mirembajtje të pajisjeve elektronike printera, fotokopje për nevojat e institucionit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier” që është zhvilluar në datë 20.10.2022 nga autoriteti kontraktor Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier. Shpallur fitues Adastra SHPK. (Operatori ekonomik i renditur i tretë Colombo SHPK u skualifikua për arsye se oferta ishte me e lartë se fondi limit).
 - iv. Procedura me nr. REF-61700-03-07-2023, dhe objekt “Blerje Vula dixhitale” që është zhvilluar në datë 08.03.2023 nga autoriteti kontraktor Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat. Shpallur fitues Adastra SHPK. (Operatori ekonomik i renditur i pari Colombo u tërhoq me justifikimin se nuk paraqitej dot brenda afateve (paraqitja e dokumentacionit)).
 - v. Procedura me nr. REF-72283-06-13-2023, dhe objekt “Mirembajtje dhe riparim i pajisjeve kompjuterike” që është zhvilluar në datë 14.06.2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria Vendore ASHK Tirana Jug. Shpallur fitues Adastra SHPK, i cili është renditur i pari.
 - vi. Procedura me nr. REF-85868-10-31-2023, dhe objekt “Riparim printera multifunksional në DVP VLORE” që është zhvilluar në datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Policisë Qarkut Vlorë. Shpallur fitues Colombo SHPK. (Operatori ekonomik i renditur i pari Adastra SHPK u skualifikua pasi njoftoi me mesazh në sistemin elektronik të prokurimit publik për pamundësinë e realizimit të procedurës).
33. Në procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për material për funksionimin e pajisjeve të zyrës” me fondin limit 800,000 lekë pa TVSH që është zhvilluar në datë 15.04.2024 nga autoriteti kontraktues, Qendra e Personel Rekrutimit, vihet re:

- i. Autorizim i datës 24.04.2024, ku ndërmarrja Adastra SHPK autorizon Z. Petrit Levendi të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor “Reparti Ushtarak nr. 6670 Qendra e Personel Rekrutimit Tiranë”, për të dorëzuar dokumentat dhe mostrat për procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës”.
 - ii. Z. Petrit Levendi është administrator dhe ortak i vetëm ndërmarrjes Colombo SHPK, gjithashtu pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt: “Shpenzime për materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit.
 - iii. Në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik Adastra SHPK gjendet vërtetim debie i datës 03.04.2024 “Për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, për personat juridik të interesuar për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura, si dhe për personat fizikë dhe juridikë të interesuar për procedurat që lidhen me zbatimin e rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit lidhur me ndërtimet e reja”, vërtetim i lëshuar me kërkesën e ndërmarrjes Colombo SHPK.
34. Në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim për Mirëmbajtje të Pajisjeve Elektronike Printera, Fotokopje, për nevojat e Insitucionit të Prokurorinë Pranë Gjykatë së Shkallës së Parë Fier” zhvilluar nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, vihet re:
- i. Njoftim në sistem nga ndërmarrja Adastra SHPK ...“një punonjës i autorizuar është duke ardhur ... për të dorëzuar dokumentacionin” dhe Autorizim i datës 24.10.2022, ku ndërmarrja Adastra SHPK autorizon Z. Petrit Levendi të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor “Prokuroria e Rethit Gjyqësor Fier”, për të dorëzuar dokumentat dhe mostrat për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim për Mirëmbajtje të Pajisjeve Elektronike Printera, Fotokopje, për nevojat e Insitucionit të Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”.
 - ii. Kontratë qeraje ku ndërmarrja Adastra SHPK merr me qera ambiente për magazinimin, nga ndërmarrja Colombo SHPK.
 - iii. Kontratë Bashkëpunimi, mes Adastra SHPK dhe Colombo SHPK e cila ka për objekt plotësimin e stafit të njëri – tjetrit, në rastet që dy palët e quajnë të nevojshme për montim, instalim, dhe servis të printerave dhe fotokopjeve, në lidhje me tenderat dhe kompanitë që lidhen me kontrata furnizim vendosje. Si dhe në nenin 2 ka të shprehur se janë partnerë për procedurë e prokurimeve publike dhe marrim përsipër detyrimin për të zëvendësuar në mungesë stafin e njëri – tjetrit.
35. Ndërmarrja Adastra SHPK dhe ndërmarrja Colombo SHPK, kanë të njëjtën zyrë qendrore me adresë të përbashkët.

36. Sjellja e ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, sipas praktikave për marrëveshje në oferta të vendeve të OECD, si edhe Udhëzimit “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, mund të përbëjë marrëveshje në oferta.
37. Si përfundim, bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe bazuar në Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, sjellja e ndërmarrjeve: Adastra SHPK dhe Colombo SHPK në tregun e prokurimit publik për shpenzimë kancelarie, pajisje zyre, pajisje informatike etj., të zhvilluara nga autoritetet kontraktore, hedh dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK.
- II. Hetimi i thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2022 deri në 23.10.2024.
- III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 1 (një) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1123, Datë 23. 10. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DELEPLANQUE ET COMPAGNIE NGA SHOQËRIA RAGT SEMENCES.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23. 10. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë DELEPLANQUE ET COMPAGNIE nga shoqëria RAGT SEMENCES.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë DELEPLANQUE ET COMPAGNIE nga shoqëria RAGT SEMENCES.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i propozuar i përfimit të kontrollit të shoqërisë DELEPLANQUE ET COMPAGNIE nga shoqëria RAGT SEMENCES.

Referuar dokumentit “Marrëveshje Shitblerje Aksionesh”, nënshkruar më datë [.....], palët në transaksion janë:

Pala blerëse: RAGT SEMENCES është një shoqëri e thjeshtë me aksione, e themeluar sipas legjislacionit francez, e cila fokusohet në seleksionimin, prodhimin dhe marketingun e farërave në fushat kryesore të të korrave dhe të llojeve të gjësë së gjallë.

RAGT SEMENCES zotërohet dhe kontrollohet bashkërisht nga Grupi RAGT dhe Grupi InVivo.

RAGT SEMENCES, Grupi RAGT dhe Grupi InVivo nuk kanë filial, degë ose zyrë përfaqësimi në Shqipëri. Grupi InVivo ka gjeneruar xhiro në Shqipëri përmes aktivitetit tregtar të farërave.

Pala shitëse: 17 shtetas francezë dhe 2 shoqëri, Financiere et Holding Deleplanque dhe Unigrains, të themeluara sipas legjisllacionit francez.

Shoqëria Target: DELEPLANQUE ET COMPAGNIE është një shoqëri e thjeshtë me aksione, e themeluar sipas legjisllacionit francez, e specializuar në shumimin, prodhimin dhe tregtimin e farërave të panxharit të sheqerit, si dhe të korrave të tjera si drithëra, farëra vajore dhe zarzavate.

Pala njoftuese sqaron se DELEPLANQUE ET COMPAGNIE është një biznes familjar që zotërohet nga familja DELEPLANQUE, punonjësit, menaxhimi i lartë i Grupit dhe fondi i investimit Unigrains, ku X% të aksioneve të saj, përfaqësohen në marrëveshje nga shoqëria DeMeTer.

DELEPLANQUE nuk ka asnjë filial të regjistruar në Shqipëri, por realizon xhiro përmes shpërndarjes së farërave *wining pea* nëpërmjet një agjenti, në territorin shqiptar.

II. Transaksioni

Më datë [.....], pala blerëse RAGT SEMENCES dhe pala shitëse (17 persona fizikë dhe 2 shoqëri) në prani të shoqërisë target DELEPLANQUE ET COMPAGNIE dhe shoqërisë DeMeTeR, lidhën “Marrëveshje Shitblerje Aksionesh” në lidhje me shitblerjen e aksioneve të DeMeTer dhe DELEPLANQUE ET COMPAGNIE.

Në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë marrëveshje, secili nga shitësit merr përsipër të shesë, caktojë dhe transferojë tek blerësi, i cili merr përsipër të blejë aksionet e shitjes, me të gjitha të drejtat e dividendit (nëse ka) të deklaruara në çdo kohë.

Në përfundim të transaksionit të propozuar, shoqëria target DELEPLANQUE ET COMPAGNIE do të zotërohet plotësisht nga pala blerëse RAGT SEMENCES.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu për furnizimin e farërave, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfundimin e kontrollit të shoqërisë DELEPLANQUE ET COMPAGNIE nga shoqëria RAGT SEMENCES.

RAGT SEMENCES është një shoqëri e specializuar në prodhimin dhe marketingun e farërave në fushat kryesore të të korrave dhe të llojeve të gjësë së gjallë. RAGT SEMENCES nuk ka prani ligjore në Shqipëri, por ka realizuar të ardhura indirekt nëpërmjet Grupit InVivo që e zotëron.

DELEPLANQUE ET COMPAGNIE është një shoqëri e specializuar në shumimin, prodhimin dhe tregtimin e farërave të panxharit të sheqerit, si dhe të korrave të tjera si drithëra, farëra vajore dhe zarzavate. DELEPLANQUE nuk ka asnjë filial te regjistruar në Shqipëri, por realizon xhiro përmes shpërndarjes së farërave *vinig pea* nëpërmjet një agjenti, në territorin shqiptar.

Nga sa më sipër, transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELEPLANQUE ET COMPAGNIE nga shoqëria RAGT SEMENCES.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1124, Datë 23. 10. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA NGA SHOQËRITË KONČAR – ELECTRICAL INDUSTRI INC. DHE SIEMENS ENERGY HOLDING B.V”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23. 10. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë KONČAR – Electrical Industri Inc. dhe Siemens Energy Holding B.V.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë KONČAR – Electrical Industri Inc. dhe Siemens Energy Holding B.V.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i propozuar i krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë KONČAR – Electrical Industri Inc. dhe Siemens Energy Holding B.V.

Referuar dokumenteve të depozituara nga pala njoftuese, palët në transaksion janë:

Pala 1: KONČAR – Electrical Industri Inc. është një shoqëri aksionare, e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Kroacisë, e regjistruar në Regjistrin e Gjykatës Tregtare në Zagreb dhe shërben si shoqëria mëmë e Grupit KONČAR. Grupi KONČAR operon në sektorin e energjisë,

mjeteve hekurudhore dhe infrastrukturës, me një fokus të madh në teknologjitë e gjelbra dhe digjitale, si dhe zhvillimin dhe inovacionin e brendshëm.

Aktualisht KONČAR – Electrical Industri Inc. ka krijuar shoqërinë që do të shërbejë si shoqëria e ardhshme e sipërmarrjes së përbashkët me emrin KONČAR – Transformer tanks Ltd.

Në Shqipëri Grupi KONČAR është aktiv përmes dy degëve: - KONČAR - Electrical Industry Inc. for manufacturing and services - degë e shoqërisë së huaj, me objekt aktiviteti; Veprimtari e arkitekturës, inxhinierisë dhe këshillave teknike. Aktivitete me kompjuter dhe të ngjashme. Prodhimi i pajimeve të tjera elektrike. Prodhimi i kompjutereve dhe pajimeve të tjera për përpilimin e shënimeve. Ndërtimi, projektimi dhe mbikëqyrja në ndërtim. Punët në instalime. Tregtia me automjete dhe riparim i automjeteve. Tregtia me pakice në shitoret e jospecializuara, shitja e prodhimeve jetësore, etj dhe - DALEKOVOD D.D – Degë e shoqërisë së huaj, me objekt aktiviteti: Projektimi, prodhimi, inxhinieria dhe ndërtimi i linjave të transmetimit të tensionit të lartë deri në 1000 KV, nënstationet dhe impiante të ndërrueshme deri në 500 KV, stukturat e çelikut dhe metaleve antenat dhe shtyllat e rrufepritësëve, shtyllat e autostradës dhe të rrugës, armaturat për linjat e transmetimit të tensionit të lartë mbi tokë, kabllot nëntokësore deri në 220 KV, elektrifikimi i hekurudhave.

Pala 2: Siemens Energy Holding B.V është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Holandës, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Dhomat e Tregtisë Holandeze, e cila operon si pjesë e grupit Siemens Energy. Grupi Siemens Energy ka selinë në Gjermani dhe operon në katër fusha kryesore të biznesit: shërbimet për gazin, teknologjitë e rrjetit(grid technologies), transformimin e industrisë dhe energji të rinovueshme, nëpërmjet Siemens Gamesa Renewable Energy.

Grupi Siemens Energy është aktiv në sektorin e energjisë duke ofruar produkte dhe shërbime në teknologjitë e energjisë tradicionale dhe të rinovueshme, teknologjinë e rrjetit, ruajtjen e energjisë dhe zgjidhjet për elektrifikimin e proceseve industriale.

Grupi Siemens Energy nuk ka filiale të regjistruara në Shqipëri.

Ndërmarrja e përbashkët (SP), KONČAR – Transformer tanks Ltd. është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë e regjistruar në Regjistrin e Gjykatës Tregtare në Zagreb, me objekt aktiviteti kryesor: - prodhim konstruksionesh metalike dhe pjesëve të tyre.

Sipërmarrja e përbashkët do të jetë me funksione të plota, e cila do të operojë në prodhimin dhe shitjen e tankeve (mbajtësve/kontenierëve) për transformatorë. SP do të ketë administratorë të dedikuar për operacionet e saj të përditshme dhe akses në burime, përfshirë financiare, të personelit të aseteve, duke siguruar vazhdimësinë e aktiviteteve të saj të biznesit. Pas ndërtimit të fabrikës së prodhimit, SP do të krijojë një prani autonome në treg, duke operuar në mënyrë të pavarur dhe do të kryejë prodhimin dhe shitjen e tankeve për transformatorë për klientë palë të

treta, përkatësisht për fabrika të vendosura në Gjermani, Holandë, Spanjë, koreja e Jugut, Kroaci, Slloveni dhe Zvicër. Në përputhje me Marrëveshjen e Sipërmarrjes së Përbashkët (SP) është krijuar për të ofruar shërbime për palë të treta mbi një bazë të qëndrueshme dhe do të jetë ekonomikisht autonome, e pavarur nga shoqëritë mëmë.

II. Transaksioni

Më datë [.....], shoqëria KONČAR – Electrical Industri Inc. dhe shoqëria Siemens Energy Holding B.V kanë nënshkruar “Marrëveshje e Sipërmarrjes së Përbashkët”, mbi transaksionin e propozuar.

Transaksioni i propozuar përbëhet nga tre faza:

-Transaksioni fillestar;

Sipas afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshje KONČAR – Electrical Industri Inc. synon ti shesë Siemens Energy Holding B.V, një kuotë me vlerë nominale prej X euro, që korespondon me X% të totalit të kapitalit të Sipërmarrjes së Përbashkët për çmimin e blerjes që korespondon me vlerën nominale të tij dhe të krijojë SP-në, me qëllim financimin e kapitalit të përbashkët të ndërtimit të fabrikës së prodhimit në pronën e përcaktuar. (Me nënshkrimin e Marrëveshjes KONČAR – Electrical Industri Inc., zotëron një kuotë në vlerë nominale X euro që korespondon me X% të totalit të kapitalit të shoqërisë KONČAR – Transformer tanks Ltd., i cili do mbajë pas ndarjes X% të totalit të kapitalit të SP- së.

Transaksioni sekondar;

Referuar Marrëveshjes KONČAR – Electrical Industri Inc. dhe Siemens Energy Holding B.V, synojnë të angazhohen për të siguruar financimin e kapitalit nëpërmjet pagesave në fondet e SP për SP me qëllimin e ndërtimit të Fabrikës së prodhimit, financimi i të cilit do të përdoret për ndërtimin dhe pajisjet e Fabrikës së prodhimit siç përcaktohet në shtojcën 4 të kësaj Marrëveshje.

Transaksioni Tretë;

Pas lëshimit të lejes për operim për fabrikën e prodhimit, KONČAR – Electrical Industri Inc. do të ndajë biznesin e prodhimit dhe të shitjes së tankeve për transformatorë nga shoqëria KONČAR – Metalne konstrukcije d.o.o.. dhe do ta transferojë atë në Sipërmarrjen e Përbashkët.

Në përfundim të transaksionit të propozuar KONČAR – Electrical Industri Inc. do të mbajë X% të kapitalit aksionar të SP-së, ndërsa Siemens Energy Holding B.V do të mbajë X% të kapitalit aksionar të SP-së. Kontrolli i Sipërmarrjes së Përbashkët do të ushtrohet bashkërisht nga KONČAR – Electrical Industri Inc. dhe Siemens Energy Holding B.V.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë, është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu në të cilin do të operojë ndërmarrja e përbashkët, pra tregu i prodhimit dhe shitjes së tankeve për transformatorë, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë KONČAR – Electrical Industri Inc. dhe Siemens Energy Holding B.V.

KONČAR – Electrical Industri Inc. është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Kroacisë, me objekt aktiviteti prodhimi i produkteve metalike; prodhimi i makinerive dhe pajisjeve; prodhimi i makinerive dhe aparateve elektrike; prodhimi i pajisjeve të tjera për transport; menaxhimi i shoqërive holding, etj. KONČAR – Electrical Industri Inc. është shoqëria mëmë e grupit KONČAR, i cili operon në sektorin e energjisë, mjeteve hekurudhore dhe infrastrukturës, me një fokus të madh në teknologjitë e gjelbra dhe digjitale, si dhe në zhvillimin dhe inovacionin e brendshëm. Grupi KONČAR operon brenda katër divizioneve: prodhimi i energjisë, transmetimi dhe shpërndarja e energjisë, lëvizshmëria dhe infrastruktura urbane, zgjidhjet dhe platformat digjitale.

Grupi KONČAR është i pranishëm në Shqipëri nëpërmjet dy degëve: KONCAR-Electrical Industry Inc. for manufacturing and services dhe DALEKOVOD D.D.

Siemens Energy Holding B.V është është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Holandës dhe operon si pjesë e Grupit Siemens Energy. Grupi Siemens Energy e ka selinë në Gjermani dhe operon në sektorin e energjisë, duke ofruar produkte dhe shërbime në teknologjitë e energjisë konvencionale dhe të rinovueshme, teknologjinë e rrjetit, ruajtjen e energjisë dhe zgjidhje për elektrifikimin e proceseve industriale. Ai është angazhuar në dekarbonizimin e sektorit të energjisë, duke promovuar një kalim gradual nga qymyri në gaz dhe sisteme hibride dhe duke eksploruar karburante të pastra si hidrogjeni.

Grupi Siemens Energy nuk ka filial në Shqipëri, por ka realizuar të ardhura në Shqipëri.

Ndërmarrja e përbashkët: KONČAR – Transformer tanks Ltd. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Kroacisë me objekt aktiviteti prodhimit dhe shitjen e tankeve për transformatorë.

Ndërmarrja e përbashkët nuk do të jetë aktive në Shqipëri.

Transaksioni i propozuar nuk çon në ndonjë mbivendosje horizontale ose vertikale midis aktiviteteve të biznesit të palëve dhe ndërmarrjes së përbashkët në Shqipëri, pasi: (i) ndërmarrja e përbashkët nuk pritet të jetë aktive në Shqipëri; dhe (ii) Grupi KONČAR dhe Grupi Siemens Energy nuk janë të pranishëm drejtpërdrejtë në tregun shqiptar në të njëjtin treg përkatës si ndërmarrja e përbashkët.

Krijimi i ndërmarrjes së përbashkët nuk do të ngrejë shqetësim për konkurrencën në Shqipëri, pasi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë KONČAR – Electrical Industri Inc. dhe Siemens Energy Holding B.V.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1127, Datë 07. 11. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË JOHNSON CONTROLS - HITACCHI AIR CONDITIONING HOLDING (UK) LTD DHE BIZNESIT TË SHOQËRISË JOHNSON CONTROLS INTERNATIONAL PLC NGA SHOQËRIA ROBERT BOSCH GMBH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07. 11. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë JOHNSON CONTROLS - HITACCHI AIR CONDITIONING HOLDING (UK) LTD dhe biznesit të shoqërisë JOHNSON CONTROLS INTERNATIONAL PLC nga shoqëria Robert Bosch GmbH.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë JOHNSON CONTROLS - HITACCHI AIR CONDITIONING HOLDING (UK) LTD dhe biznesit të shoqërisë JOHNSON CONTROLS INTERNATIONAL PLC nga shoqëria Robert Bosch GmbH,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i propozuar i përfutimit të kontrollit të shoqërisë JOHNSON CONTROLS - HITACCHI AIR CONDITIONING HOLDING (UK) LTD dhe biznesit të shoqërisë JOHNSON CONTROLS INTERNATIONAL PLC nga shoqëria Robert Bosch GmbH.

Referuar dokumenteve “Marrëveshja e Shitblerjes së Aksioneve dhe Aseteve” dhe “Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve”, nënshkruar më datë [...], palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Robert Bosch GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti zhvillimin, prodhimin, funksionimin dhe shpërndarjen e produkteve, teknologjive, sistemeve dhe zgjidhjeve, si dhe ofrimin e shërbimeve, veçanërisht në fushat e lëvizshmërisë, teknologjisë industriale, mallrave të konsumit, energjisë dhe teknologjisë së ndërtimit, komunikimit dhe teknologjisë së informacionit, etj.

Robert Bosch GmbH është pjesë e Grupit Bosch, një furnizues global i teknologjisë dhe shërbimeve për industrinë e automobilave, teknologjinë industriale, mallrat e konsumit dhe energjinë dhe industrinë e teknologjisë së ndërtimit.

Grupi Bosch nuk ka filiale në Shqipëri, por gjeneron të ardhura nëpërmjet palëve të treta.

Pala shitëse:

Shitësi 1: JOHNSON CONTROLS INTERNATIONAL PLC (JCI) është një shoqëri e kufizuar publike, e themeluar sipas legjislacionit të Irlandës, e cila prodhon produkte dhe sisteme ndërtimi, duke përfshirë pajisjet HVAC (sisteme të ngrohjes, ventilimit dhe ajrit të kondicionuar) rezidenciale dhe komerciale, sistemet industriale të ftohjes, kontrollet, sistemet e sigurisë, sistemet e zbulimit të zjarrit dhe zgjidhjet e shuarjes së zjarrit.

Shitësi 2: Hitachi Global Life Solutions, Inc. është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Japonisë, me objekt aktiviteti prodhimin dhe shpërndarjen e pajisjeve shtëpiake.

Target:

- **JOHNSON CONTROLS - HITACCHI AIR CONDITIONING HOLDING (UK) LTD (JCH)** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Mbretërisë së Bashkuar, e cila operon një biznes të ngrohjes, ventilimit dhe ajrit të kondicionuar pa kanalizime në njësi banimi dhe njësi të vogla tregtare. JCH është aktualisht një sipërmarrje e përbashkët, e cila zotërohet 60% nga JCI dhe 40% nga Hitachi Global Life Solutions, Inc.
- **Biznesi i ngrohjes, ventilimit dhe ajrit të kondicionuar (HVAC) me kanalizime në njësi banimi dhe njësi të vogla tregtare i shoqërisë JOHNSON CONTROLS INTERNATIONAL PLC (JCI).** Biznesi i JCI-së për HVAC me kanale përfshin produktet si: sistemet e ngrohjes dhe ftohjes rezidenciale me kanale; sistemet e ngrohjes dhe ftohjes tregtare; pajisje për cilësinë e ajrit të brendshëm.

Target nuk ka filiale në Shqipëri, por gjeneron të ardhura nëpërmjet palëve të treta.

II. Transaksioni

Më datë [...], pala blerëse Robert Borsch GmbH dhe pala shitëse JOHNSON CONTROLS INTERNATIONAL PLC, lidhën “Marrëveshje e Shitblerjes së Aksioneve dhe Aseteve”. Në të

njëjtën datë, pala blerëse Robert Borsch GmbH, pala shitëse Hitachi Global Solutions, Inc. dhe JOHNSON CONTROLS INTERNATIONAL PLC lidhën “Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve”.

Referuar marrëveshjeve të mësipërme, tek pala blerëse Robert Bosch GmbH do të transferohet biznesi me sisteme HVAC me kanale, aktualisht pjesë e JCI dhe shoqëria JCH, aktualisht në pronësi xx% të JCI dhe xx% të Hitachi Global Solutions, Inc.

Sipas Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 1.3 “Objekti i Kontrollit” parashikohet se përftimi i kontrollit mbi asetet mund të konsiderohet një përqendrim, vetëm nëse këto asete përbëjnë ndërmarrjen si një e tërë ose një pjesë të saj, d.m.th. një biznes me një përfaqësim në treg, e cila ka një xhiro vjetore tregu.

Mbështetur në dokumentacionin e depozituar, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë JOHNSON CONTROLS - HITACCHI AIR CONDITIONING HOLDING (UK) LTD dhe biznesit të shoqërisë JOHNSON CONTROLS INTERNATIONAL PLC nga shoqëria Robert Bosch GmbH.

Ky transaksion është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 1.3 “Objekti i Kontrollit” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu për sistemet HVAC, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të shoqërisë JOHNSON CONTROLS - HITACCHI AIR CONDITIONING HOLDING (UK) LTD dhe biznesit të shoqërisë JOHNSON CONTROLS INTERNATIONAL PLC nga shoqëria Robert Bosch GmbH.

Robert Bosch GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, pjesë e Bosch Group, i cili është një furnizues global i teknologjisë dhe shërbimeve për industrinë e automobilave, teknologjinë industriale, mallrat e konsumit dhe energjinë dhe industrinë e teknologjisë së ndërtimit.

Bosch Group nuk ka filiale, por realizon xhiro në Shqipëri nëpërmjet shitjeve të realizuara nga palë të treta.

Targeti, *Biznesi i ngrohjes, ventilimit dhe ajrit të kondicionuar (HVAC) me kanalizime në njësi banimi dhe njësi të vogla tregtare* i shoqërisë JOHNSON CONTROLS INTERNATIONAL PLC dhe shoqëria JOHNSON CONTROLS - HITACHI AIR CONDITIONING HOLDING (UK)

LTD, janë aktivë në prodhimin e sistemeve HVAC “me zgjerim të drejtpërdrejtë” që përfshijnë sisteme me kanale, sisteme të kondicionerëve të dhomës, sisteme të kondicionerëve të pakeluar dhe sisteme të ndryshueshme të fluksit të ftohësit, si dhe “sisteme hidronik” që përfshijnë ftohës pa kanal dhe pompa nxehtësie hidronike.

Në Shqipëri, Target realizon të ardhura nga shitjet e sistemeve HVAC rezidenciale dhe pompa nxehtësie ajër – ujë nëpërmjet disa kontraktorëve.

Nga sa më sipër, transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar, të realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë JOHNSON CONTROLS - HITACCHI AIR CONDITIONING HOLDING (UK) LTD dhe biznesit të shoqërisë JOHNSON CONTROLS INTERNATIONAL PLC nga shoqëria Robert Bosch GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1128, Datë 07. 11. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË V4DRIVE BATTERY GMBH NGA SHOQËRIA DR. ING.H.C.F. PORCHE AKTIENGESELLSCHAFT.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07. 11. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë V4Drive Battery GmbH nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë V4Drive Battery GmbH nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i propozuar, i përfimit të kontrollit të shoqërisë V4Drive Battery GmbH nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft.

Referuar dokumentit “Marrëveshja e pjesëmarrjes” nënshkruar më datë [...], palët në transaksion janë:

Pala blerëse: Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: prodhimin dhe shitjen e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, duke përfshirë avionët dhe mjetet ujore, si dhe pjesëve, aksesorëve

për produkte të tilla dhe të tjera teknike, etj.

Dr. Ing. h.c.F. Porsche Aktiengesellschaft është një filial i zotëruar në mënyrë indirekte nga Volkswagen Aktiengesellschaft, kompania mëmë e Volkswagen Group.

Grupi Volkswagen është aktiv në të gjithë botën në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë. Grupi Volkswagen gjithashtu angazhohet dhe në shpërndarjen e automjeteve.

Grupi Volkswagen, operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Porsche Leasing SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: dhënie e qerasë financiare dhe shërbimin e sigurimeve të lidhura me shitjet e automjeteve.

Porsche Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesorëve, etj.

Aktiviteti i Grupit VW në Shqipëri konsiston kryesisht në shitjen e automjeteve të pasagjerëve dhe automjeteve tregtare.

Pala shitëse: VARTA AKTIENGESELLSCHAFT është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti mbajtjen, blerjen, administrimin dhe shfrytëzimin e aksioneve, në veçanti aksionet në fushën e zhvillimit, prodhimit dhe shpërndarjes së sistemeve të energjisë dhe sistemeve të ruajtjes së energjisë, ofrimi i të gjitha llojeve të shërbimeve, veçanërisht shërbimet për shoqëritë dhe / ose në emër të shoqërive në të cilat shoqëria zotëron aksione etj.

VARTA AKTIENGESELLSCHAFT zotëron plotësisht shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara VARTA Microbattery GmbH dhe Varta Micro Production GmbH, të themeluara sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti prodhimin, shpërndarjen dhe zhvillimin e produkteve kimike, elektrokimike, elektroteknike dhe metalurgjike, si dhe produkteve të tjera industriale të të gjitha llojeve, në veçanti bateritë, si dhe prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve në fushën e inxhinierisë mekanike etj.

Shoqëria target: V4Drive Battery GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti hulumtimin në produktet e ruajtjes së energjisë dhe prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve të ruajtjes së energjisë.

Shoqëria V4Drive Battery GmbH, një filial i zotëruar plotësisht nga VARTA AKTIENGESELLSCHAFT, nuk është i pranishëm dhe nuk gjeneron të ardhura në tregun shqiptar.

II. Transaksioni

Më datë [...], shoqëritë Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft (pala blerëse), VARTA AKTIENGESELLSCHAFT (pala shitëse), V4Drive Battery GmbH (shoqëria target), VARTA Microbattery GmbH, Varta Micro Production GmbH, Michael Tojner Industrie Beteiligungs und – beratungs GmbH dhe Brillant Immobilien beteiligungs GmbH kanë lidhur “Marrëveshja e Pjesëmarrjes”, në lidhje me shoqërinë target V4Drive Battery GmbH.

Referuar kësaj marrëveshje, VARTA AKTIENGESELLSCHAFT do të vendosë në mbledhjen e ortakut të vetëm të zmadhohë kapitalin e shoqërisë target, duke hequr dorë plotësisht nga të drejtat e nënshkrimit të kuotave dhe të autorizojë Porsche të marrë përsipër të gjithë zmadhimin e kapitalit.

Pas implementimit të transaksionit të propozuar, Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft do të jetë ortaku i shumicës që ushtron kontrollin në shoqërinë target.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i zhvillimit dhe shitjes së qelizave të baterive litium-jon për aplikacione automobilistike dhe jo automobilistike, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë V4Drive Battery GmbH nga shoqëria Dr.Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft.

Dr.Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft është pjesë e grupit Volkswagen, i cili është aktiv në mbarë botën për zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave për transportin e pasagjerëve, makinave komerciale, kamionëve, autobusëve, trajlerave, shasive për autobusë dhe motorë benzine, motoçikleta, duke përfshirë pjesë këmbimi dhe aksesore për to.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK, por nuk është prezent në Shqipëri në tregun përkatës. Aktiviteti i tyre në Shqipëri konsiston kryesisht në shitjen e automjeteve të pasagjerëve dhe automjeteve tregtare.

V4Drive Battery GmbH është një shoqëri aktive në hulumtimin e produkteve të ruajtjes së energjisë dhe prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve të ruajtjes së energjisë.

Target nuk është prezent dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Nga sa më sipër, transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar, të realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë V4Drive Battery GmbH nga shoqëria Dr.Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 1129, Datë 07. 11. 2024

**“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI
APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN
RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SHA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Lejda MATJA	Zv/ kryetare
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07. 11. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Dhënie e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Gjirrokastër SHA.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirrokastër SHA,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës nr. 407 prot., datë 24.10.2024, informon Autoritetin e Konkurrencës se me projekt-vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 20 prot., datë 09.07.2024, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirrokastër SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjiellës dhe të kanalizimit, në të gjithë zonën e shërbimit pas themelimit të ndërmarrjes Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirrokastër SHA më datë 22.09.2022, bazuar në VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SHA”, rezultoi se:
3. Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale për kategorinë e furnizimit me ujë (FU), jo për të gjitha njësitë, të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura (KUN) dhe tarifën fikse të shërbimit.
4. Ndërmarrja Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SHA aktualisht ushtron aktivitetin e saj sipas tarifave të miratuara nga ERRU për ish shoqëritë UK ekzistuese. Tarifat e miratuara janë sipas :
 - Vendimit të KKRR nr. 7, datë 08.02.2019 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime Gjirokastër SHA.
 - Vendimit të KKRR nr. 42, datë 30.07.2010 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për UK Tepelenë SHA”;
 - Vendimit të KKRR nr. 23, datë 30.04.2013 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të kanalizimeve për UK Tepelenë SHA”
 - Vendimit të KKRR nr. 47, datë 30.12.2013 Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për UK Tepelenë SHA”.
 - Vendimit të KKRR nr. 34, datë 11.12.2012 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për UK Përmet SHA”.
5. Kjo ndërmarrje e riorganizuar në nivel rajonal synon ndryshimin e tarifave aktuale në një nivel të ri tarifor, me qëllimin e qëndrueshmërisë financiare duke përmirësuar nivelin e kostove dhe përcaktimin e objektivave të treguesve kryesorë të performancës që ndërmarrja duhet të arrij në fund të vitit 2025; 2026, për të ofruar një shërbim më cilësor tek konsumatori dhe që të përballoj kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes.
6. Ndërmarrja Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SHA bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që nuk arrijnë të mbulojnë kostot të operimit dhe mirëmbajtjes, prandaj përmirësimi i këtij treguesi është objektivi kryesor i ndërmarrjes për vitin 2025, 2026. Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja

aplikon një nivel tarifimi volumetrik shërbimi për FU dhe për KUN, të cilat aplikohen jo në mënyrë uniforme për të gjithë zonën e shërbimit që mbulohet nga secila UK ekzistuese. Pas riorganizimit të sektorit është themeluar ndërmarrja Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjyrokastër SHA për të cilën po miratohen tarifa të ndryshuara pas analizës së kryer.

7. Aktualisht për Zonën A - Bashkia Gjyrokastër tarifat për FU kanë qënë më të ulta në qarkun përkatës sepse nuk janë rishikuar që nga viti 2019 për Gjyrokastrën, që nga vitit 2013 për Tepelenën dhe që nga viti 2012 për Përmetin. Shoqëria në këtë aplikim ka kërkuar rishikim të tarifave për klientët jo familjarë, familjarë për rishikimi e tarifave për FU, për KUN dhe për tarifat fikse. Është pranuar si i arsyeshëm propozimi i shoqërisë për klientët publike ndërsa tarifat për klientët privat nuk janë pranuar në nivelin e kërkuar nga shoqëria, por është parë e arsyeshme të respektohet klauzola e metodologjisë së tarifave lidhur me koeficientin e ndërfinancimit të tarifave ndërmjet klientëve familjarë me ato jo familjarë, megjithëse në disa raste kjo tarifë kalon dyfishin e raportit të konsumatorit familjarë me konsumatorin jofamiljarë (publik dhe privat). Në këtë propozim tarifat fikse janë pranuar të unifikuara për të tre zonat A,B,C sipas propozimit të shoqërisë. Gjithashtu tarifat volumetrike për KUN për të tre zonat janë pranuar të unifikuara sipas propozimit të shoqërisë.
8. Tarifa për klientët familjare për Zonën C (Njësia Libohovë, Njësia Dropull dhe Njësia Administrative Gjyrokastër) është pranuar propozimi i shoqërisë si një rritje e arsyeshme në këtë aplikim duke patur parasysh kushtet specifike të këtyre njësive. Referuar tarifave për klientët publik dhe private të njësisë Kavajë, nuk është pranuar propozimi i shoqërisë për FU, por është parë e arsyeshme të respektohet aplikimi i koeficientit të ndërfinancimit të përcaktuar në metodologjinë e tarifave ndërmjet klientëve familjare me ato jo familjare.
9. Referuar tarifave për klientët publike dhe private të njësive Libohovë, Këlcyrë dhe Dropull, nuk është pranuar propozimi i shoqërisë për FU, por është parë e arsyeshme të respektohet aplikimi pothuajse i koeficientit dy (2) të ndërfinancimit të përcaktuar në metodologjinë e tarifave ndërmjet klientëve familjarë me ato jo familjarë.
10. Ndërmarrjen Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjyrokastër SHA propozon tarifat e reja si rezultat në nevojën për përmirësim të performancës financiare dhe mbulimin 100% të kostove operacionale duke qënë se është një shoqëri me kosto shumë të larta të energjisë elektrike; aplikimi për nivel te ri tarifor për shkak të rritjes së cmimeve të materialeve dhe pagës minimale; reduktimi i ujit pa të ardhura i cili vazhdon të jetë në nivele shumë të larta; përmirësim i cilësisë së shërbimit të ujit me rritjen e vazhdimësisë së furnizimit me ujë; tarifat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e

defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit.

11. Bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, të përcaktuara në Vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2024; vitin 2025 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, reduktimin e kostove të mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar reduktimin e humbjeve teknike dhe administrative, rritjen e qëndrueshmërisë financiare si edhe rritjen e mundësisë për përfitime të investimeve në shërbimet e ofruar.
12. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrjen Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë SHA pas miratimit të tarifave të reja do të ketë një nivel të pranueshëm të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes totale, që varion nga 32.1% për vitin 2023 me një rritje 44.7% për në fund të vitit 2027. Nevoja për të ardhura synon përmirësimin e nivelit të mbulimit të kostove O&M, i cili parashikohet të jetë në nivelin 77.88% për vitin 2023 me një rritje 112.7% për në fund të vitit 2027.
13. ERRU bazuar në projekt vendimin e miratimit të tarifave gjykon se ndërmarrjen Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë SHA duhet të instaloj matëset në burim (Bulk metër), si edhe matësit familjarë, sidomos në zonat rurale ku shpërdorimi i ujit për vaditje është i lartë në mënyrë që të realizojë objektivin e vendosur nga ERRU për treguesit e nivelit të matjes; të kryejë vlerësimin e “ujit të prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përfitohet; të organizojë taks - forcën me ndihmën edhe të Bashkisë Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Memaliaj, Libohovë, Këlcyrë, Dropull për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit dhe abuzuesit kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zonat rurale; të trajtojnë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e bilancit të ujit me të dhënat sa më afër realitetit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij sa më të saktë, për të patuar situatën reale mbi ujin pa të ardhura; të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të bilancit të Ujit për vitin 2023, vitin 2024 e në vazhdim; të gjejnë mundësitë për të nxjerrë jashtë pune rrjetin e vjetër të furnizimit, i cili shkakton humbje fizike të konsiderueshme; të mbaj nën kontroll të gjithë sistemin e furnizimit për të reaguar në kohën e duhur ndaj riparimeve të defekteve, për të minimizuar sa më shumë humbjet nga rrjedhjet; të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara në të në mënyrë që të evitohen vjetrimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme për të zvogëluar humbjen nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të çënimit të shëndetit publik nga ndotjet dhe çarjet; Të mirëmbajë sistemet e informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të parashikuara për t'u realizuar në vitin 2025.

14. Në aspektin ekonomik, ERRU gjykon se, ndërmarrja Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjyrokastër SHA duhet të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e amortizimit të aseteve sipas kërkesave të ERRU referuar ndarjes për këtë qëllim, që ka bërë në këtë model aplikimi, në mënyrë që të kemi:

- a) Orientimin e tarifave drejt mbulimit të Kostove Operacionale për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;
- b) Tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.
- c) Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, ERRU ka vendosur detyra për t'u realizuar nga UK Rajonale Gjyrokastër SHA:
- d) T'i kushtohet vëmendja maksimale instalimit të matësive në prodhim për të gjithë burimet, si dhe atyre familjarë të parashikuar, për të gjithë klientët në zonën e shërbimit në mënyrë që të arrihet objektivi i vendosur nga ERRU për treguesin e nivelit të matjes dhe uljen e humbjeve;
- e) Të kryejë vlerësimin e “Ujit të Prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet me dhe pa ujëmatës;
- f) Të trajtojë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e Bilancit të Ujit me të dhëna sa më afër realitetit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij sa më saktë, për të patur situatë reale mbi UPA dhe të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të Bilancit të Ujit për vitin 2024 dhe në vazhdim;
- g) Të mbajë aktive vazhdimisht Task-Forcën për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e furnizimit dhe abuzimet kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zonat rurale;
- h) Për aplikimin tarifor të rradhës (jo më vonë se qershor 2027), duke qenë se shoqëria në fund të periudhës rregullatore 2025-2027 do të arrijë të mbulojë mbi 100% kostot O&M, në këtë aplikim të pritshëm shoqëria do të aplikojë sipas metodës “Çmim Tavan” të metodologjisë së tarifave, i cili kërkon që të jetë detyruesisht i shoqëruar me Planin e Biznesit 5-vjeçar i aprovuar paraprakisht nga ERRU. Për këtë qëllim shoqëria duhet të ketë parasysh që brenda vitit 2027 të ketë përditësuar Planin e Biznesit 5-vjeçar duke përdorur si vit bazë të dhënat e çertifikuara të vitit 2026, i cili duhet të shoqërohet me planet përkatëse të veprimit të mbështetura me projekte dhe me burimet e financimit.
- i) Të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara për të planifikuar prioritetet e investimeve në të ardhmen e afërt në mënyrë që të evitohet vjetërimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme, e cila lidhet ngushtësisht me strategjinë e zvogëlimit të humbjeve nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të çënimit të shëndetit publik nga ndotjet në çarjet.
- j) Të mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të paktën për vitin 2026, si një vit bazë që do të përdoret për aplikimin e radhës.

- k) Me mbështetjen e Task Forcës të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit dhe asaj të përgjithshme duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si, monitorimi i klientëve, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, pagesa on-line dhe deri ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë.
 - l) Treguesi i eficensës së stafit që lidhet me një nga elementet e rëndësishëm të kostove të O&M duhet të justifikohet me argumenta mbështetëse. Për këtë duke hartuar urgjentisht një organogramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri.
 - m) Ti kushtohet vëmendje e veçantë konsumit të energjisë në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të ketyre kostove, duke i dhënë prioritet hartimit urgjent të një studimi mbi eficientësinë e energjisë me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë për energjinë.
15. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) bazuar në pikën 1/b të nenit 14 të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë edhe të largimit të përpunimit të ujërave të ndotura”, ka kompetencë të miratojë çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruar nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik, edhe në rastet kur sistemet e ujësjellës kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose në pronësi të njësisve të qeverisjes vendore. KKRR me anë të vendimit nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”, ka miratuar rregullat, procedurat, politikën tarifore dhe metodologjinë e vendosjes së tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura.
16. Mbështetur në nenet 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatorë, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive dhe për arsye të interesit të përgjithshëm, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ.
17. Propozimet për ndryshim të tarifa të shërbimit nga ndërmarrja e Ujësjetllës Kanalizimeve janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Entit Rregullator të Ujit:

- a. Detyrimin për zbatimin e nenit 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregun përkatës.
 - b. Për çdo rast të rishikimit të tarifave të reja për ndërmarrjet e ujësjellës kanalizime, të përcaktohet qartë struktura e kostos mbi bazën e së cilës miratohen tarifat, bazuar në metodologjinë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, në të cilën përfshihen kostot e: - Tarifës së ujit për shitje sipas kategorive të konsumatorëve; - Tarifës për Shërbimin e Grumbullimit, Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura ; - Tarifës së shërbimit.
 - c. Rritja e tarifave duhet të jetë graduale dhe në përputhje me kriteret e performancës, në mënyrë të veçantë të orarit të furnizimit me ujë.
 - d. Të rishikohen kostot në drejtim të rritjes së performancës së administrimit dhe të rishpërndahen burimet e të ardhurave të kërkuara për investime edhe nga ulja e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes pasi sipas vendimit të ardhurat do të vijnë në masën 96% nga rritja e tarifave, dhe vetëm 4% nga rritja e nivelit të faturimit.
 - e. Publikimin dhe bërjen transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të të gjithë informacionit në lidhje me aplikimet për ndryshimin e tarifave, kostot përkatëse mbi të cilat bazohen këto ndryshime, si dhe për vitet 2018 dhe 2019 të publikohen treguesit e parashikuar për “ujin pa të ardhura”, “Kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “Eficiencën e stafit”.
18. Në zbatim të këtij vendimi, Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar disa vendime të marra nga ERRU për miratimin e ndryshimit të tarifave të shërbimit nga ndërmarrje të Ujësjellës Kanalizimeve.
19. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” SHA, i ka rekomanduar Entit Rregullator të Ujit si vijon:
- a. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për Ndërmarrjen Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
 - b. ERRU të kërkoj nga Ndërmarrja Rajonale Ujësjellës Kanalizime Tirane SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
 - c. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëj transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.

20. Nga analiza e konkurrencës rezulton se ndërmarrja Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjyrokastër SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, në kuptim të nenit 9 pika 1 e Ligjit nr. 9121/2003 ka detyrimin e mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht në vendosjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar ERRU, si autoriteti përgjegjës për miratimin e tarifave, orientimin e çmimeve të shërbimit drejt kostos për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjyrokastër SHA.
21. Në aplikimin për nivel të ri të tarifës për FU dhe KUN, ERRU, e gjen të nevojshme ndryshimin e nivelit tarifor për tarifën variabël të FU dhe KUN për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjyrokastër SHA, por jo në nivelet që propozon ndërmarrja. ERRU e ka bazuar analizën e përcaktimit të tarifave në Vendimin nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjetllës kanalizime”, duke analizuar të dhënat që përcaktojnë tarifën (kostot operacionale, vëllimet e faturave dhe numrin e klientëve) të realizuar në vitin bazë (viti 2022) dhe duke aplikuar koeficientin tarifor për përcaktimin e tarifave për kategoritë e klientëve jo familjarë.
22. Procedura e miratimit të tarifave nga ERRU, bazuar në pikën 1 të nenit 13 të Metodologjisë së miratimit të tarifave sipas Vendimit të KKRR nr. 539/2021, përmban dhe aprovimin e prezantimit për në seancën dëgjimore me publikun të tarifave dhe zhvillimin e tyre. Sipas verifikimit të faqes zyrtare të ëeb-it të Bashkisë Gjyrokastër, Tepelenë, Përmet, Memaliaj, Libohovë, Këlcyrë, Dropull si edhe të Ndërmarrjes Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Gjyrokastër SHA, konstatojmë se seanca dëgjimore në lidhje me propozimin për ndryshim tarife kundrejt konsumatorëve familjarë, publik dhe jo familjarë, nuk janë publike.
23. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot për të dy shërbimet e ofruara, duke zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (b).
24. Konstatohet se vetëm vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, germa (d) e (f); 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
2. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.
3. Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Memaliaj, Libohovë, Këlcyrë, Dropull, si edhe në ndërmarrjen Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë SHA seancat e zhvilluara të dëgjësës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 1130, Datë 07. 11. 2024

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E
SIGURIMIT TË JETËS PËR KREDI”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07. 11. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e sigurimit të jetës për kredi.

Bazë ligjore: Neni 9, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar një kërkesë me nr. 523 prot., datë 30.07.2024 nga ndërmarrja SiCRED SHA, me qëllim fillimin e procedurave hetimore për të shmangur pengimet, kufizimet, shtrembërimet e konkurrencës në tregun e sigurimeve të jetës për kredi.
2. Ndërmarrja SiCRED SHA nëpërmjet kësaj shkrese pretendon se disa banka të nivelit të dytë nuk janë transparente në metodologjinë që ndjekin në lidhje me produktin “sigurimi i jetës për hua” duke cënuar në këtë mënyrë interesat e ndërmarrjes SiCRED SHA.
3. Në vijim të ankesës, Autoriteti i Konkurrencës bazuar në nenin 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës, nisi procedurën e monitorimit në tregun e sigurimit të jetës për kredi, duke kërkuar informacion nga bankat lidhur me këtë treg.

4. Nga vlerësimi i informacionit gjatë monitorimit, si dhe nga faqja zyrtare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare u konstatua se, shoqëritë e sigurimit të cilat ushtrojnë aktivitet në tregun e sigurimit të jetës janë: Sigal Life Uniqa Group Austria SHA me 44.37%, Insig Jeta SHA 21.72%, Albsig Jetë SHA me 17.92% dhe Sicred SHA me 15.99% të tregut të sigurimit të jetës sipas raportit statistikor të vitit 2023.
5. Të gjitha bankat janë të licensuara si “Broker” nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, përveç Bankës Amerikane të Investimeve SHA, First Investment Bank SHA edhe ProCredit Bank SHA, për ushtrimin e aktivitetit të brokerimit. Megjithatë jo të gjitha aplikojnë sigurimin e detyrueshëm të jetës në rast huamarrje.
6. Gjithashtu nga vlerësimi i informacionit gjatë monitorimit vihet re se, bankat e licensuara si “Broker” paraqesin portofolin e shoqërive të sigurimit me të cilat kanë kontrata aktive, dhe më pas lejojnë klientët të bëjnë përzgjedhjen e tyre pasi u janë shpjeguar kushtet e ndërmjetësimit përse i përket produktit të sigurimit të jetës. Pavarësisht shpjegimit të sjellë në mënyrë shkresore nga bankat e nivelit të dytë, rezulton se përqindja e tregut total të sigurimit të jetës sipas raportit statistikor të AMF për vitin 2023, nuk reflektohet tek ndarja e portofolit të sigurimit të jetës për hua ku SiCRED SHA rezulton të ketë përqindje tregu të tilla si 0.3% tek BKT SHA, 0.3% tek Raiffeisen bank SHA, 0.1% tek Intesa San Paolo bank SHA, 1% tek Pro Credit bank SHA etj. Nisur nga fakti që një përqindje e tillë tregu për një produkt të vetëm, nuk reflekton ndarjen totale të tregut të sigurimit të jetës, mund të vijë si pasojë e sjelljeve përjashtuese me karakter antikonkurrues duke bërë që klientët mos të jenë të lirë të zgjedhin sigurimin e jetës për kredi nga shoqëri sigurimi të përzgjedhura nga vetë ata.
7. Bazuar sa më sipër, sjellja e bankave në tregun e sigurimit të jetës për kredi mund të sjellë kufizim të konkurrencës në kuptim të nenit 4 dhe nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Hapjen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi.

- II. Hetimi paraprak do të përfshijë periudhën kohore nga 07.11.2021 deri në 07.11.2024
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1132, Datë 14. 11. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË ENTITETEVE TË GRUPIT VANTIVE (VANTIVE HEALTH LLC, VANTIVE MEXICO LLC, GAMBRO RENAL PRODUCTS INC, RTS WORLDWIDE HOLDINGS INC, VANTIVE HOLDING BV, VANTIVE HEALTH GMBH, JERSEY NEWCO) NGA SHOQËRIA CP SPRUCE HOLDINGS, S.C.SP..”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 11. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Entiteteve të Grupit Vantive (Vantive Health LLC, Vantive Mexico LLC, Gambro Renal Products Inc, RTS Worldwide Holdings Inc, Vantive Holding BV, Vantive Health GmbH, Jersey NewCo) nga shoqëria CP Spruce Holdings, S.C.Sp..

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Entiteteve të Grupit Vantive (Vantive Health LLC, Vantive Mexico LLC, Gambro Renal Products Inc, RTS Worldwide Holdings Inc, Vantive Holding BV, Vantive Health GmbH, Jersey NewCo) nga shoqëria CP Spruce Holdings, S.C.Sp..

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të Entiteteve të Grupit Vantive nga shoqëria CP Spruce Holdings, S.C.Sp.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për Blerje të Kapitalit”, palët në marrëveshje janë:

Palët Blerëse: CP Spruce Holdings, S.C.Sp, është një partneritet i veçantë, i regjistruar në Regjistrin e Tregtisë dhe të Shoqërive të Luksemburgut. Si një shoqëri holding, ajo është krijuar me qëllim realizimin e objektivit në vijim: zotërimi i pjesëmarrjeve në çfarëdo lloj forme në shoqëri vendase apo të huaja dhe i çdo forme tjetër investimi, përfitim nëpërmjet blerjes, nënshkrimit apo çfarëdolloj mënyre tjetër, transferimi nëpërmjet shitjes, shkëmbimit ose çdo mënyrë tjetër i vlerave të luajtshme, administrimi, menaxhimi, kontrolli dhe zhvillimi i portofolit të saj, të pjesëmarrjeve të ortakëve të saj.

Shoqëria është krijuar si një subjekt për qëllime të veçanta, e cila kontrollohet dhe zotërohet indirekt nga The Carlyle Group Inc., një menaxher global i asetëve alternative, i cili menaxhon fonde që investohen globalisht.

Në Shqipëri, The Carlyle Group nuk ka asnjë filial të regjistruar, por gjatë vitit 2023 ka gjeneruar xhiro në mënyrë të tërthortë nëpërmjet disa shoqërive portofol.

Për realizimin e transaksionit të propozuar, CP Spruce Holdings, S.C.Sp ka krijuar filialet e saj Spruce Bidco I, Inc., Spruce Bidco II, Inc. dhe Spruce Bidco I Limited, si subjekte për qëllime të veçanta.

Pala shitëse: Baxter International Inc., është një korporatë e Delaware, e cila nëpërmjet filialeve të saj, ofron një portofol të gjerë të produkteve thelbësore të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë terapitë e dializës akute dhe kronike; solucione sterile intravenoze (IV); sistemet dhe pajisjet e infuzionit; terapi ushqimore parenteral; anestetikë të thithur; farmaceutike gjenerike injektuese; hemostat dhe produkte izoluese kirurgjikale, pajisje të avancuara kirurgjikale; sisteme të zgjuar të shtratit; teknologjitë e monitorimit dhe diagnostikimit të pacientëve; dhe pajisjet e shëndetit të frymëmarrjes.

Baxter International Inc. kontrollon segmentin për kujdesin e veshkave, të njohur si Vantive.

Vantive është segmenti i kujdesit për veshkat i Baxter International Inc.. Vantive është kryesisht aktiv në furnizimin me produkte për Terapi të Zëvendësimit të Veshkave (RRT). Operacionet e Vantive kanë dy divizione kryesore: (i) Terapitë Kronike, që përfshijnë njësitë e Dializës Peritoneale dhe Produkte të Hemodializës dhe (ii) Terapitë Akute, e cila përdoret për Terapi të Vazhdueshme të Veshkave dhe për suport organesh të tjera që përdoren në njësi të kujdesit intensiv.

Aktualisht, Vantive është nën kontrollin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të filialeve të Baxter International Inc.

Shoqëritë Target/ Entitetet Vantive përfshijnë:

1. **Vantive Health LLC** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në shtetin Delaware, SHBA dhe vepron si Shoqëri *Holding* me aktivitete të kufizuar operativ.

2. **Vantive Mexico LLC** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në shtetin Delaware, SHBA dhe vepron si Shoqëri *Holding* për entitetet operative në Meksikë.
3. **Gambro Renal Products Inc.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e Colorado, themeluar dhe regjistruar në SHBA dhe vepron si Shoqëri *Holding* për pronësinë intelektuale.
4. **RTS Worldwide Holdings Inc.** është një korporate e shtetit Delaware, themeluar dhe regjistruar në SHBA si Shoqëri *Holding* për entitetet që operojnë klinikat e dializës jashtë SHBA-së dhe operacionet teknike në SHBA.
5. **Vantive Holding BV** është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe regjistruar në Holandë, ekzistuese sipas ligjeve të Holandës Shoqëri *Holding* për entitetet operative dhe jo-operative jashtë SHBA.
6. **Vantive Health GmbH** është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar sipas legjislacionit Zvicerian, dhe Qëllimi i shoqërisë është të prodhojë, zhvillojë, importojë, eksportojë, blejë, shesë, licencojë, reklamojë, shpërndajë, ofrojë, riparojë, instalojë, programojë dhe mbajë në emrin dhe për llogari të saj, ose si një agjent shitjesh ose agjent me komision komisioni/komisionar, produkte të kujdesit shëndetësor, produkte farmaceutike, pajisje mjekësore dhe terapitë, produktet dhe shërbimet përkatëse;
7. **Vantive Holding Limited/Jersey NewCo** është një shoqëri e re e themeluar sipas ligjeve të Jersey, Channel Islands si Shoqëri *Holding* pa aktivitet operativ.

II. Transaksioni

Më datë [...] ndërmjet shoqërisë CP Spruce Holdings, S.C.Sp., Spruce Bidco I, Inc., Spruce Bidco II, Inc., Spruce Bidco I Limited (Blerësit) dhe Baxter International Inc. (shitësi), është nënshkruar, “Marrëveshje për Blerje të Kapitalit”.

Referuar “Marrëveshjes për Blerje të Kapitalit”, CP Spruce si Blerësi, përmes filialeve të saj të krijuara si subjekte për qëllime të veçanta, US Bidco I, US Bidco II dhe Irish Bidco, do të blejë segmentin e Shitësit për kujdesin e veshkave, të njohur si Vantive.

Sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje: (a) në finalizim të transaksionit shitësi pranon të shesë, kalojë, transferojë dhe dorëzojë, ose këtë ta bëjnë direkt filialet e tij dhe blerësi pranon të blejë dhe pranojë nga shitësi apo filiali tij interesat në SHBA dhe interesat jo në SHBA, të lira dhe të parënduara nga çdo barrë; (b) gjatë finalizimit lokal të zbatueshëm shitësi do të detyrojë ose do të bëjë që filialet e tij të kalojnë, transferojnë dhe dorëzojnë për blerësin ose të caktuarin e tij, Biznesin e Ardhshëm Lokal Vantive sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe marrëveshjen e Transferimit të Aksioneve dhe/ose Biznesit.

Pas transaksionit, The Carlyle Group Inc. (përmes CP Spruce Holdings, S.C.Sp.) do të përfitojë kontrollin e vetëm e të tërthortë mbi Entitetet Vantive.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar, i përfshimit të kontrollit të Entiteteve të Grupit Vantive (Vantive Health LLC, Vantive Mexico LLC, Gambro Renal Products Inc, RTS Worldwide Holdings Inc, Vantive Holding BV, Vantive Health GmbH, Jersey Newco), CP Spruce Holdings, S.C.Sp., përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu në të cilin operojnë shoqëritë target, pra tregu i furnizimit me produkte për terapi të zëvendësimit të veshkave, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfshimin e kontrollit të Entiteteve të Grupit Vantive (Vantive Health LLC, Vantive Mexico LLC, Gambro Renal Products Inc., RTS Worldwide Holdings Inc., Vantive Holding BV, Vantive Health GmbH, Jersey Newco), nga CP Spruce Holdings, S.C.Sp.

CP Spruce Holdings, S.C.Sp. zotërohet në mënyrë indirekte nga filialet e The Carlyle Group Inc..

The Carlyle Group Inc. është një menaxher global i asetëve alternative, i themeluar sipas ligjeve të SHBA, i cili menaxhon fonde që investojnë globalisht në tre disiplinat e investimeve: (i) Kapitale Private Globale; (ii) Kreditim Global dhe (iii) Zgjidhje Investimesh Globale.

The Carlyle Group Inc. nuk ka asnjë filial të regjistruar në Shqipëri, por në vitin 2023 ka realizuar të ardhura në mënyrë të tërthortë nëpërmjet shoqërive portofol.

Shtatë shoqëritë target, Entitetet Vantive, janë aktive tek segmenti i kujdesit për veshkat, i cili është nën kontrollin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të filialeve të Baxter International Inc.. Aktivitetet e Entiteteve Vantive janë kryesisht aktiv në furnizimin me produkte për Terapi të Zëvendësimit të Veshkave (RRT), të ndarë në dy divizione kryesore: (i) Terapitë Kronike, që përfshijnë njësitë e Dializës Peritoneale dhe Produkte të Hemodializës dhe (ii) Terapitë Akute, e cila përdoret për Terapi të Vazhdueshme të Veshkave dhe për suport organesh të tjera që përdoren në njësi të kujdesit intensiv.

Asnjë nga shoqëritë e kontrolluara në portofolin e The Carlyle Group Inc. nuk është aktive në ofrimin e produkteve për terapi të zëvendësimit të veshkave.

Transaksioni i propozuar nuk çon në ndonjë mbivendosje horizontale ose vertikale midis aktiviteve të biznesit të palëve as në nivel global, as në Shqipëri pasi palët: (i) nuk janë aktive

në Shqipëri; dhe (ii) palët nuk operojnë në të njëjtin treg përkatës, as në Shqipëri, as në mbarë botën.

Nga sa më sipër, Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar përftimit të kontrollit të Entiteteve të Grupit Vantive (Vantive Health LLC, Vantive Mexico LLC, Gambro Renal Products Inc, RTS Worldwide Holdings Inc, Vantive Holding BV, Vantive Health GmbH, Jersey NewCo) nga shoqëria CP Spruce Holdings, S.C.Sp..
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1133, Datë 14. 11. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË IDEMIA IDENTITY & SECURITY FRANCE NGA SHOQËRIA IMPRIMERIE NATIONALE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 11. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Idemia Identity & Security France nga shoqëria IMPRIMERIE NATIONALE.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Idemia Identity & Security France nga shoqëria IMPRIMERIE NATIONALE,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i propozuar i përfimit të kontrollit të shoqërisë Idemia Identity & Security France nga shoqëria IMPRIMERIE NATIONALE.

Referuar dokumenteve “Marrëveshja e ushtrimit të së drejtës së blerjes” dhe “Draft – Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve” në lidhje me shitjen e Idemia Identity & Security France, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: IMPRIMERIE NATIONALE është një shoqëri anonime, e themeluar sipas legjislacionit francez, e cila është tërësisht në pronësi të shtetit francez dhe është përgjegjëse për

lëshimin e dokumenteve të sigurta të identitetit në Francë (pasaporta, leje drejtimi, karta identiteti etj.).

IMPRIMERIE NATIONALE është shoqëria holding e IMPRIMERIE NATIONALE Group (IN Group), aktiv në sektorin e identitetit dhe shërbimeve digjitale të sigurta

IN Group gjeneron të ardhura në Shqipëri që rrjedhin nga shitja e moduleve të sigurisë për hardware, nëpërmjet një filiali të tij.

Pala shitëse: Idemia France është një shoqëri aksionare e thjeshtuar, e themeluar sipas legjislacionit francez, e cila ofron produkte dhe shërbime të lidhura me sigurinë si: hyrje në makinë pa çelës, kartë SIM, teknologji për njohjen e fytyrës, digjital banking, menaxhim abonimi, etj. Idemia France zotërohet plotësisht nga IDEMIA Finance SAS.

Idemia France aktualisht zotëron plotësisht Idemia Identity & Security France.

Target: Idemia Identity & Security France është një shoqëri aksionare e thjeshtuar (shoqëri me një ortak të vetëm), e themeluar sipas legjislacionit francez, me objekt aktiviteti shfrytëzimin e të gjitha ndërmarrjeve që kanë të bëjnë me zbatimet e përgjithshme të teknologjive të informacionit, të elektronikës, të optikës dhe të kriptologjisë në fushat e sigurisë, veçanërisht për transaksionet elektronike dhe identifikimin e personave dhe të pasurive.

Idemia Identity & Security France është pjesë e Grupit Idemia, i cili ushtron aktivitetet e tij në bizneset: a) *Biznesi ISI*, biznesi i dokumenteve të identitetit civil dhe kartave të shoqërive që ndjek divizioni ISI i Grupit Idemia (i cili përfshin prodhimin, personalizimin dhe zhvillimin dhe shpërndarjen e komponentëve teknologjikë për produktet fizike të identitetit civil dhe kartat e shoqërive dhe Zgjidhjet Digjitale të Identitetit Civil, përfshirë kartat e identitetit, pasaportat, lejet e qëndrimit, kartat e shëndetit etj; b) *Biznesi ISP*, c) *Biznesi IST* dhe *Biznesi i Sigurisë Rrugore*.

Biznesi ISP, Biznesi IST dhe Biznesi i Sigurisë Rrugore nuk do të jenë pjesë e transaksionit të propozuar dhe nuk do të përfshihen në të.

Idemia Identity & Security France në Shqipëri zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 75% të kapitalit të shoqërisë ALEAT SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti zbatimin e koncesionit “Prodhimi dhe shpërndarja e dokumenteve të identitetit dhe pasaportave elektronike”, duke përfshirë por pa u kufizuar në krijimin, funksionimin, financimin dhe mirëmbajtjen e sistemit për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve të identitetit dhe të pasaportave elektronike në Shqipëri etj. Shoqëria momentalisht është në statusin *në likuidim e sipër*.

Target ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri për vitin 2023 dhe aktualisht ALEAT SHPK ofron dokumente identiteti të zbrazëta për shtetin shqiptar dhe shërbime mirëmbajtje të sistemeve menaxhuese për dokumentet e identitetit.

II. Transaksioni

Më datë [...], pala blerëse IMPRIMERIE NATIONALE dhe pala shitëse Idemia France, lidhën “Marrëveshje e ushtrimit të së drejtës së blerjes Idemia Identity & Security France”. Bashkëlidhur kësaj marrëveshje është “Draft – Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve” në lidhje me shitjen e Idemia Identity & Security France, ndërmjet Idemia France (shitësi), Idemia Group (shoqëria mëmë e shitësit) dhe IMPRIMERIE NATIONALE (blerësi).

Referuar këtyre marrëveshjeve, pala blerëse është angazhuar në mënyrë të pakthyeshme që të blejë, pas ushtrimit nga shitësi të optionit të shitjes, të gjitha aksionet pa asnjë barrë dhe me të gjitha të drejtat e bashkangjitura ose që i akumulohen në finalizim, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në SPA (Draft-Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve).

Aktualisht target operon si një nga njësitë e biznesit të Idemia France. Pala njoftuese sqaron më tej se, ndarja e target do të përfundojë përpara përfundimit të transaksionit të propozuar, sipas hapave të përcaktuara në marrëveshje.

Gjithashtu Target, përpara transaksionit të propozuar, do të shesë aksionet e zotëruara në ALEAT SHPK në IDEMIA Finance SAS (shoqëria mëmë e targetit) dhe si rrjedhojë, Aleat SHPK nuk do të preket nga transaksioni i propozuar.

Pas transaksionit të propozuar, IMPRIMERIE NATIONALE do të zotërojë aksionet që përfaqësojnë 100% të kapitalit aksionar të target.

Mbështetur në dokumentacionin e depozituar, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Idemia Identity & Security France nga shoqëria IMPRIMERIE NATIONALE, transaksion i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i furnizimit të dokumenteve të identitetit bosh, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitimi i kontrollit të shoqërisë Idemia Identity & Security France nga shoqëria IMPRIMERIE NATIONALE.

IMPRIMERIE NATIONALE është një shoqëri holding e IN Group, i cili është aktiv në sektorin e identitetit dhe shërbimeve digjitale të sigurta. IN Group nuk zotëron asnjë shoqëri në Shqipëri, por ka realizuar të ardhura nga shitja e moduleve të sigurisë për hardware (“HSM”) nëpërmjet një filiali të tij.

Target është biznesi i dokumenteve të identitetit civil dhe kartave të shoqërive i Idemia-s.

Target zotëron 75% të kuotave në shoqërinë ALEAT SHPK dhe aktualisht ALEAT SHPK ofron dokumente identiteti të zbrazëta për shtetin shqiptar dhe shërbime mirëmbajtje të sistemeve menaxhuese për dokumentet e identitetit.

Transaksioni nuk do të ketë për pasojë ndryshimin e kontrollit të ALEAT SHPK, pasi përpara përfundimit të transaksionit të propozuar, shoqëria target do të shesë aksionet e zotëruara në ALEAT SHPK, tek IDEMIA Finance SAS (shoqëria mëmë e targetit).

Nga sa më sipër, transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar, të realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë Idemia Identity & Security France nga shoqëria IMPRIMERIE NATIONALE.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1134, Datë 06. 12. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË NOA SHA NGA SHOQËRIA TRANZIT SHPK.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06. 12. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë NOA SHA nga shoqëria TRANZIT SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale ndërmjet ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë NOA SHA nga shoqëria TRANZIT SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë NOA SHA nga shoqëria Tranzit SHPK.

Referuar dokumentit “Marrëveshje lidhur me shitjen dhe blerjen e gjithë kapitalit aksionar të emtuar të NOA Sh.a” të nënshkruar më datë [...], palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: TRANZIT SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti ofrimin e kredive personave fizikë dhe juridikë, faktoringu, qiraja financiare (leasing), këshillimi dhe shërbime ndërmjetësimi. Veç kësaj, në

përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të lidhur drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, që vjen si pasojë ose që është e lidhur me veprimtaritë e mësipërme. Për të arritur qëllimet e mësipërme, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion si p.sh.: tregtar, financiar, shërbime të mbledhjes së huave në vonesë, të pagesave në vonesë dhe/ose detyrimeve të tjera në vonesë të institucioneve të tjera, me qëllim vlerësimin e fizibilitetit të portofolave për t'u blerë nga Shoqëria, veprimtari qiraje ose hipotekimi që mund të konsiderohen të vlefshme dhe të nevojshme me qëllim kryerjen e veprimtarisë së Shoqërisë.

Shoqëria TRANZIT SHPK është një Subjekt Financiar JoBankë, e licensuar nga Banka e Shqipërisë me licencën Nr. 20, datë 04.08.2010, që ushtron veprimtarinë në fushën e kredidhënies.

TRANZIT SHPK zotërohet në xxx të kuotave nga NEW CENTURY HOLDINGS XI, LP, xxx nga NCH BALKAN FUND, L.P. dhe xxx të kuotave nga MOSCOPOLE INC.

Shoqëria TRANZIT SHPK, direkt dhe nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej saj zotëron kuota/aksione në shoqëritë e mëposhtme:

- **A.I.D.A SHPK**, shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktivitete lidhur me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në emër të shoqërisë ose personave të tretë, duke përfshirë transaksione dhe menaxhim; aktivitete lidhur me investime dhe zhvillim në fushën e energjisë, teknologjisë si dhe në sektorë të tjerë industrial si atë urban/rural/industrial/turistik etj, shërbime këshillimi dhe konsultimi për këto aktivitete ose sipërmarrje financiare.
- **BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA**, shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: të gjitha format e kredidhënies, të gjitha format e pagesave, të garancive, tregtimin për llogari të saj dhe të klientit të valutave etj.

Shoqëria është pajisur me licencën Nr. 14, datë 28.10.1999, lëshuar nga Banka e Shqipërisë, për kryerjen e veprimtarive bankare dhe financiare të mësipërme.

- **ABI INVEST SHA**, një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti krijimin dhe /ose administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, bazuar në Ligjin 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe veprimtari të tjera që parashikohen në këtë ligj.

Shoqëria është pajisur me licencën Nr. 6, datë 27.02.2020 nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

- **ABI BROKER SIGURIMESH SHA**, një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti ndërmjetësimin (shërbimi i brokerimit) në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve, përfshirë negociatat deri në nënshkrimin e kontratave të sigurimit dhe risigurimit, në emër dhe për llogari të klientëve të shoqërisë, me një apo më shumë shoqëri sigurimi dhe risigurimi, sipas rastit.

Shoqëria është pajisur me licencën Nr. 25, datë 20.10.2018 nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

- **BURSA SHQIPTARE E TITUJVE ALSE SHA**, shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt kryerjen e aktivitetit të bursës së titujve për të gjithë titujt dhe instrumentet e tjera financiare, të parashikuar sipas Ligjit për Titujt dhe në përputhje me licencën e dhënë nga AMF-ja, me përjashtim të instrumenteve derivative të përcaktuar nga Kreu II i Ligjit për Titujt. Në mënyrë më të detajuar, aktiviteti i Shoqërisë do të përfshijë, por pa u kufizuar në: realizimin e të gjitha aktiviteteve që lidhen me veprimtarinë si bursë titujsh, si dhe aktivitete të tjera që lidhen me organizimin e tregtimit të titujve dhe instrumenteve të tjerë financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi; ofrimin dhe realizimin e një platforme tregtimi shumëpalëshe (MTF) etj.

Shoqëria është pajisur me licencën Nr. 2, datë 03.07.2017 nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

- **Regjistri Tregtar i Titujve ALREG SHA**, shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i shoqërisë do të jetë kryerja e aktivitetit të Regjistrarit të titujve për të gjithë titujt dhe instrumentet e tjera financiare, të parashikuar sipas Ligjit për “Tregjet e Kapitalit” dhe në përputhje me licencën e dhënë nga Autoriteti përkatës. Shoqëria do të kryejë regjistrimin fillestar të titujve në një sistem regjistrimi (emetimin) si dhe kodifikimin e titujve sipas përcaktimeve më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, do të mbajë regjistrat e titujve, do të organizojë dhe administrojë të dhënat mbi të gjitha llojet e titujve. Shoqëria do të ofrojë shërbimin qendror të mirëmbajtjes së llogarive të titujve duke bërë të mundur që të sigurohen në çdo kohë të dhënat e plota për pronësinë mbi të gjithë titujt e regjistruar, si dhe kufizimet e të drejtave të pronësisë mbi to. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e klerimit dhe shlyerjes së titujve si operator i sistemit të shlyerjes së titujve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi.

Shoqëria është pajisur me licencën Nr. 2, datë 19.12.2019 nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Pala Shitëse:

Shitësi 1: NOA Cooperatief U.A. është një shoqëri holandeze, e regjistruar në Regjistrin e Biznesit të Dhomës së Tregtisë Holandeze, e cila zotëron xxx të kapitalit aksionar të shoqërisë target.

Shitësi 2: NOA Holdings N.V. është një shoqëri holandeze, e regjistruar në Regjistrin e Biznesit të Dhomës së Tregtisë Holandeze, e cila zotëron xxx të kapitalit aksionar të shoqërisë target.

Shoqëria Target: NOA SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti i. Të japë kredi; ii. të kryejë pagesa dhe arkëtime; iii. të emetojë, pranojë dhe administrojë instrumentet e pagesës; iv. të ofrojë shërbimin e këmbimit të monedhave; v. të ofrojë garanci të tjera (që nuk emërtohen garanci bankare); vi. të shërbejë si agjent financiar/rekuperues i kredive me probleme dhe konsulent (që nuk përfshihen në shërbimet

e parashikuara në paragrafët 3 (a) dhe 3 (b) të nenit 26 "Për Bankën e Shqipërisë"; vii. të kryejë aktivitetin e qirasë financiare; viii. të kryejë veprimtarinë e Agjentit në Sigurime.

NOA SHA është një subjekt financiar, i cili ushtron veprimtarinë e tij në bazë të Licencës Nr. 09, datë 06.06.2007, të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, të rinovuara me licencat 09/1 për të operuar si Institucion Financiar JoBankë dhe 09/2 për të operuar si Institucion Pagesash në Republikën e Shqipërisë.

Shoqëria target NOA SHA aktualisht zotërohet nga shoqëritë NOA Cooperatief U.A. dhe NOA Holdings N.V. sipas aksioneve respektive.

Shoqëria NOA SHA zotëron xxx të aksioneve të shoqërisë I.F.J.B NOA SH.A., një shoqëri aksionare e themeluar dhe regjistruar në Kosovë, me objekt aktivitete të tjera të kredisë, ndërmjetësime të tjera monetare, aktivitete të tjera shërbyese financiare, përveç fondit të sigurimit dhe atij pensional, leasing financiar.

Shoqëria ushtron veprimtarinë financiare, me anë të licencës Nr. IFJB / 084, datë 27 shkurt 2023, lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

II. Transaksioni

Më datë [...] është nënshkruar "Marrëveshje lidhur me shitjen dhe blerjen e gjithë kapitalit aksionar të emetuar të NOA Sh.a", ndërmjet shoqërisë [...] në cilësinë e blerësit dhe shoqërive [...] në cilësinë e shitësve.

[....]

Në përfundim të transaksionit, TRANZIT SHPK do të zotërojë plotësisht shoqërinë NOA SHA dhe indirekt pronësinë sipas aksioneve të shoqërisë I.F.J.B NOA SH.A. Kosovë.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", "tregu përkatës" i prekur nga transaksioni do të përfshijë dy komponentë:

- I. tregu përkatës i produktit, dhe
- II. tregu përkatës gjeografik.

Përcaktimi i tregut si në dimensionin e produktit dhe atë gjeografik, bëhet me qëllim që të identifikohen konkurrentët aktualë dhe potencialë të ndërmarrjeve që janë të përfshirë në atë treg, sjelljen e këtyre ndërmarrjeve, llogaritjen e pjesëve të tregut, përcaktimin e fuqisë së ndërmarrjes, strukturën e tregut me qëllim vlerësimin e konkurrencës në treg.

Përcaktimi i tregut përkatës të produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.

Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës ndodh në rastet kur një rritje e çmimeve e bën një produkt më pak të pëlqyer nga konsumatorët, të cilët vendosin të blejnë më pak nga ai produkt dhe më shumë nga produktet alternative zëvendësuese.

Referuar përcaktimit të tregut përkatës në raportin e hetimit të përgjithshëm të sektorit bankar (VKK nr. 453, datë 07.03.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve për BSH, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe Bankat e nivelit të dytë”) në lidhje me zëvendësueshmërinë e shërbimeve/produkteve të ofruara nga bankat e nivelit të dytë dhe atyre nga SFJB-të, Autoriteti konstatoi se edhe pse pjesërisht bankat dhe SFJB-të e shohin njëri-tjetrin si zëvendësues, procedura e dhënies së kredi/mikrokredive, normat e aplikuara të interesit nga SFJB-të dhe kostot për marrjen e tyre ndryshojnë ndjeshëm nga ato të sistemit bankar⁵.

Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës nënkupton që ndërmarrjet të jenë të afta të këmbëjnë produktet e tyre me produktet e tregut përkatës dhe ti tregtojnë ato në periudha afatshkurtra pa sjellë kosto shtesë, në përgjigje të ndryshimeve të vogla ose të përhershme të çmimeve.

Për vetë veçoritë që kanë tregjet ku operojnë SFJB-të dhe detyrimin për tu pajisur me licenca përkatëse nga BSH, rrjedhimisht produktet e SFJB-ve nuk janë të zëvendësueshme nga ana e ofertës.

Referuar objektit të aktivitetit të shoqërive pjesëmarrëse në transaksion, si dhe shkresës nr. 671/3 prot., i AK, datë 01.11.2024, të Bankës së Shqipërisë, dy subjektet, TRANZIT SHPK dhe NOA SHA janë të licencuara për të ofruar të gjitha format e kredidhënies. Subjekti TRANZIT SHPK është gjithashtu i licencuar për të ofruar faktoringun dhe qiranë financiare, por nuk ka raportuar asnjëherë volume aktiviteti për këtë kategori. Ndërsa subjekti NOA SHA është i licencuar dhe si institucion i pagesave, por nuk ka ofruar shërbime të pagesave për vitet 2022,2023.

Gjithashtu referuar shkresës së Bankës së Shqipërisë, bazuar në fleksibilitetin që lejon kuadri rregullativ, subjekti TRANZIT SHPK nuk raporton produkte të mikrokredisë, ndërsa subjekti NOA SHA ka filluar të raportojë këtë produkt vetëm në Mars 2023.

Sa më sipër, tregu ku ka mbivendosje të aktivitetit të shoqërive pjesëmarrëse në transaksion është tregu i kredidhënies, pasi të dyja shoqëritë, TRANZIT SHPK dhe NOA SHA janë të licencuara për të ofruar këtë shërbim. Për sa i përket faktoringut, qirasë financiare, mikrokredisë dhe

⁵ VKK nr. 453, datë 07.03.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve për Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe Bankat e nivelit të dytë”, si dhe VKK nr. 906, datë 29.07.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë SFJB”.

shërbimeve të pagesave nuk ka mbivendosje të aktivitetit të shoqërive pjesëmarrëse në transaksion.

Për sa më sipër, **treg përkatës i produktit** do të konsiderohet **tregu i ofrimit të shërbimit të kredihënies** nga Subjekte Financiare Jo Banka (SFJB).

Për analizimin e këtij rasti **treg përkatës gjeografik** do të konsiderohet territori i **Republikës së Shqipërisë**.

Referuar Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2023, në sistemin financiar ushtrojnë aktivitet 39 Subjekte Financiare JoBanka (SFJB).

Pjesa më e madhe e portofolit të kredisë së SFJB-ve mbahet nga subjektet e kredihënies dhe mikrokredisë xxx më pas renditet portofoli i qirasë financiare xxx ndërsa pesha e portofolit faktoring mbetet më pak se xxx

Kreditimi është procesi i dhënies hua të fondeve që Shoqëritë Financiare Jo-Banka disponojnë sipas kushteve të rëna dakord midis SFJB-së dhe huamarrësit i cili mund të jetë një individ, biznes apo korporatë.

Mbështetur në të dhënat e depozituara nga Banka e Shqipërisë me shkresat nr. 671/2 prot., datë 24.10.2024 dhe nr. 671/5 prot., datë 13.11.2024, mbi volumet e portofolit për secilin Subjekt Financiar Jo Bankë, të licencuar për produktin kredi, për vitet 2022-2023, u përcaktua struktura e tregut përkatës të produktit dhe pjesa e tregut e palëve të përfshira në transaksion.

Fondi Besa mbetet SFJB me pjesën më të madhe të tregut të kredihënies me rreth xx% për vitet 2022-2023, e ndjekur nga NOA SHA, e cila zotëron xx% të tregut për vitin 2022 dhe xx% për vitin 2023, ndërkohë që shoqëria TRANZIT SHA zë një pjesë tregu prej xx% për vitin 2022 dhe xx% për vitin 2023.

Pas përqendrimit, pjesa e kombinuar e tregut e shoqërisë TRANZIT SHPK do të jetë xx% të tregut të kredihënies, duke qenë SFJB e dytë me pjesën më të madhe në treg.

Referuar të dhënave të strukturës së tregut, rezulton se treguesi i përqendrimit HHI në tregun e kredihënies është i lartë, duke treguar për një treg me përqendrim të. Pjesa e tregut e dy subjekteve me të mëdha është mbi xx% dhe subjektet e tjera kanë një pjesë shumë të vogël në treg, duke i dhënë tregut karakteristikat e një tregu duopol. Edhe pas realizimit të transaksionit, treguesi HHI vazhdon të jetë në nivelin e një tregu me përqendrim të lartë, me një delta HHI prej xx.

Mbështetur në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, Autoriteti mund të mos identifikojë probleme që lidhen me konkurrencën në nivel horizontal, në ato përqendrim ku indeksi HHI pas përqendrimit është në nivelet ndërmjet 1000 dhe 2000 dhe një delta nën 250, ose me një përqendrim ku indeksi HHI pas përqendrimit është mbi 2000 dhe një delta nën 150.

Referuar dokumentacionit të depozituar, vlerësohet se transaksioni i njoftuar pritet të sjellë një sërë përftimesh strategjike dhe operationale për tregun përkatës, si diversifikimi i ofertës financiare, përmirësim të shërbimit për konsumatorët, më shumë mundësi për financimin e aktiviteteve bujqësore dhe konsumit dhe adresim më i mirë i nevojave të tregut.

Duke integruar shërbimin e secilit subjekt, konsumatorët mund të përfitojnë nga një gamë më e gjerë produktesh financiare, të cilat do t'i ndihmojnë ata të optimizojnë menaxhimin e financave të tyre personale dhe të nevojave të bizneseve të vogla. Ekspertiza në një nivel më të lartë në procesin e kredihënies, analizës së rrezikut dhe menaxhimit të kredive, do të përbëjë një avantazh në efikasitetin e shoqërisë target.

Blerja e një subjekti jobankë nga një tjetër subjekt jobankë përbën një mundësi për rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e shërbimeve për konsumatorët.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës konstaton se transaksioni i përftimit të kontrollit të shoqërisë NOA SHA nga shoqëria TRANZIT SHPK, do të krijojë mbivendosje horizontale ndërmjet aktivitetit të palëve në transaksion, por pa shfaqur shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë NOA SHA nga shoqëria TRANZIT SHPK.
2. Monitorimin e tregut të kredihënies për një periudhë 1 (një) vjeçare nga marrja e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1136, Datë 06. 12. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË BIZNESIT TË TRANSFERUAR NGA SHITËSIT TEK SHOQËRIA DIGI TÁVKÖZLÉSI ÉS SZOLGÁLTATÓ KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06. 12. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Biznesit të Transferuar nga Shitësit tek shoqëria DIGI Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Biznesit të Transferuar nga shitësit tek shoqëria DIGI Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të Biznesit të Transferuar nga shitësit tek shoqëria DIGI Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për transferim biznesi dhe bashkëpunim”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: DIGI Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit hungarez. DIGI është i angazhuar në tregun e telekomunikacioneve, duke operuar kryesisht në tregun e aktiviteteve të telekomunikacioneve të kabllit.

DIGI nuk operon dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri. Shoqëria zotërohet nga 4iG Nyrt, nëpërmjet shoqërisë Antenna Hungária Zrt., i cili është prezent indirekt në Shqipëri përmes shoqërisë ONE ALBANIA SHA.

ONE ALBANIA SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila ka si objekt aktiviteti: ndërtimin, zotërimin, operimin dhe ofrimin e rrjetit publik të telefonisë së lëvizshme të standartit GSM dhe telefonisë fikse; komunikim bazë të telefonisë celulare në rrjetin lokal bazuar në kanalet radio; komunikimin bazë në rrjetin ndërqytetas që lidhen me transmetimin radio, komunikimin e të dhënave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar etj.

Pala shitëse:

Shitësi 1: Canal + Luxembourg S.à r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Luksemburgut, me objekt aktiviteti: përfitimi i pjesëmarrjeve, në çdo formë të tyre, si në Luksemburg ashtu edhe jashtë tij, në të gjitha shoqëritë ose ndërmarrjet e çdo forme, si dhe mbajtja, administrimi, menaxhimi, kontrolli, zhvillimi ose shitja e këtyre pjesëmarrjeve, në tërësi ose pjesërisht, te palët të cilat Shoqëria i konsideron të denjë dhe veçanërisht në këmbim të aksioneve ose titujve në çdo shoqëri ose pale që i fiton ato. Shoqëria mund të blejë, të abonohet, të shkëmbejë ose të fitojë në çdo mënyrë të gjitha certifikatat, aksionet dhe/ose vlerat e tjera të pjesëmarrjes, obligacionet, kreditë, certifikatat e depozitave dhe/ose instrumenta të tjerë të borxhit të lëshuar nga çdo entitet publik ose privat etj.

Shitësi 2: Eviso Magyarország Korlátolt Felelősségű Társaság është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit hungarez, me objekt aktiviteti: agjensi reklamimi; shitja me pakicë e kompjuterëve, pjesëve periferikë dhe softuerit në dyqane të specializuara; shitja me pakicë e pajisjeve audio dhe video; aktivitete prodhimi e filmave, videove dhe programeve televizive; aktivitete të shpërndarjes së filmave, videove dhe programeve televizive etj.

Shitësi 3: Canal+ Distribution Hungary Korlátolt Felelősségű Társaság është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, me objekt: aktivitete telekomunikacioni me kablo; riprodhim i medias së regjistruar; publikim i revistave dhe periodikeve; aktivitete të konsulencës kompjuterike; shitja me shumicë dhe pakicë e pajisjeve dhe pjesëve elektronike dhe të telekomunikacionit; qiradhënie dhe qiramarrje e makinerive, pajisjeve dhe produkteve të prekshme të tjera etj.

Shitësit nuk operojnë dhe nuk gjenerojnë të ardhura në Shqipëri.

Target: Biznesi që do të transferohet e cila përfshin:

- Marrëveshjet e abonentëve DTH (Direct to Home), që zotëron Shitësi 1 që do të thotë të gjitha marrëveshjet e abonentëve në fuqi të përfunduara nga Shitësi 1 me Abonentët DTH për ofrimin e transmetimit të programeve televizive satelitore, të subjektit të Kushteve të Përgjithshme të Abonentëve DTH të Shitësit 1;
- Marrëveshjet për Shërbimet e Marketingut Intragrup që zotëron Shitësi 2;
- Punonjësit e Transferuar që zotëron Shitësi 2 që do të thotë 5 punonjës të Shitësit 2 që, në datën e Nënshkrimit, janë të punësuar në Biznes.
- Si një element opsional, Marrëveshjet e Abonentëve të Kabllos që zotëron Shitësi 3, do të thotë të gjitha marrëveshjet e abonentëve në fuqi të përfunduara nga Shitësi 3 me Abonentët e Kabllos për ofrimin e transmetimit të programeve televizive përmes kabllor, të subjektit të Kushteve të Përgjithshme të Abonentëve të Kabllos të Shitësit 3; dhe Marrëveshjet e Qirasë së Kabllos; do të thotë kontratat e qirasë dhe të menaxhimit të automjeteve të përhershme të lidhura mes Shitësit 2 si qiramarrës dhe LeasePlan Hungária Zrt. si qiradhënës për qiranë e automjeteve.

Të gjitha këto së bashku përbëjnë Biznesin që do të transferohet sipas Transaksionit të Propozuar. Pas datës së përmbylljes së transaksionit, DIGI-t do t'i caktohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Biznesit, dhe punonjësit e përfshirë në Punonjësit e Transferuar do të jenë të punësuar nga DIGI.

II. Transaksioni

Më datë [...], ndërmjet palës blerëse DIGI Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság dhe palëve shitëse Canal + Luxembourg S.à r.l. si shitësi 1, Eviso Magyarország Korlátolt Felelősségű Társaság si Shitësi 2 dhe Canal+ Distribution Hungary Korlátolt Felelősségű Társaság si Shitësi 3, është lidhur “Marrëveshje për transferim biznesi dhe bashkëpunim”.

Objektivi i kësaj Marrëveshje është transferimi i Biznesit, që përfshin Marrëveshjen e Abonentëve DTH, Marrëveshjen e Shërbimeve të Marketingut brenda grupit, Punonjësit Transferues dhe, si një element opsional, Marrëveshjet e Abonentëve Kabllor dhe Marrëveshjet e Qirasë së Kabllit si dhe të drejtat dhe detyrimet e tjera, të cilat do të **konsiderohen njësi biznesi autonome**.

Titulli i Biznesit (duke përfshirë titullin e pronësisë për të gjitha asetet që janë pjesë e Biznesit) do të transferohet nga Shitësi te Blerësi në Datën e Mbylljes.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar konsiston në përfundimin e kontrollit të Biznesit të Transferuar nga shitësit tek shoqëria DIGI Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i televizionit dhe komunikimeve televizive, por duke qenë se

transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, si edhe duke iu referuar praktikave të tjera të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të Biznesit të Transferuar nga shitësit tek shoqëria blerëse DIGI Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság.

DIGI Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság ushtron aktivitet kryesisht në tregun e aktiviteve të telekomunikacioneve kablore. DIGI nuk operon dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri, por është prezent indirekt në Shqipëri përmes shoqërisë One Albania SHA.

Biznesi që do të transferohet përfshin Marrëveshjet e abonentëve DTH; Marrëveshjet për Shërbimet e Marketingut Intragrup; Punonjësit e Transferueshëm që zotëron; dhe si element opsional, Marrëveshjet e Abonentëve të Kabllos dhe Marrëveshjet e Qirasë së Kabllos.

Biznesi që do të transferohet dhe Blerësi nuk operojnë në Shqipëri. Transaksioni i Propozuar nuk do të sjellë ndryshim të strukturës së këtij tregu në territorin shqiptar.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar të përfimit të kontrollit të Biznesit të Transferuar nga Shitësit tek shoqëria DIGI Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1137, Datë 06. 12. 2024

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Lejda MATJA	Zv/ kryetare
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06. 12. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Dhënie e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Shkodër SHA.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër SHA,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës nr. 751 prot., datë 14.11.2024, informon Autoritetin e Konkurrencës se me projekt-vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 26 prot., datë 12.09.2024, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjiellës dhe të kanalizimit, në të gjithë zonën e shërbimit pas themelimit të ndërmarrjes Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër SHA më datë 05.04.2023, bazuar në VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër SHA”, rezultoi se:
3. Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale për kategorinë e furnizimit me ujë (FU), për të gjitha njësitë, të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura (KUN) dhe tarifën fikse të shërbimit.
4. Ndërmarrja Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër SHA aktualisht ushtron aktivitetin e saj sipas tarifave të miratuara nga ERRU për ish shoqëritë UK ekzistuese. Tarifat e miratuara janë sipas :
 - Vendimit të KKRR nr. 37, datë 19.12.2011 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për konsumin publik për shoqërinë ujësjellës kanalizime Shkodër SHA.
 - Vendimit të KKRR nr. 10, datë 16.02.2018 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotur për shoqërinë ujësjellës kanalizime Malësia e Madhe SHA.
 - Vendimit të KKRR nr. 30, datë 20.06.2019 “Për miratimin e tarifave të largimit të ujërave të ndotur për shoqërinë ujësjellës kanalizime Malësia e Madhe SHA.
 - Vendimit të KKRR nr. 74, datë 19.10.2018 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime Vau Dejës SHA.
 - Vendimit të KKRR nr. 48, datë 30.12.2013 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për shoqërinë e ujësjellës kanalizime Pukë SHA.
5. Kjo ndërmarrje e riorganizuar në nivel rajonal synon ndryshimin e tarifave aktuale në një nivel të ri tarifor, me qëllimin e qëndrueshmërisë financiare duke përmirësuar nivelin e kostove dhe përcaktimin e objektivave të treguesve kryesorë të performancës që ndërmarrja duhet të arrij në fund të vitit 2025; 2026, për të ofruar një shërbim më cilësor tek konsumatori dhe që të përballoj kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes.
6. Ndërmarrja Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër SHA bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që nuk arrijnë të mbulojnë kostot të operimit dhe mirëmbajtjes, prandaj përmirësimi i këtij treguesi është objektiv kryesor i ndërmarrjes për vitin 2025, 2026. Për shërbimin e furnizimit

me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon një nivel tarifimi volumetrik shërbimi për FU dhe për KUN, të cilat aplikohen jo në mënyrë uniforme për të gjithë zonën e shërbimit që mbulohet nga secila UK ekzistuese, e riorganizuar në një njësi rajonale. Pas riorganizimit të sektorit është themeluar ndërmarrja Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër SHA për të cilën po miratohen tarifa të ndryshuara bazuar në analizën e kryer.

7. Aktualisht për Zonën A - Bashkia Shkodër tarifat për FU kanë qenë më të ulta në qarkun përkatës sepse nuk janë rishikuar që nga viti 2011 për Shkodrën, që nga vitit 2019 për Malësinë e Madhe dhe që nga viti 2013 për Pukën dhe viti 2018 për Vaun e Dejës. Ndërmarrja në këtë aplikim ka kërkuar rishikim të tarifave për klientët jo familjarë, familjarë për rishikimi e tarifave për FU, për KUN dhe për tarifat fikse. Është pranuar si i arsyeshëm propozimi i shoqërisë për klientët publike ndërsa tarifat për klientët privat nuk janë pranuar në nivelin e kërkuar nga shoqëria, por është parë e arsyeshme të respektohet klauzola e metodologjisë së tarifave lidhur me koeficientin e ndër financimit të tarifave ndërmjet klientëve familjarë me ato jo familjarë, megjithëse në disa raste kjo tarifë kalon dyfishin e raportit të konsumatorit familjarë me konsumatorin jo familjarë (publik dhe privat). Në këtë propozim tarifat fikse janë pranuar të unifikuara për të të gjithë zonën e riorganizuar të ujësjiellësit rajonal sipas propozimit të shoqërisë. Gjithashtu tarifat volumetrike për KUN për të gjithë zonën janë rillogaritur dhe miratuar nga ERRU- të unifikuara jo sipas propozimit të shoqërisë, por sipas llogaritjeve përkatëse.
8. Tarifa për klientët familjare për Zonën e Pukës dhe Fushë Arrëzit u unifikuan në një vlerë më të ulët se ajo e zonës ku përfshihet Shkodra, Malësia e Madhe dhe Vau i Dejës. Edhe për këto njësi është rishikuar propozimi i shoqërisë duke konsideruar një rritje të arsyeshme në këtë aplikim duke patur parasysh kushtet specifike të këtyre njësisë. Referuar tarifave për klientët publik dhe private të njësisë Shkodër, nuk është pranuar propozimi i shoqërisë për FU, por është parë e arsyeshme të respektohet aplikimi i koeficientit të ndërfinancimit të përcaktuar në metodologjinë e tarifave ndërmjet klientëve familjare me ato jo familjare.
9. Referuar tarifave për klientët publike dhe private të njësisë Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, nuk është pranuar propozimi i shoqërisë për FU, por është parë e arsyeshme të respektohet aplikimi pothuajse i koeficientit dy (2) të ndërfinancimit të përcaktuar në metodologjinë e tarifave ndërmjet klientëve familjarë me ato jo familjarë. Përjashtim bën Njësia Pukë e cila i ka pas aktualisht tarifat për klientët publike dhe private të larta dhe megjithëse tarifa e faturimit të ujit për klientë familjarë është 40 lek/m³, ajo për klientë publik është 130 lek/m³ ndërsa për klientë privat është 140 lek/m³ nuk është aplikuar koeficienti i

ndërfinancimit të përcaktuar në metodologjinë e tarifave ndërmjet klientëve familjare me ato jo familjar.

10. Ndërmarrjen Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër SHA propozon tarifat e reja si rezultat i nevojës për përmirësim të performancës financiare; cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve; tendencën e unifikimit të tyre për gjithë zonën e shërbimit. Nevoja për përmirësimin e performancës financiare dhe mbulimi mbi 100% i kostove operacionale. Aplikimi për nivel të ri tarifor për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve dhe pagës minimale ndër vite. Përmirësim i cilësisë së shërbimeve të ofruara të FU dhe KUN si rezultat i investimeve të parashikuara. Tarifat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit. Tarifat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit.
11. Bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, të përcaktuara në Vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2025; vitin 2026 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, reduktimin e kostove të mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar reduktimin e humbjeve teknike dhe administrative, rritjen e qëndrueshmërisë financiare si edhe rritjen e mundësisë për përfitime të investimeve në shërbimet e ofruar.
12. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrjen Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër SHA pas miratimit të tarifave të reja do të ketë një nivel të pranueshëm të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes totale, që varion nga 39% në vitin 2023 me një rritje në 63% për në fund të vitit 2026. Nevoja për të ardhura synon përmirësimin e nivelit të mbulimit të kostove O&M, i cili parashikohet të jetë në nivelin nga 69.19% për vitin 2023 me një rritje 102.61% për në fund të vitit 2026.
13. ERRU bazuar në projekt vendimin e miratimit të tarifave gjykon se ndërmarrjen Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër SHA duhet t'i kushtohet vëmendja maksimale instalimit të matësve në prodhim për të gjithë burimet, si dhe atyre familjarë të parashikuar, për të gjithë klientët në zonën e shërbimit në mënyrë që të arrihet objektivi i vendosur nga ERRU për treguesin e nivelit të matjes dhe uljen e humbjeve; Të kryejë vlerësimin e "Ujit të Prodhuar" bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet me dhe pa ujëmatës; Të trajtojë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e Bilancit të Ujit me të dhëna sa më afër realitetit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij sa më saktë, për të patur situatë reale mbi UPA dhe të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të Bilancit të Ujit për vitin 2024 dhe në vazhdim; Të mbajë aktive vazhdimisht Task-Forcën për

evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e furnizimit dhe abuzimet kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zonat rurale;

14. Për aplikimin tarifor të rradhës (jo më vonë se qershor 2027), duke qenë se shoqëria në fund të periudhës rregullatore 2025-2027 do të arrijë të mbulojë mbi 100% kostot O&M, shoqëria do të aplikojë sipas metodës “Çmim Tavan” të metodologjisë së tarifave, i cili kërkon që të jetë detyruesisht i shoqëruar me Planin e Biznesit 5-vjeçar i aprovuar paraprakisht nga ERRU. Për këtë qëllim shoqëria duhet të ketë parasysh që brenda vitit 2027 të ketë hartuar Planin e Biznesit 5-vjeçar duke përdorur si vit bazë të dhënat e çertifikuara të vitit 2026, i cili duhet të shoqërohet me planet përkatëse të veprimit të mbështetura me projekte dhe me burimet e financimit.
15. Të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara për të planifikuar prioritetet e inestimeve në të ardhmen e afërt në mënyrë që të evitohet vjetërimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme, e cila lidhet ngushtësisht me strategjinë e zvogëlimit të humbjeve nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të çënimit të shëndetit publik nga ndotjet në çarjet.
16. Të mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të paktën për vitin 2026, si një vit bazë që do të përdoret për aplikimin e radhës.
17. Me mbështetjen e task forcës të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit dhe asaj të përgjithshme duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si, monitorimi i klientëve, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, pagesa online dhe deri ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë.
18. Treguesi i efikasitetit të stafit që lidhet me një nga elementet e rëndësishëm të kostove të O&M duhet të justifikohet me argumenta mbështetëse. Për këtë duke hartuar urgjentisht një organogramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri.
19. Ti kushtohet vëmendje e veçantë konsumit të energjisë në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të këtyre kostove, duke i dhënë prioritet hartimit urgjent të një studimi mbi efikasitetin e energjisë me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë për energjinë.
20. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) bazuar në pikën 1/b të nenit 14 të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë edhe të largimit të

përpunimit të ujërave të ndotura”, ka kompetencë të miratojë çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruar nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik, edhe në rastet kur sistemet e ujësjellës kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose në pronësi të njësisive të qeverisjes vendore. KKRR me anë të vendimit nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”, ka miratuar rregullat, procedurat, politikën tarifore dhe metodologjinë e vendosjes së tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura.

21. Mbështetur në nenet 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatorë, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive dhe për arsye të interesit të përgjithshëm, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ.
22. Propozimet për ndryshim të tarifa të shërbimit nga ndërmarrja e Ujësijellës Kanalizimeve janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe me Vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Entit Rregullator të Ujit:
 - a. Detyrimin për zbatimin e nenit 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregun përkatës.
 - b. Për çdo rast të rishikimit të tarifave të reja për ndërmarrjet e ujësjellës kanalizime, të përcaktohet qartë struktura e kostos mbi bazën e së cilës miratohen tarifat, bazuar në metodologjinë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura”, në të cilën përfshihen kostot e: - Tarifës së ujit për shitje sipas kategorive të konsumatorëve; - Tarifës për Shërbimin e Grumbullimit, Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura ; - Tarifës së shërbimit.
 - c. Rritja e tarifave duhet të jetë graduale dhe në përputhje me kriteret e performancës, në mënyrë të veçantë të orarit të furnizimit me ujë.
 - d. Publikimin dhe bërjen transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të të gjithë informacionit në lidhje me aplikimet për ndryshimin e tarifave, kostot përkatëse mbi të

cilat bazohen këto ndryshime, si dhe për vitet 2018 dhe 2019 të publikohen treguesit e parashikuar për “ujin pa të ardhura”, “Kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “Eficiencën e stafit”.

23. Në zbatim të këtij vendimi, Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar disa vendime të marra nga ERRU për miratimin e ndryshimit të tarifave të shërbimit nga ndërmarrje të Ujësjetllës Kanalizimeve.
24. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” SHA, i ka rekomanduar Entit Rregullator të Ujit si vijon:
 - a. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për Ndërmarrjen Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
 - b. ERRU të kërkoj nga Ndërmarrja Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Tirane SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
 - c. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëj transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.
25. Nga analiza e konkurrencës rezulton se ndërmarrja Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, në kuptim të nenit 9 pika 1 e Ligjit nr. 9121/2003 ka detyrimin e mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht në vendosjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar ERRU, si autoriteti përgjegjës për miratimin e tarifave, orientimin e çmimeve të shërbimit drejt kostos për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër SHA.
26. Në aplikimin për nivel të ri të tarifës për FU dhe KUN, ERRU, e gjen të nevojshme ndryshimin e nivelit tarifor për tarifën variabël të FU dhe KUN për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër SHA, por jo në nivelet që propozon ndërmarrja. ERRU e ka bazuar analizën e përcaktimit të tarifave në Vendimin nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjetllës kanalizime”, duke analizuar të dhënat që përcaktojnë tarifën (kostot operacionale, vëllimet e faturave dhe numrin e klientëve) të realizuar në vitin bazë (viti 2023) dhe duke aplikuar koeficientin tarifor për përcaktimin e tarifave për kategoritë e klientëve jo familjarë.

27. Procedura e miratimit të tarifave nga ERRU, bazuar në pikën 1 të nenit 13 të Metodologjisë së miratimit të tarifave sipas Vendimit të KKRR nr. 539/2021, përmban dhe aprovimin e prezantimit për në seancën dëgjimore me publikun të tarifave dhe zhvillimin e tyre. Sipas verifikimit të faqes zyrtare të web-it të Bashkisë Shkodër, Malësia e Madhe, Vau i Dejës, Fushë Arrëz dhe Pukë si edhe të Ndërmarrjes Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër SHA, konstatohet se seanca dëgjimore në lidhje me propozimin për ndryshim tarife kundrejt konsumatorëve familjarë, publik dhe jo familjarë, nuk janë publike.
28. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot për të dy shërbimet e ofruara, duke zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (b).
29. Konstatohet se vetëm vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, germa (d) e (f); 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
2. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.
3. Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër, Malësia e Madhe, Vau i Dejës, Fushë Arrëz dhe Pukë si edhe në ndërmarrjen Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër

SHA seancat e zhvilluara të dëgjesës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 1138, Datë 20. 12. 2024

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE ADASTRA SHPK DHE COLOMBO SHPK, GJOBITJEN DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJET ADASTRA SHPK DHE COLOMBO SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20. 12. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, gjobitjen dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK.

Bazë ligjore: Neni 4, neni 24, germa (d), neni 26, neni 43, pika 5, neni 45, pika 1, neni 74, pika 1, germa (a) dhe neni 75, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Agjencia e Prokurimeve Publike (APP) nëpërmjet shkresës nr. 3321/1 prot., datë 27.05.2024, (protokolluar pranë AK me nr. 388 prot., datë 28.05.2024), ka depozituar pranë Autoritetit të

Konkurrencës, një rast mbi dyshimin për marrëveshjeje në oferta midis operatorëve ekonomik Colombo SHPK dhe Adastra SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për material për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Qendra e Personel Rekrutimit.

2. APP nëpërmjet kësaj shkrese shprehet se është depozituar shkresa nr. 2640/8 prot., datë 26.04.2024 (protokolluar në APP me nr. 3321 prot., datë 30.04.2024) më lëndë: “Kërkesë për përjashtim OE nga procedurat e prokurimit publik”, e Qendrës së Personel Rekrutimit, e cila ka kërkuar vlerësimin e rastit për operatorët ekonomik Colombo SHPK dhe Adastra SHPK.
3. Operatorët ekonomik Colombo SHPK dhe Adastra SHPK kanë qenë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt: “Shpenzime për material për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit, në datën 15.04.2024.
4. Sipas Autoritetit Kontraktor është konstatuar se të dy operatorët ekonomik të sipërcituar kanë lidhje familjare pasi administratorët e këtyre shoqërive janë në rrethin e personave të lidhur me njëri tjetrin (bashkëshortë) si dhe operatori ekonomik Colombo SHPK ka qenë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.
5. APP, i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë të Ligjit nr. 162/2020 “për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Në nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 parashikohet se qëllimi i këtij ligji është si më poshtë vijon:
 - a) Të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
 - b) Të sigurojë mire përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
 - c) Të nxisë pjesëmarrjen e operatoreve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
 - d) Të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
 - e) Të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.
 - f) Të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.
6. APP shprehet se, referuar dokumentacionit të dërguar në AK, “Deklaratë për paraqitje oferte e pavarur” nga operatori ekonomik Adastra SHPK është dërguar e paplotë dhe e panënshkruar nga subjekti dhe pas renditjes së tij në vendin e parë (mundon faqe e dytë e tij). Qëllimi i plotësimit të kësaj deklaratë është ndalimi i marrëveshjeve të fshehta ne ofertë, pasi ky veprim çon në pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg dhe përbëjnë shkelje të rendë të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

7. Nisur nga parimi i nxitjes së konkurrencës, ndërmjet operatorëve ekonomikë, si dhe në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit nr. 28/2 prot., datë 02.04.2019, të nënshkruar më Autoritetin e Konkurrencës, APP përcjell këtë rast për të vijuar më tej hetimin sa i takon kësaj çështjeje.
8. Nga vlerësimi i informacionit të paraqitur nga APP, mbi shkeljet e pretenduara të konkurrencës nga ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, dhe informacionit të Qendrës së Personel Rekrutimit, mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Shpenzime për materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Qendra e Personel Rekrutimit Tiranë, vihet re:
 - Ndërmarrja Adastra SHPK ka paraqitur “Deklaratë për paraqitje oferte e pavarur”, të plotë dhe të nënshkruar.
 - Autorizim i datës 24.04.2024, ku ndërmarrja Adastra SHPK autorizon Z. Petrit Levendi të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor “Reparti Ushtarak nr. 6670 Qendra e Personel Rekrutimit Tiranë”, për të dorëzuar dokumentat dhe mostrat për procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës”.
 - Z. Petrit Levendi është administrator dhe ortak i vetëm ndërmarrjes Colombo SHPK, gjithashtu pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt: “Shpenzime për materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit.
 - Ndërmarrja Adastra SHPK dhe ndërmarrja Colombo SHPK, kanë të njëjtën zyrë qendrore me adresë të përbashkët.
 - Në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik Adastra SHPK gjendet, vërtetim debie i datës 03.04.2024 “Për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, për personat juridik të interesuar për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura, si dhe për personat fizikë dhe juridikë të interesuar për procedurat që lidhen me zbatimin e rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit lidhur me ndërtimet e reja”, vërtetim i lëshuar me kërkesën e ndërmarrjes Colombo SHPK.
9. Sa më sipër ngrihen dyshime të arsyeshme se ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK përdorin skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord më përpara se cili prej tyre do të paraqesë ofertën më të lartë dhe cili ofertën fituese në procedurën e prokurimit ku ata do të jenë pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët, duke krijuar përshtypjen e një oferte të pastër dhe një konkurrence të sinqertë.
10. Bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimit “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, kjo sjellje hedh dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta

midis operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për material për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit.

11. Për sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit me objekt “Shpenzime për material për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit, ka elementë të një sjelljeje antikonkurrese, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
12. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” me Vendim nr. 1089, datë 21.06.2024, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, për periudhën kohore nga 01.01.2022 deri në 21.06.2024.
13. Në zbatim të Vendimit nr. 1089, datë 21.06.2024, bazuar në nenet 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës me nr. 388/6, datë 27.06.2024 “Autorizim inspektorësh”, Grupi i Inspektimi, gjatë periudhës së hetimit paraprak, më datë 27.06.2024 proceduan me kryerjen e inspektimit pranë adresave të deklaruara në QKB të ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, specifikisht në rruga “Rreli”, njësia administrative Farkë, Selitë, Tiranë.
14. Gjatë procedurës së inspektimit nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve nën hetim sipas përcaktimit të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
15. Ndërmarrja Adastra SHPK dhe Colombo SHPK në datë 26.09.2024, janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, ku janë pyetur nga Sekretariati për çështjen objekt hetimi.
16. Në këtë seancë, Adastra SHPK dhe Colombo SHPK u shprehën se në asnjë moment sjellja e tyre ka pasur për qëllim kordinimin midis të dyja ndërmarrjeve për të komunikuar mbi ofertat dhe procedurat e prokurimit ku marrin pjesë, pavarësisht lidhjes si burrë dhe grua, ndërmarrjet shprehën se operojnë të pavarura në momentin e pjesëmarrjes në një procedurë prokurimi. Gjithashtu, ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK u shprehën se nuk kanë pasur dijeni që sjellja e tyre në procedurat e prokurimit mund të përbënte një marrëveshje të ndaluar.

Së fundmi, Znj. Kozeta Levendi administratore dhe ortake e vetme e ndërmarrjes Adastra SHPK u shpreh se angazhohet që do të mbylli aktivitetin e kësaj ndërmarrje.

17. Gjatë hetimit paraprak, bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë p engimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe bazuar në Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, sjellja e ndërmarrjeve: Adastra SHPK dhe Colombo SHPK në tregun e prokurimit publik për shpenzimë kancelarie, pajisje zyre, pajisje informatike etj., të zhvilluara nga autoritetet kontraktore, hedh dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis tyre.
18. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 4, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me Vendimin nr.1122, datë 23.10.2024, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, për periudhën kohore nga 01.01.2022 deri në 23.10.2024.
19. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës sa më sipër, ndërmarrjet nën hetim janë:
(i) Ndërmarrja Adastra SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në datë 11.06.2014, me kapital 100% privat, me NIPT: L41826018M, me seli në: Tiranë, Farkë Selitë, Rruga "Rreli", zona kadastrale nr. 3292, volumi 56, faqe 94, me Administrator dhe Ortak të vetëm Znj. Kozeta Levendi dhe (ii) ndërmarrja Colombo SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në datë 08.12.2000, me kapital 100% privat, me NIPT: K36608208V, me seli në: Tiranë, Farkë Selitë, Njësia Administrative Farke, Rruga "Rreli", objekti Selita 5, me Administrator dhe Ortak të vetëm Z. Petrit Levendi.
20. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion drejtuar Agjencisë e Zhvillimit të Territorit, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Jug, Drejtorsë së Policisë së Qarkut Vlorë, Bashkisë Belsh dhe Bashkisë Malësi e Madhe.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

21. Në zbatim të Ligjit nr. 9121/2003, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
22. Procedurat e prokurimeve publike kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me Ligjin nr. 162/2020. Ky ligj përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet dhe entet kontraktore për kontratat publike dhe konkurset e projektimit. Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike.
23. APP, nëpërmjet shkresës nr. 388 prot., datë 28.05.2024, i ka kërkuar Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ për procedurën e prokurimit me nr. REF-01042-04-12-2024, dhe objekt “Shpenzime për material për funksionimin e pajisjeve të zyrës” me fondin limit 800,000 lekë pa TVSH që është zhvilluar në datë 15.04.2024 nga autoriteti kontraktues, Qendra e Personel Rekrutimit.
24. Nëpërmjet shkresës nr. 388 prot., datë 28.05.2024 të depozituar nga APP pranë Autoritetit të Konkurrencës, janë sjellë të gjithë procedurat e prokurimit publik ku ndërmarrjet nën hetim kanë marrë pjesë. Adastra SHPK dhe Colombo SHPK kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.
25. Gjatë periudhës kohore në hetim 1 janar 2022 – 21 qershor 2024, Adastra SHPK dhe Colombo SHPK kanë marrë pjesë në 1651 procedura prokurimi së bashku, në të cilat 772 procedura për vitin 2022, 650 procedura për vitin 2023 dhe 229 procedura për vitin 2024. Objekti i prokurimit për këto procedura kryesisht kanë qenë në lidhje me shpenzime pajisje zyre, pajisje kancelarie, pajisje informatike etj.
26. Nisur nga sa më sipër, treg përkatës i produktit do të konsiderojmë tregun e prokurimit publik për shpenzime kancelarie, pajisje zyre, pajisje informatike etj., ofruar nga ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK.
27. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.

28. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë të prokurimit janë aktive në tregjet e produktit, nëpërmjet ofrimit të tyre, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Si rrjedhojë, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

III. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve

29. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve, në tregun e prokurimit publik për shpenzimë kancelarie, pajisje zyre, pajisje informatike etj., ofruar nga ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK është realizuar bazuar në metodologjinë e OECD⁶ “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, si dhe Udhëzuesit⁷ të përshtatur sipas kësaj metodologjie të OECD, “Mbi Luftimin e Marrëveshjeve të Ndaluar në Oferta në Prokurimet Publike”.
30. Ndërmarrja Adastra SHPK, për vitin 2022 ka marrë pjesë në 777 procedura prokurimi, për vitin 2023 ka marrë pjesë në 655 procedura prokurimi dhe për vitin 2024 deri në tetor ka marrë pjesë në 223 procedura prokurimi.
31. Nga këto procedura është shpallur fituese në 38 prej tyre në vitin 2022, më pas në 2023 është shpallur fituese në 27 prej tyre dhe deri në tetor 2024 në 14 procedura prokurimi.
32. Ndërmarrja Colombo SHPK, për vitin 2022 ka marrë pjesë në 822 procedura prokurimi, për vitin 2023 ka marrë pjesë në 873 procedura prokurimi dhe për vitin 2024 deri në tetor ka marrë pjesë në 583 procedura prokurimi.
33. Nga këto procedura është shpallur fituese në 34 prej tyre në vitin 2022, më pas në 2023 është shpallur fituese në 49 prej tyre dhe deri në tetor 2024 në 31 procedura prokurimi.
34. Për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve për periudhën kohore nga 01.01.2022 deri në 23.10.2024 është shqyrtuar i gjithë dokumentacioni i administruar dhe i paraqitur nga Autoritetet Kontraktore pranë Autoritetit të Konkurrencës. Duke qenë se procedurat e prokurimit ku dy ndërmarrjet në hetim Adastra SHPK dhe Colombo SHPK kanë marrë pjesë janë procedura prokurimi me vlerë të vogël ndërmarrjet konkurrojnë vetëm nëpërmjet vlerës në këto procedura dhe nuk ngarkojnë dokumente në sistem. Procedurat e prokurimit të analizuara si vijon:
- vii. Procedura e referuar nga APP: me nr. REF-01042-04-12-2024, dhe objekt “Shpenzime për material për funksionimin e pajisjeve të zyrës” me fondin limit 800,000 lekë pa TVSH që

⁶ <http://www.oecd.org/competition/cartels/fightingbidrigginginpublicprocurement.htm>

⁷ <http://www.caa.gov.al/file/publikimet/brochure.pdf>

është zhvilluar në datë 15.04.2024 nga autoriteti kontraktues, Qendra e Personel Rekrutimit. Nuk është shpallur fitues asnjë nga ndërmarrjet nën hetim.

- viii. Procedura me nr. REF-34602-06-28-2022, dhe objekt “Riparim kompjuter printer dhe fotokopje” që është zhvilluar në datë 28.06.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Zhvillimit të Territorit. Shpallur fitues Colombo SHPK.(operatori ekonomik i renditur i pari Adastra SHPK u skualifikua pasi njoftoi me mesazh në sistemin elektronik të prokurimit publik për pamundësinë e realizimit të procedurës)
- ix. Procedura me nr. REF-46819-10-20-2022, dhe objekt “Sherbim per mirembajtje te pajisjeve elektronike printera, fotokopje për nevojat e institucionit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier” që është zhvilluar në datë 20.10.2022 nga autoriteti kontraktor Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier. Shpallur fitues Adastra SHPK. (operatori ekonomik i renditur i treti Colombo SHPK u skualifikua për arsye se oferta ishte me e lartë se fondi limit).
- x. Procedura me nr. REF-61700-03-07-2023, dhe objekt “Blerje Vula dixhitale” që është zhvilluar në datë 08.03.2023 nga autoriteti kontraktor Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat. Shpallur fitues Adastra SHPK. (operatori ekonomik i renditur i pari Colombo u tërhoq me justifikimin se nuk paraqitej dot brenda afateve (paraqitja e dokumentacionit).
- xi. Procedura me nr. REF-72283-06-13-2023, dhe objekt “Mirembajtje dhe riparim i pajisjeve kompjuterike” që është zhvilluar në datë 14.06.2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria Vendore ASHK Tirana Jug. Shpallur fitues Adastra SHPK, i cili është renditur i pari.
- xii. Procedura me nr. REF-85868-10-31-2023, dhe objekt “Riparim printera multifunksional në DVP VLORE” që është zhvilluar në datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Policisë Qarkut Vlorë. Shpallur fitues Colombo SHPK. (operatori ekonomik i renditur i pari Adastra SHPK u skualifikua pasi njoftoi me mesazh në sistemin elektronik të prokurimit publik për pamundësinë e realizimit të procedurës).
- i. Procedura me nr. REF-17232-08-28-2024 dhe objekt “Blerje kancelari & shtypshkrime & tonera” që është zhvilluar në datën 28.08.2024 nga autoriteti kontraktor Bashkia Belsh. Shpallur fitues operatori ekonomik Adastra SHPK, i cili është renditur i pari.
35. Në procedurën e prokurimit me objekt objekt “Shpenzime për material për funksionimin e pajisjeve të zyrës” me fondin limit 800,000 lekë pa TVSH që është zhvilluar në datë 15.04.2024 nga autoriteti kontraktues, Qendra e Personel Rekrutimit, vihet re:
- iv. Autorizim i datës 24.04.2024, ku ndërmarrja Adastra SHPK autorizon Z. Petrit Levendi të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor “Reparti Ushtarak nr. 6670 Qendra e Personel Rekrutimit Tiranë”, për të dorëzuar dokumentat dhe mostrat për procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës”.
- v. Z. Petrit Levendi është administrator dhe ortak i vetëm ndërmarrjes Colombo SHPK, gjithashtu pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt: “Shpenzime për

- materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit.
- vi. Në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik Adastra SHPK gjendet, vërtetim debie i datës 03.04.2024 “Për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, për personat juridik të interesuar për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura, si dhe për personat fizikë dhe juridikë të interesuar për procedurat që lidhen me zbatimin e rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit lidhur me ndërtimet e reja”, vërtetim i lëshuar me kërkesën e ndërmarrjes Colombo SHPK.
36. Në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim për Mirëmbajtje të Pajisjeve Elektronike Printera, Fotokopje, për nevojat e Insitucionit të Prokurorinë Pranë Gjykatë së Shkallës së Parë Fier” zhvilluar nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, vihet re:
- iv. Njoftim në sistem nga ndërmarrja Adastra SHPK ...“një punonjës i autorizuar është duke ardhur ... për të dorëzuar dokumentacionin” dhe Autorizim i datës 24.10.2022, ku ndërmarrja Adastra SHPK autorizon Z. Petrit Levendi të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor “Prokuroria e Rethit Gjyqësor Fier”, për të dorëzuar dokumentat dhe mostrat për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim për Mirëmbajtje të Pajisjeve Elektronike Printera, Fotokopje, për nevojat e Insitucionit të Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”
- v. Kontratë qeraje ku ndërmarrja Adastra SHPK merr me qera ambiente për magazinimin, nga ndërmarrja Colombo SHPK
- vi. Kontratë Bashkëpunimi, mes Adastra SHPK dhe Colombo SHPK e cila ka për objekt plotësimin e stafit të njëri – tjetrit, në rastet që dy palët e quajnë të nevojshme për montim, instalim, dhe servis të printerave dhe fotokopjeve, në lidhje me tenderat dhe kompanitë që lidhen me kontrata furnizim vendosje. Si dhe në nenin 2 ka të shprehur se janë partnerë për procedurë e prokurimeve publike dhe marrim përsipër detyrimin për të zëvendësuar në mungesë stafin e njëri – tjetrit.
37. Ndërmarrja Adastra SHPK dhe ndërmarrja Colombo SHPK, kanë të njëjtën zyrë qendrore me adresë të përbashkët.
38. Në vijim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1122, datë 23.10.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK” dhe nenit 39 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës në datën 20.12.2024 ka ftuar ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK për tu dëgjuar përpara marrjes së vendimit përfundimtar. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore ndërmarrjet nuk dorëzuan dokumente shtesë për të

argumentuar pretendimet e ngritura në raportin e hetimit të thelluar dhe mbrojtja e tyre nuk ishte e bazuar në fakte të qenësishme.

39. Referuar nenit 19, pika 1 dhe pika 2 germa "c" të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Autoritetet ose entet kontraktore duhet të marrin masat e përshtatshme për të parandaluar, identifikuar dhe zgjidhur në përputhje me legjislacionin në fuqi rastet e konfliktit të interesit që lindin gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës dhe për të garantuar trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë. Autoriteti ose enti kontraktor refuzon një ofertë ose një kërkesë për pjesëmarrje në tender nëse kandidati ose ofertuesi në të njëjtën procedurë janë në rrethin e personave të lidhur sipas legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesave.
40. APP-ja mund të evidentojë ekzistencën e konfliktit të interesit. Sipas ligjit "Për prokurimin publik", neni 23, ndër të tjera, APP-ja "...verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj...", pjesë e së cilës është edhe parandalimi i konfliktit të interesit në procedurat e prokurimit publik.
41. Sjellja e ndërmarrjeve Adastras SHPK dhe Colombo SHPK, sipas praktikave për marrëveshje në oferta të vendeve të OECD, si edhe Udhëzimit "Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike", përbën marrëveshje në oferta.
42. Skema e marrëveshjes në oferta e përdorur nga ndërmarrjet Adastras SHPK dhe Colombo SHPK në tregun e prokurimit publik për shpenzimë kancelarie, pajisje zyre, pajisje informatike etj., është ajo e ofertës së mbuluar, e cila është dhe forma më shpesh e përdorur, në të cilën gjenden të implementuara skemat e marrëveshjeve të ndaluara në oferta. Sipas kësaj skeme, njëri nga konkurrentët pranon të paraqesë një ofertë më të lartë sesa oferta e fituesit të përcaktuar, me qëllim për të dhënë përshtypjen e një ofertë të pastër dhe një konkurrencë të sinqertë, si dhe skema e ofertës së përmbajtur e cila përfshin marrëveshjet midis konkurrentëve në bazë të të cilave një apo më shumë firma bien dakort që të përmbahen nga oferta (mos ofertojnë), apo të tërhiqen nga një ofertë e paraqitur në mënyrë që oferta e përcaktuar fituese në marrëveshje të pranohet si e tillë.
43. Si përfundim, bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe bazuar në Udhëzimin "Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike", sjellja e ndërmarrjeve: Adastras SHPK dhe Colombo SHPK në tregun e prokurimit publik për shpenzimë kancelarie, pajisje zyre, pajisje informatike etj., të zhvilluara nga autoritetet kontraktore, përbën marrëveshje të ndaluara.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, germa (d), nenin 26, nenin 43, pika 1 nenin 45, pika 1, nenin 74, pika 1, germa (a) dhe nenin 75, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK.
- II. Gjorbitjen e ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK për shkelje të nenit 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121/2003, përkatësisht në masën 2% të xhiros të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në 122 275 Lekë për ndërmarrjen Adastra SHPK dhe në masën 1% të xhiros të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në 238 809 Lekë për ndërmarrjen Colombo SHPK.
- III. Detyrimin e ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, si vijon:
 - i. Ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK gjatë pjesëmarrjes së tyre në të gjitha procedurat e prokurimit ku ato ofertojnë në kuadër të objektit të veprimtarisë së tyre:
 - a) do të ofertojnë në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakort me asnjë konkurrent tjetër, në lidhje me: çmimet, metodat, faktorët apo formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit, qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë, sjellje këto të cilat vijnë në kundërshtim me Ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
 - b) do të operojnë me punonjësit e tyre, në mënyrë të pavarur si më sipër;
 - c) nuk do të ofertojnë në asnjë procedurë prokurimi sipas objektit të veprimtarisë së shoqërive respektive, njëkohësisht me dy oferta të ndryshme.
- IV. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (c) të Ligjit nr. 9121/2003, ndëshkohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës.
- V. Monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të këtij vendimi nga ana e ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK.

- VI. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.
- VII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1139, Datë 27. 12. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALBANIA LEASING SHA NGA SHOQËRIA AMERICAN CAPITAL SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27. 12. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIA LEASING SHA nga shoqëria AMERICAN CAPITAL SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIA LEASING SHA nga shoqëria AMERICAN CAPITAL SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIA LEASING SHA nga shoqëria AMERICAN CAPITAL SHPK.

Referuar dokumenteve “Marrëveshje për shit-blerjen e aksioneve të ALBANIA LEASING SH.A.” të nënshkruar më datë 14 nëntor 2024 dhe “Marrëveshje Cedimi” të nënshkruar më datë 18 nëntor 2024, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: AMERICAN CAPITAL SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti shërbime profesionale në lidhje me konsulencën menaxheriale dhe financiare; investime financiare; tregti brenda dhe jashtë vendit; dhënie me qira e pasurive të paluajtshme dhe objekteve; dhënie me qira e mjediseve për promovimin, kryerjen dhe/ose organizimi i veprimtarive promovuese, zhvillim projektsh, zbatim dhe menaxhim projektsh, blerje si dhe çdo lloj aktiviteti apo shërbimi tjetër i cili nuk është ndaluar me ligj.

AMERICAN CAPITAL SHPK zotërohet nga Z. Maksim Caslli, shtetas shqiptar, me 1 kuotë, e cila përfaqëson xxx të kuotave dhe Zj. Matilda Caslli, shtetase shqiptare me 1 kuotë, e cila përfaqëson xxx të kuotave të kapitalit.

AMERICAN CAPITAL SHPK zotëron kuota në shoqëritë e mëposhtme: *INTEGRATED TECH SOLUTIONS SHPK, PRAGMA INVESTMENT SHPK, BIOMISHI SHPK, Coinvest SHPK xxx AGRIGOSE SHPK xxx Electromagic SHPK xxx Bio Farm Morava, Bonum SHPK, FACT SHPK xxx*.

Pala Shitëse:

Shitësi 1: Islamic Corporation for Development of the Private Sector është një institucion financiar shumëpalësh, me zyrë qendrore në Mbretërinë e Arabisë Saudite, i cili zotëron xxx të kapitalit aksionar të shoqërisë target.

Shitësi 2: BANKA KOMBËTARE TREGTARE SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti veprimtari bankare, e cila zotëron xxx të kapitalit aksionar të shoqërisë target.

Shitësi 3: KOLON WORLD INVESTMENT CO., LIMITED është një shoqëri investimesh holding, e themeluar sipas ligjeve të Hong Kongut, e cila zotëron xxx të kapitalit aksionar të shoqërisë target.

Shitësi 4: ND Real Estate DOOEL Tetovo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Maqedonisë së Veriut, e cila zotëron xxx të kapitalit aksionar të shoqërisë target.

Shoqëria Target: ALBANIA LEASING SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti shërbimin e qirasë financiare dhe këshillimin, ndërmjetësimin dhe shërbimet e tjera financiare aksesore për qiranë financiare.

ALBANIA LEASING SHA është licencuar nga Banka e Shqipërisë si institucion financiar jobankë, me Licencën nr. 29, datë 21 prill 2014, për kryerjen e shërbimeve të qirasë financiare.

II. Transaksioni

Më datë 14 nëntor 2024 është nënshkruar “Marrëveshje për shit-blerjen e aksioneve të ALBANIA LEASING SHA”, ndërmjet shoqërisë AMERICAN CAPITAL SHPK dhe ALISSA ALBANIA

SHPK në cilësinë e blerësve dhe shoqërive Islamic Corporation for Development of the Private Sector, BANKA KOMBËTARE TREGTARE SHA, KOLON WORLD INVESTMENT CO., LIMITED dhe ND Real Estate DOOEL Tetovo në cilësinë e shitësve.

Referuar kësaj marrëveshje, palë blerëse, përveç shoqërisë AMERICAN CAPITAL SHPK, ka qenë dhe shoqëria ALISSA ALBANIA SHPK.

Më datë 18 nëntor 2024, shoqëritë Islamic Corporation for Development of the Private Sector, BANKA KOMBËTARE TREGTARE SHA, KOLON ËORLD INVESTMENT CO., LIMITED dhe ND Real Estate DOOEL Tetovo në cilësinë e shitësve dhe shoqëritë AMERICAN CAPITAL SHPK, në cilësinë e Cesionarit ose Përfituesit, dhe ALISSA ALBANIA SHPK, në cilësinë e Ceduesit, kanë nënshkruar “Marrëveshje Cedimi”.

Referuar kësaj marrëveshje, Ceduesi, shoqëria ALISSA ALBANIA SHPK i ka ceduar dhe transferuar shoqërisë përfituese AMERICAN CAPITAL SHPK, të gjitha të drejtat, titujt dhe detyrimet që lindin nga Marrëveshje për shit-blerjen e aksioneve të ALBANIA LEASING SHA.

Rrjedhimisht, shoqëria AMERICAN CAPITAL SHPK do të përftojë kontroll të plotë dhe të vetëm mbi shoqërinë, duke zotëruar 100% të kapitalit dhe të të drejtave të votimit të ALBANIA LEASING SHA.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i qirasë financiare. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Shërbimi i qirasë financiare ofrohet nga institucionet financiare jobankë (IFJB), subjekte që licencohet nga BSH për të ushtruar një ose disa nga veprimtaritë financiare, të përcaktuara në nenin 54 pika 2 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në RSH” i ndryshuar.

ALBANIA LEASING SHA është e licensuar nga Banka e Shqipërisë si një institucion financiar jobankë, për kryerjen e shërbimeve të qirasë financiare.

Referuar Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 202, totali i portofolit të qirasë financiare, në muajin dhjetor 2023 ka qenë 11.2 miliardë lekë, ose 20% te portofolit të IFJB-ve. Portofoli i qirasë financiare, sipas produkteve, dominohet nga financimet për mjete transporti personale dhe mjete transporti pune.

Tre konkurrentët më të mëdhenj në këtë treg janë: Raiffeisen Leasing SHA, Landeslease SHA dhe Porsche Leasing SHPK. Sipas të dhënave të deklaruara nga pala blerëse, ALBANIA LEASING SHA zë vetëm 8% të tregut të qirasë financiare.

As shoqëria AMERICAN CAPITAL SHPK dhe as ndonjë nga shoqëritë e grupit, nuk janë aktive në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë institucionet financiare jobankë.

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim konglomerat pasi palët pjesëmarrëse në transaksion operojnë në tregje të ndryshme.

Pas transaksionit, pjesa e tregut të ALBANIA LEASING, si një institucion financiar jobankë, nuk do të ndryshojë duke mos sjellë ndryshime të strukturës së tregut në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye transaksioni nuk do të sjellë ndryshime të strukturës në tregun e qerases financiare.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIA LEASING SHA nga shoqëria AMERICAN CAPITAL SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr. 1140, Datë 27. 12. 2024

“MBI VËNIEN NË DISPOZICION TË NJË KOPJEJE TË DOKUMENTEVE TË HETIMIT TË THELLUAR PËR NDËRMARRJEN SAFE SECURITY ALBANIA SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27. 12. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi vënien në dispozicion të një kopjeje të dokumenteve të hetimit të thelluar për ndërmarrjen Safe Security Albania SHPK.

Bazë ligjore: Neni 45 i Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe neni 17 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës ,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 8, nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vendosi me Vendimin nr. 1025, datë 18.10.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit”, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 13 tetor 2023.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak dhe në përfundim të analizës së sjelljes së ndërmarrjeve të administrimit, u konfirmua edhe më tej se në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sjellja e ndërmarrjeve të administrimit mund të përbënte abuzim me pozitën dominuese kryesisht nëpërmjet: refuzimit të aksesit të

ndërmarrjeve të tjera që ofrojnë këtë shërbim; zbatimit të kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët dhe duke krijuar kushtet e favorshme për krijimin e pozitës dominuese të ndërmarrjeve të internetit brenda rezidencës që ata administrojnë.

3. Nisur nga analiza e bërë nga Sekretariati gjatë fazës së hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, u shpreh me Vendimin nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 10 maj 2024.
4. Në vijim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë” dhe nenit 39 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës në datën 23.12.2024 ka ftuar ndërmarrjen Safe Security Albania SHPK për tu dëgjuar përpara marrjes së vendimit përfundimtar.
5. Ndërmarrja Safe Security Albania SHPK gjatë seancës dëgjimore gjithashtu edhe nëpërmjet shkresës prokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me nr. 23/198 prot., datë 23.12.2024 “Kërkojmë të njihemi me dokumentet e dosjes dhe të na vendoset në dispozicion një kopje e të gjitha dokumentave të ndodhura në dosjen administrative, që i përkasin Shoqërisë “Safe Security Albania” Shpk, ka kërkuar që në bazë të nenit 45 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ku parashikohet se: *“1. Të gjitha palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrin kopje të tyre. 2. Organi publik, i përfshirë në procedurën administrative, brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës, siguron në mjediset e tij të punës kushte për mbajtjen e të dhënave, si dhe kushte për njohjen dhe marrjen e kopjeve të dokumenteve, sipas pikës 1 të këtij neni...”* të njihet me dokumentet e plota të dosjes hetimore (si të hetimit paraprak ashtu edhe hetimit të thelluar) që i përket shoqërisë Safe Security Albania SHPK si dhe ti vihet në dispozicion një kopje e dokumentave të ndodhura në dosje (si të hetimit paraprak ashtu edhe hetimit të thelluar), që i përkasin konstatimeve ndaj shoqërisë Safe Security Albania SHPK.
6. Referuar nenit 45 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenin 17 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, palët e përfshira drejtpërdrejtë në procedurat lidhur me nenet 4, 5 dhe 9 të

Ligjit nr. 9121/2003 kanë të drejtë për akses në çdo dokument të hartuar ose përkohësisht të ruajtur nga Komisioni dhe Sekretariati pas njohjes së tyre me Raportin e Hetimit sipas nenit 18 të kësaj Rregulloreje.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 45 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe neni 17 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës,

VENDOSI:

- I. Vënie në dispozicion të një kopjeje të dokumenteve të hetimit të thelluar për ndërmarrjen Safe Security Albania SHPK.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1142, Datë 27. 12. 2024

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURENCËS NR. 1078, DATË 10.05.2024 “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E OFRIMIT DHE AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT KU KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27. 12. 2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”.

Bazë ligjore: Neni 9, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 43, pika 3, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 8, nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vendosi me Vendimin nr. 1025, datë 18.10.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit”, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 13 tetor 2023.

2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak dhe në përfundim të analizës së sjelljes së ndërmarrjeve të administrimit, u konfirmua edhe më tej se në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sjellja e ndërmarrjeve të administrimit mund të përbënte abuzim me pozitën dominuese kryesisht nëpërmjet: refuzimit të aksesit të ndërmarrjeve të tjera që ofrojnë këtë shërbim; zbatimit të kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët dhe duke krijuar kushtet e favorshme për krijimin e pozitës dominuese të ndërmarrjeve të internetit brenda rezidencës që ata administrojnë.
3. Nisur nga analiza e bërë nga Sekretariati gjatë fazës së hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, u shpreh me Vendimin nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 10 maj 2024.
4. Gjatë procedurës së hetimit të thelluar u vlerësua se, informacioni i administruar për ndërmarrjet D&L Administrim SHPK, Arlis Administrim SHPK dhe Safe Security Albania SHPK nuk ishte i mjaftueshëm për të përfunduar procedurat e hetimit të thelluar sipas afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1078, datë 10.05.2024.
5. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit të thelluar me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve D&L Administrim SHPK, Arlis Administrim SHPK dhe Safe Security Albania SHPK në tregun e aksesit të shërbimit të internetit, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 3, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSI:

- I. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, pika “II” dhe pika “III”, të ndryshohet si vijon:

“II. Hetimi do të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 27 dhjetor 2024.”.

“III. Raporti i hetimit të thelluar për ndërmarrjet D&L Administrim SHPK, Arlis Administrim SHPK dhe Safe Security Albania SHPK duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 13.02.2025.”.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS
2024**
BULETINI ZYRTAR



2024